

DISA
SEKRETE
TË
KUR'ANIT



HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)



Në Kur'an, së bashku me lutjet, urdhërimet, ndalimet dhe standarte të larta morale, Zoti shpall shumë sekrete për njerëzimin. Këto janë sekrete vërtet të rëndësishme, dhe një sy i vëmendshëm mund të jetë dëshmitar i këtyre gjatë gjithë jetës së tij. Asnjë burim tjetër përveç Kuranit nuk i zotëron këto sekrete. Kur'ani është burimi unik i sekreteve që ata njerëz, sado inteligjentë, të shkolluar apo të mprehtë të jenë, nuk mund të shpresojë të gjejnë diku tjetër.

Që disa njerëz nuk mund të shohin, ndërsa të tjerët kanë një zotërim të disa mesazhe të fshehura në Kur'an është një tjetër sekret krijuar nga Zoti. Ata të cilët nuk i kërkojnë këto sekrete të shpallura në Kur'an, jetojnë në ankth dhe vështirësi. Ironikisht, ata kurrë nuk e dinë shkakun e shqetësimit të tyre. Ata që mësojnë dhe i kuptojnë këto sekrete të Kur'anit, në anën tjetër, çojnë një jetë të lehtë, të gëzuar.

Subjekti i këtij libri ka të bëjë me disa vargje që Zoti ka shpallur për njerëzimin si sekret. Kur një person i lexon këto ajete, dhe vëmendja e tij tërhiqet nga sekretet në këto ajete, atë që ai duhet të bëjë është të kërkojë qëllimet hyjnore të fshehura në ngjarje dhe të vlerësojë çdo gjë nën dritën e Kur'anit. Pastaj, njerëzit do të kuptojnë me gjallëri se sekretet e Kur'anit kontrollojnë si jetët e tyre por edhe të tjerëve si ato.



DY FJALË RRETH AUTORIT

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Duke qenë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një njohje më të thellë për besimin e tyre. Librat e Harun Jahjasë u drejtohen të gjithë lexuesve, pa marrë parasysh moshën, racën, apo kombësinë e tyre, sepse ata përqendrohen në një synim: të hapin horizontin e lexuesit duke e nxitur atë të mendojë për disa çështje të rëndësishme, si qenia e Allahut dhe Njëshmëria e Tij dhe të jetuarit sipas vlerave që Ai ka përcaktuar për ne.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ
رَسُولُ
مُحَمَّدٍ



DISA SEKRETE TË KUR'ANIT



**HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)**



Dy fjalë rreth autorit dhe veprave të tij

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Harun Jahja është njohur mirë si autor i veprave të rëndësishme, të cilat zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavërteta dhe lidhjet e errëta midis Darwinizmit dhe ideologjive gjakësore, të tilla si: fashizmi dhe komunizmi.

Veprat e Harun Jahjasë, të përkthyer në 72 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion prej mëse 55,000 faqesh me 40,000 ilustrime. Pseudonimi i tij është një ndërthurje e emrave të Harunit (Aaron) dhe Jahja (John), në kujtim të dy Profetëve të nderuar, të cilët luftuan kundër mohimit të besimit. Vula e Profetit në librat e tij është një simbol i cili është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ky simbol paraqet Kur'anin (Shpalljen e Fundit) dhe Profetin Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Profetin e fundit. Nën dritën e udhëzimit të Kur'anit dhe Sunnetit (traditës dhe mësimëve të Profetit), autori i ve vetes si qëllim të hedhë poshtë çdo neghinë të ideologjive që mohojnë fenë dhe të thotë "fjalën e fundit" në mënyrë që ta bëjë të heshtë çdo kundërshtim ngritur kundër fesë. Ai e përdor vulën e Profetit të fundit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i cili arriti urtësinë më të lartë dhe përsosmërinë morale, si një shenjë të qëllimit të tij për të ofruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahja kanë një qëllim të përbashkët: të japin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit për të menduar mbi çështje që kanë të bëjnë me besimin, si për shembull, ekzistenca e Allahut dhe njëshmëria e Tij dhe besimi në Botën Tjetër dhe njëkohësisht të nxjerrë në pah rrënjët e kalbura të sistemeve antifetare dhe ideologjive të devijuara.

Harun Jahja gëzon një rang të gjerë lexuesish në shumë vende të botës, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, Poloni, e deri në Bosnjë, Spanjë, Brazil, Malajzi, Itali, Francë, Bullgari, e deri në Rusi. Disa nga librat e tij mund të gjenden në gjuhën Angleze, Frënge, Gjermane, Spanjolle, Italiane, Portugeze, Urdu, Arabe, Shqipe, Kineze, Dhivehi (folur në ishujt Mauritius)



Ruse, Serbo-Croate (Boshnjake), Polake, Malaje, Turke, Uygur, Indoneziane, Bengali, Daneze dhe Suedeze.

Duke qënë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Mençuria dhe sinqeriteti që i karakterizon librat e tij, së bashku me një stil të veçantë që është i lehtë për t'u kuptuar, ndikon drejtpërdrejt çdokënd që i lexon. Ata që i studiojnë me kujdes këta libra, nuk mund të mbrojnë më ateizmin apo ndonjë ideologji tjetër të devijuar apo filozofi materialiste, sepse këta libra karakterizohen nga një ndikim i shpejtë, përfundime të qarta dhe janë të pakundërshtueshëm. Edhe nëse këta njerëz do të vazhdojnë të këmbëngulin në të tyren, nuk do të jetë gjë tjetër veçse një këmbëngulje të kotë, sepse këta libra përmbysin ideologji të tilla që nga themelet. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore antifetare tashmë mbrohen ideologjikisht, falë librave të shkruar nga Harun Jahja.

Kjo është, pa dyshim, një rezultat i urtësisë dhe dritës së Kur'anit. Autori në mënyrë modeste dëshiron të shërbejë si një mjet në kërkimin njerëzor të rrugës së drejtë të Allahut. Prej botimit të këtyre materialeve nuk kërkohet asnjë përfitim material.

Ata njerëz që inkurajojnë të tjerët për të lexuar këto libra, për të hapur mendjet dhe zemrat e tyre dhe për t'i udhëzuar ata të bëhen robër të devotshëm të Allahut, kryejnë një shërbim të paçmuar.

Njëkohësisht, do të ishte një humbje kohe dhe energjie për të reklamua libra të tjerë, të cilët krijojnë çoroditje në mendjet e njerëzve, i shpien ata në kaos ideologjik dhe që nuk kanë një ndikim të fortë dhe preçiz në largimin e dyshimit prej mendjeve të njerëzve, siç është vërtetuar nga përvoja e përparshme. Për librat që janë shkruar vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah fuqinë letrare të shkrimtarit se sa qëllimin fisnik për t'i shpëtuar njerëzit nga mungesa e besimit është e pamundur që të kenë një ndikim kaq të madh. Ata që e venë në dyshim këtë mund të shohin qartë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjasë është të mposhtë mosbesimin dhe, njëkohësisht, të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi shfaqen qartë në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet parasysh: Arsyeja kryesore për vazhdimin e mizorisë, konflikteve dhe telasheve të tjera që po përjetojnë shumica e njerëzve sot është mbizotërimi ideologjik i mosbesimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të tij dhe, njëkohësisht, duke transmetuar mrekullitë e krijimit dhe moralin e Kur'anit, në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke patur parasysh gjendjen e botës sot, që po precipiton në një spirale dhune, korrupsioni dhe lufte, është e qartë se ky shërbim duhet të jepet shpejt dhe në mënyrë të suksesshme, përndryshe, do të jetë tepër vonë.

Në këtë drejtim, librat e Harun Jahjasë marrin një rol udhëheqës. Me lejen e Allahut, këto libra do të jenë një mjet, nëpërmjet të cilit njerëzit në shekullin e XXI do të gjejnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

Për lexuesin

Të gjithë librat e Harun Jahjasë shpjegojnë tema që kanë lidhje me besimin nën dritën e vargjeve kuranore dhe i ftojnë lexuesit të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë në përputhje me to. Të gjitha çështjet në lidhje me ajetet kuranore janë shpjeguar në mënyrë që të mos lihet vend për dyshim apo për pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i thjeshtë dhe i rrjedhshëm i librave bën të mundur që çdo njeri i çfarëdo moshe qoftë dhe i çfarëdo grupi shoqëror t'i kuptojë ata me lehtësi. Falë shpalosjes së tyre mbresëlënëse dhe të ndritshme, ata mund të lexohen me një frymë. Madje, edhe ata njerëz që e refuzojnë besimin ndikohen nga faktet që dokumentojnë këta libra dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

Ky libër, po ashtu, të gjithë librat e Harun Jahja mund të lexohen vetëm ose të diskutohen në grup. Lexuesit e etur për të përfutur nga librat do të zbulojnë se diskutimi është mjaft i dobishëm dhe u mundëson atyre të shkëmbejnë mendimet dhe përvojën e tyre me të tjerët.

Një shërbim i madh për Islamit do të ishte ndihma në botimin dhe leximin e këtyre librave shkruar vetëm për hir të Allahut. Të gjithë librat e Harun Jahjasë janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, për t'ia komunikuar të tjerëve fenë e vërtetë, një nga mënyrat më të dobishme do të ishte nxitja për të lexuar këta libra.

Shpresojmë se, lexuesi do t'i hedhë një sy përmbledhjeve të librave të tjerë të autorit, të cilat janë vendosur në pjesën e pasme të këtij libri. Lënda e tij e pasur në çështjet e besimit është mjaft e dobishme dhe të sjell kënaqësi në lexim.

Në këta libra, ndryshe nga librat e tjerë, janë mënjanuar tërësisht pikëpamjet personale të autorit, shpjegimet e bazuara në burime të dyshimta, stile që nuk i kushtojnë kujdesin e duhur temave fetare, dhe as argumente të pashpresë apo pesimistë, të cilët krijojnë dyshime në mendjen e lexuesit dhe mosbesim në zemrat e tyre.

PËRMBAJTJE

Parathënie	9
Allahu i përgjigjet lutjes së secilit lutës	12
Allahu e shton bekimin e Tij mbi ata që janë mirënjohes	20
Sekretet e besimit të njërit në fatin dhe mbështetja e Tij në Allahun	24
Në çdo ngjarje ka të mira	28
Allahu e turbullon të kuptuarit e jobesimtarëve	32
Allahu shpërndan kuptimin në ata që i frikohen Atij	35
Ata që bëjnë mirë takojnë mirësinë	37
Në fytyrat e besimtarëve ka shkëlqim, por në fytyrat e jobesimtarëve ka turpërim	42
Sekreti që Allahu i fshin punët e këqija	44
Qëllimi i shenjët në shpenzimin në rrugën e Allahut	48
Efekti i punëve të mira dhe fjalëve të mira	54
Sekreti që Allahu i pajisë njerëzit me vend	56
Allahu sigurisht u ndihmon atyre të cilët e ndihmojnë fenë e tij ..	58
Përçarjet shkaktojnë humbjen e fuqisë	62
Vetëm në përkujtimin e Allahut zemrat gjejnë kënaqësi	65
Dinakëria e djallit është e dobët	67
Dëgjimi i shumicës e largon njeriun nga udha e drejtë	70
Sekretet në zgjerimin dhe zvoglimit të bekimeve	72
Bindja ndaj të dërguarit është bindje ndaj Allahut	74

Një numër i vogël i besimtarëve mund ta mposht shumicën jobesimtare	81
Allahu e bënë fenë e tij më të lartë kur ndonjëri e adhuronë vetëm atë	85
Jeta e kësaj bote është në fakt shumë e shkurtër	88
Në zemrat e jobesimtarëve Allahu hedh frikë	90
Urtësia dhe fjalimet bindëse janë bekim nga Allahu	92
Njeriu gjithashtu do të përgjegjet për mendimet dhe qëllimet e tij .	94
Allahu është ai i cili vendos dashurinë në zemërat e njerëzve ...	97
Vdekja e besimtarëve dhe jobesimtarëve nuk do të jetë e njëjtë ..	99
Lutja e largon njeriun nga e keqja	102
Ata që janë mbytur në rrugën e Allahut nuk janë të vdekur	104
Allahu është dhuruesi i nderit	106
Sekretet e zbulimit të rrugës së drejtë	108
Uni i njeriu urdhëron punë të këqija	112
Sekretet e begatisë dhe pasurisë të caktuara për njerëzit	115
Sekreti se pse Allahu nuk i dënon menjëherë jobesimtarët	118
Përfundim	120
Mashtrimi i evolucionit	122
Shënime	146

PARATHËNIE



Ka shumë njerëz të cilët nuk besojnë në Kur'an pavarësisht nga pretendimet e tyre se janë besimtar të vërtetë. Ata e kalojnë jetën e tyre duke u kapur për iluzione dhe e jetojnë jetën e tyre me kundërshtime dhe pamjaftueshmeri, refuzojnë të pranojnë se Kur'ani është udhërrëfues i tyre. Sidoqoftë vetëm Kur'ani parashikon një jetë kohore me dituri të vërtetë për çdo person dhe përmban fshehtësitë e krijesës së Allahut në formën e tij të vërtetë dhe të pastër. Çfarëdo pjese informative e cila nuk është e bazuar në Kur'an është e kundërshtueshme, dhe prandaj është një mashtrim dhe një shpresë e kotë. Prandaj ata të cilët nuk mbështeten në Kur'an jetojnë në mashtrim. Në ahiret ata do të dënohen me ndëshkim të përjetshëm.

Në Kur'an përveç lutjeve, udhimeve, ndalimeve dhe standardeve të larta të moralit, Allahu i njofton njerëzit me shumë fshehtësi. Keto janë fshehtësi me të vërtetë të rëndësishme, dhe një sy i vemendshëm mund t'i dëshmoi këto gjatë gjithë jetës së tij. Kur'ani është burimi i vetëm i fshehtësive për të gjithë njerëzit, sado inteligjent, të shkolluar apo të mprehet të jenë, kurrë nuk do të shpresojnë me gjet ndokund tjetër.

Përderisa disa njerëz nuk mund të shohin, ndërsa të tjerët kanë kuptuar disa porosi të fshehta në Kur'an, është edhe një nga fshehtësitë

e krijuara të Allahut. Ata të cilët nuk i kerkojnë këto fshehtësi të shpallura në Kur'an, jetojnë në ankth dhe veshtirsi. Për shkak të ironisë ata kurrë nuk do ta kuptojnë se pse jetojnë në kësi ankthi. Në anën tjetër, ata të cilët mesojnë për këto fshehtësi të Kur'anit, e bejnë një jetë të lehtë dhe të lumtur

Kjo është për arsye se Kur'ani është i qartë, i lehtë dhe mjaft i hapur për tu kuptuar nga çdokush. Në Kur'an Allahu thotë:

O ju njerëz, juve ju erdhi nga Allahu juaj argument dhe Ne ju zbritëm dritë të qartë. Ata që i besuan All-llahut dhe iu përmbajtën Atij (librit të Tij), Ai do t'i fusë në mëshirën (Xhennetin) e Tij dhe do t'i gradojë e do t'i udhëzojë për në rrugë të drejtë. (Nisa:174-175)

Megjithatë shumica e njerëzve, pavarsisht nga aftësia për të zgjedhur problemet më të komplikuar, kuptimin dhe vendosjen e filozofive më të mistershme dhe më të dykuptimshme në praktikë, deshtojnë të kuptojnë thjeshtësinë dhe qartësinë e Kur'anit. Sikur që ky liber shpjegon, kjo në vetveten është edhe një misterie e rëndësishme. Nga pamundësia të kuptojnë shpejtsinë natyrore të jetës në këte botë të përkohshme. Këta njerëz shkojnë për çdo ditë më afër vdekjes se pashmangshme. Fshehtësitë në Kur'an janë shërim për besimtarët përderisa ata mposhtin jobesimtarët në dyluftim, në të dy jetrat në këtë dhe në ahiret. Allahu e shpall këtë fakt në ajetin vijues:

Ne të shpallim Kur'anin që është shërim për besimtarët, kurse jobesimtarëve nuk u dhuron tjetër përpos dëshprim. (al-Isra': 82)

Ky liber shqyrton disa mesime të lidhura me ajetet që Allahu u ka shpallur njerëzimit sikur një fshehtësi. Kur një person i lexon këto ajete, dhe kur vemendja e tij është e përqendruar, ai duhet të përpiqet të zbuloi qëllimin e fshehtësisë në ngjarjet dhe të vlersoi gjithçka në dritën e Kur'anit. Atëherë, njerëzit do të kuptojnë me entuziazem së fshehtësitë e Kur'anit kontrollojnë jetrat e tyre dhe të tjerëve sikur janë ata.

Prej momentit që ndokush zgjohe në mëngjes, manifestimet e fshehtësive të shpallura nga Allahu mund të shihen. Të vij të ky përfundim; ai vetëm duhet të jetë i kujdesëshëm, të kthehet të Allahu dhe të mendoj. Atëhere, ai do të kuptoi se jeta e tij nuk është e varur nga kurrfarë ligjesh që njerëzit pamenduar adoptojnë dhe se autoritet të vetme dhe ligje të vlefshme janë ligjet e Allahut. Kjo është një fshehtësis shumë e rendsishme. Atje nuk ka asnjë te mirë në shumicen e ligjeve dhe praktikave të cilat shumica e njerëzve i kanë pranuar si të vertetat dhe të përfunduara. Si fakt thelpsor, këta njerëz janë shumë të zhgenjyer. E verteta është ajo që është shpallur në Kur'an. Çdokush që e lexon Kur'anin sinqërisht, verson ngjarjet në dritën e Kur'anit dhe të besimit, dhe jeton si përkrahës i Allahut, do t'i shohë kjartësisht këto fshehtësi. Kjo do ta dërgon të një kuptim më i mirë se Allahu është i Vetmi i Cili mban kontrollin për çdo krijesë, për çdo shpirt dhe çdo mendim. Siç thotë Allahu në ajetet në vijim:

Ne do t'u bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri që t'u bëhet e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Allahu yt është dëshmitar për çdo gjë? Vini re! Ata janë në dyshim për takimin me Allahun e tyre (me botën tjetër), e ta dini se Ai ka përfshirë me dijen e vet çdo send. (fussile 53-54)

ALLAHU I PËRGJIGJET LUTJES SE SECILIT LUTËS



Allahu, i Gjithfuqishmi, i Mëshirshmi dhe Mëshiruesi, shpalli ne Kur'an se Ai është pranë njeriut dhe do të ju përgjigjet njerzëve kur ata i luten Atij. Një prej ajeteve të shpallura është:

E kur robët e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qënë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua dhe le të më besojnë Mua. (bekare: 186)

Siç u tha në ajetin e mësipërm, Allahu është pranë çdonjërit, Ai ka dijëni për dëshirat e çdonjërit, ndjenjat, mendimet, çdo fjalë të shprehur, dhe çdo gjë të përshpëritur, bile edhe çfarë është e fshehur thell në mendjet e çdonjërit. Si pasoj e kësaj, Allahu dëgjon dhe din për çdo njëri i cili i kthehet Atij dhe i lutet Atij. Kjo është bekimi i Allahu për njerzimin, dhe manifestim i mëshires, mirësisë dhe fuqisë së pakufij të Tij.

Allahu ka dijëni dhe fuqi të pakufi. Ai është Zotëruesi i çdo gjëje në tërë gjithësinë. Çdo gjallesë, çdo gjë, prej sa duket njerzëve më të

fuqishëm deri të ata më të dobët, prej njerëzve më të varfër deri te njerëzit më të pasur, prej trupave madheshtor qiellor e deri te streha e shtazes më të imët në tokë, të gjitha i takojnë Allahut dhe të gjitha janë nën kontrollin dhe dëshirën e Tij

Një përsôn i cili ka besim në këtë të vërtetë mund t'i lutet Allahut për çfarëdo qoftë dhe mund të shpresoi se Allahu do t'i përgjigjet këtyre lutjeve. P.sh. një përsôn i cili është semur nga ndonjë smundje e pasherueshme, sigurisht do të drejtohet te të gjitha llojet e kujdesit mjeksor. Sidoqoftë, duke e ditur se vetëm Allahu e kthen shendetin, lutjet do t'i ofrohen atij për shërim. Si rrjedhim, një përsôn me disa lloje të frigës prej ankthit, mund t'i lutet Allahut për qëtsim dhe t'i largoi te gjitha llojet e frigës. Një përsôn i cili befasisht ka hasur ne vështirsi financiale të cilat nuk mund t'i kryej, mund t'i drejtohet Allahut për menjanimin e vështërsive financiale. Njeriu mund t'i lutet Allahut për numër të pakufizuar të gjërave, për tregimin e rrugës së drejt, për pranim në xhennet me besimtarët e tjerë, për një vend më të mirë në xhennet dhe shpetimin e tij nga xhehennemi me fuqin e Allahut, për shendet të mirë, dhe kështu me radhë. Kjo është çfarë Pejgamberi i Allahut (saas) ju tha shokëve të tij i tensionuar kur tha:

Doni te ju njoftoi me një armë e cila do te ju mbroi juve nga e liga e armikut dhe do te rrit ushqimin e juaj? Ata than: po, o i dërguar i Allahut . ai tha: thirrne Allahun ditën dhe natën, se namazi është arma e besimtarit¹

Megjithatë, në Kur'an është edhe një zbulim, i cili meriton vemendje në këtë pike. Sikur që Allahut thotë në Kur'an :

Njëriu (e tepron) lutet për keq, ashtu sikurse lutet për mirë, (po Allahu nuk e pranon lutjen e tij për keq); njëriu (nga vetë natyra e tij) është i ngutshëm. (isra: 11)

Nuk është çdo lutje e njeriut e dobishme. P.sh. një përsôn mund të lus Allahun për më shumë pronë e pasuri për ardhmerinë e fëmijëve të

tij. Megjithatë Allahu mund të mos shoh mirësi në këtë kërkesë. Mund të jetë se prosperiteti do t'i largoi fëmijët e tij nga adhurimi i Allahut. Ne këtë kuptim, Allahu dëgjon lutjen e këtij përsone, e pranon si një lloj të adhurimit dhe i përgjigjet në varianten më të mirë. Si alternativ, një përsone mund të lutet që të mos vonohet në një takim. Megjithatë, mund të jetë se është më mirë për të që të shkoi në atë destinacion pas kohës së caktuar, por në vend të saj ta bej të mundshme të takoi dikend që do të kontribojë diçka e cila do të jet më fitimprurëse për tërë jetën e tij . Allahu e di këtë dhe i përgjigjet lutësit, jo në formën të cilën përsone mendoj, por në mënyrën më të mirë për të. D.m.th, Allahu e dëgjon lutjen e atij përsone, por nese Ai nuk sheh mirë në lutjen e tij, atëhere Ai krijon çfarë është më mirë për të. Kjo në vetvete është një fshehtësi shumë e rëndësishme.

Kur lutja paraqitet e papërgjegjur, ata të pavetdijëshmit në këtë fshehtësi supuzojnë se Allahu nuk e ka dëgjuar thirrjen e tyre. Kjo në të vërtetë është një besim i shtrëmber i injorances sepse Allahu thotë:

Ne e kemi krijuar njëriun dhe dimë se ç'pëshpëritë ai në vetvete dhe Ne jemi më afër tij se damari (që rrah) i qafës së tij. (kaf:16)

Ai Allahu e di çdo fjalë që njëriu e flet, çdo mendim dhe çdo moment që ndokuj i takon gjatë jetes se tij. Edhe atëhere kur dikush është fjetur, Allahu e di se çfarë ai provon në ëndërr. Është Allahu i Cili krijon çdo gjë. Si pasoj, çdo here që ndokush i lutet Allahut, ai duhet ta dij se Allahu do ta pranoi lutjen e tij si adhurim dhe të besoj se Allahu do t'i përgjigjes lutjes se tij në kohën më të duhur dhe do të krijoj çfarë është më e mirë për të.

Lutja, ndonëse është formë e adhurimit të Allahut, është gjithashtu edhe një dhuratë shumë e çmuar për njerëzinë. Sepse, përmes lutjes, Allahu ia mundson njëriut të arrij çdo gjë që Allahu mendon se është e mirë dhe që është fitimprurëse për të. Allahu e shpall rëndsinë e lutjeve ne ajetin ku thotë:

Thuaj: “Allahu im as nuk do të kujdesej për ju, sikur të mos ishte lutja juaj (kur gjendeni në vështirësi, ose sikur të mos ishit të thirur të besoni), e ju përgënjështuar, andaj dënimi do t'ju jetë i pandërprerë”. (furkan: 77)

Allahu iu përgjigjet lutjes se atyre te cilët janë në nevoj dhe shqëtsim

Lutjet janë kohët kur njeriu është më së afërmi me Allahun ndihet singërisht, është koha kur njëriu e kupton afërsinë e Allahut dhe veten si rob i Allahut, ai është në nevoj për Allahun. Kjo është sepse kur dikush lutet, kupton se sa i ulët e i pafuqishem është para Allahut, dhe kupton se askush përpos Allahut nuk mund t'i ndihmoi. Singëriteti dhe çiltërsia e lutjes se ndokujt mvaret nga ajo se sa shumë ai është në nevojë. P.sh çdokush i lutet Allahut për paqë në botë. Sidoqoftë ndokush që gjindet i pashpresë në mes të luftës do të lutet më shumë dhe më seriozisht dhe më përlur Allahut. Ngjashëm, njerëzit, gjatë stuhisë në anije ose në aeroplan në rrezik të përplasjes, do t'i luten përlulisht Allahut. Ata do të jenë të singertë dhe të nënshtruar në lutjet e tyre. Allahu shpalli këtë fakt në ajetin ku thotë:

Thuaj: “Kush ju shpëton prej errësirave (trishtuese) të tokës e të detit e (nga trishtimi) ju e lutni atë haptas e fshehtas (duke thënë), nëse Ai na shpëton prej kësaj, ne do të jemi (besimtarë) mirënjohës?” (En'am: 63)

Në Kur'an Allahu e urdhron njëriun që të lutët me përlulësi:

Luteni Allahun tuaj të përlur e në heshtje, pse Ai nuk i do ata që e teprojnë. (A'raf: 55)

Në një ajet tjetër, Allahu thotë se ai i përgjigjet thirrjes se nevojëtarëve dhe të shtypurve

A është Ai që i përgjigjet nevojtarit (të mjerit) kur ai e thërret,

duke ia larguar të keqën e juve ju bën mbizotërues të tokës. A ka zot tjetër pos All-llahut? Jo, por ju shumë pak përkujtoni. (Neml: 62)

Padyshim, ndokush nuk duhet doemosdo të takoi vdekjen për me ju lutë Allahut dhe t'i lutët Atij në nevojë. Keta shembuj janë dhënë që t'i bëj njëzë të kuptojnë gjendjen shpirtërore me të cilën të lutën sinqërisht dhe të mendojnë për momentin e vdekjes, kur njëriu nuk mundet më të jet i çkujdesur dhe definitivisht t'i kthehet Allahut me sinqëritet të brendshëm. Besimtarët të cilët janë përzemësisht të terhequr te Allahu, në anën tjetër, duke qënë te vetëdëshëm për dobsitë dhe duke ndier nevojë, çdo herë kthehen sinqërisht te Allahu, edhe nese nuk janë në gjendjen “jetë a vdekje”. Kjo është një karakteristik e rëndësishme e cila i dallon prej jobesimtarëve dhe prej atyre me besim te dobët.

Mos caktimi i çfardo kufiri në lutje

Një përsone mund të kerkoj nga Allahu gjithçka mbrenda kufijve të lejueshëm (hallall). Kjo është për arsye se, siç u përmend më parë, Allahu është i vetmi sundimtar dhe pronar i tërë gjithësis; dhe nëse Ai dëshiron, Ai i jep njeriut gjithçka që Ai dëshiron. Çdo përsone që i drejtohet Allahut dhe i lutet Atij do të kreditoi forcen e Allahut me bë gjithçka dhe *‘të jetë i vendosur në kerkesë’* sikur që i dashuri ynë Pejgamberi (saas) ka thënë²: *njëriu duhet ta dijë se është lehtë për Allahun të plotsoi çdo dëshirë të tij, dhe Allahu do t'i plotsoi përsoneit çdo kerkes te tij nese ka çfardoqoftë të mirë për atë njëri në atë lutje.* Lutjet e Pejgamberve dhe besimtarëve të vërtetë të përmendur në Kur'an cakton një shembull për besimtarët për çeshtjet që mund të lusin Allahun. P.sh. Pejgamberi Zekrija (as) ju është lutur Allahut për trashigimtar të kënaqshëm dhe, Allahu ju përgjegj lutjes së tij, pa marr parasysh se gruaja e tij ishte sterile:

Kur ai iu lut Allahut të vet me një zë të ulët, e Tha: “Allahu im! Vërtet, mua më janë dobësuar eshtrat, më janë përhapur thinjat në kokën time, e me lutjen time ndaj Teje o Allahu im, asnjëherë nuk kam qënë i dëshpëruar”.Unë ua kam frikë pasardhësve të mi pas meje (kushërinjve se do ta humbnin fenë), ndërsa gruaja ime është sterile, pra më falë nga ajo mirësia Jote një pasardhës (një fëmijë).Të më trashëgojnë mua dhe t'i trashëgojë ata nga familja e Jakubit, dhe bërë atë, o Zot, të këndshëm! (të vyeshëm)!” (Merjem: 3-6)

Allahu ju përgjigj lutjes së Pejgamberit Zekrijaha dhe i dha atij lajmin e mirë për Pejgamberin Jahja (as) pasi që i pranoi lajmet e reja për djalin, Pejgamberi Zekrijaha ishte i befësuar pasi që gruaja e tij ishte sterile. Përgjegjëja e Allahut, Pejgamberit Zekrijaha, (as) zbulon një fshehtësi të cilën besimtarët duhet gjithmonë ta mbajnë në mend:

Ai tha: “Allahu im, si do të kemë unë djalë kur gruaja ime ishte që nuk lind, e unë kam arritur pleqëri të thellë?” Tha: “Ja, kështu Allahu yt ka thënë: se ajo për Mua është lehtë; Unë të krijova më parë ty, që nuk ishe fare!” (Merjem: 8-9)

Ka shumë Pejgamber te cilët përmenden në Kur'an të cilve ju dhanë përgjegjëje në lutje. P.sh. Pejgamberi Nuhi (as) e luti Allahun të u sjell vuajtje popullit të tij, të cilët e humben rrugen e drejt pavarishtë nga përpekjet më të mira të tij për t'i udhëqur ata për rrugën e drejt. Si përgjegjëje lutjes se tij Allahu solli një denim të madh në ta, i cili hyri në histori.

Pejgamberin Ejubi (as) thirrri Allahun e tij për arsye te smundjes, duke thënë:

“Më gjeti belaja, e Ti je më Mëshiruesi ndër Mëshiruesit!”(el enbija:83)

Përgjigjëja Profetit Ejub është shpallur si vijon:

Ne iu përgjegjëm atij nga mëshira e Jonë, ia hoqëm ato vështirësi që i kishte, i dhamë familjen e tij dhe aq sa ishin ata, dhe e bëmë përkujtim për të devotshmit. (el enbija:84)

Allahu ju përgjigj Pejgamberit Sylejmanit (as) i cili u lutë:

Tha: “Allahu im, më fal (gabimin), më dhuro asi pushteti që askush pas meje nuk do të ketë; vërtet, Ti je dhuruesi më i madh. (sad; 35)

Dhe Allahu i dhuroi pasuri dhe fuqi të madhe.

Prandaj, ata te cilët luten duhet të kenë në mendjët e tyre ajetin:

Kur Ai dëshiron ndonjë send, urdhëri i Tij është vetëm t'i thotë: “Bëhu!” Ai menjëherë bëhet. (ja sin:82)

Siç thuhet në ajet çdo gjë është e lehtë për Allahun dhe Ai dëgjon dhe dinë çdo lutës.

Allahu ju jep bekim në këtë botë atyre që e deshirojnë, por në jetën e ardhshme ata do të vuajnë një humbje të rëndë

Deshirat e atyre të cilët nuk fshehin një frikë të rrënjosur thellë në zemrat e tyre nga Allahu dhe munges të një besimi të thellë, në jetë e ardhshme janë të drejtuar pa fjalë. Ata luten për pasuri, pronë dhe pozitë vetëm për jetën në këtë botë. Allahu na informon neve se ata të cilët e deshirojnë vetëm këtë botë nuk do të kenë shpërblim në botën e ardhshme. Besimtarët, në anën tjetër, luten për të dy botërat, për këtë dhe për ahiret, pasi që ata besojnë se jeta në botën e ardhshme është e vertetë dhe është afër sikur kjo jetë. Ne këtë Allahu thotë:

Ka disa prej njërëzve që thonë: “Allahu ynë, na jep Ti neve në këtë botë!” për të nuk ka asgjë në botën tjetër.E, ka prej tyre asish që thonë: “Allahu ynë na jep të mira në këtë jetë, të mira edhe në botën tjetër, dhe na ruaj prej dënimit me zjarr!”Të tillët e kanë

**shpërblimin nga ajo që e fituan. All-llahu është i shpejtë në llogari.
(bekare:200-202)**

Besimtare, gjithashtu, lutem për shendet, pasuri, dituri dhe lumturi. Sidoqoft lutjet e tyre bartin synimin që ta kënaqin Allahun dhe kanë diçka që ka të bëjë me fenë (*dinin*). Ata lutem për pasuri, më qëllim, që ta përdorin në rrugën e Allahut. Duke ju falenderuar kësaj, Allahu i jep shembull Pejgamberit Sylejmanit (as) në Kur'an. Larg prej qëllimit për këtë botë, lutja e Pejgamberit Sylejmanit (as) për një posedim të pashembullt, ishte vetem për qëllim fisnik që t'i shfrytzoj në rrugën e Allahut, duke i thirrur njëzëti në fenë e Tij, dhe mbajtjen e vetvetës të zënë në përkujtim të Allahut. Fjalet e Pejgamberit Sylejmanit (as) të shpallura në Kur'an paraqesin këtë qëllim të sinqërtë:

E ai tha: “Unë i dhashë përparësi dashurisë së kuajve, ndaj Allahut tim, (sad:32)

Allahu iu përgjigj pikërisht kësaj lutje të Sylejmanit, i dha atij një pronë të madhe dhe e shpërbleu atë me bekimet e jetës së ardhshme. Në anën tjetër, Allahu gjithashtu ua plotson dëshirat e atyre të cilët e duan vetëm jetën e kësaj bote, sidoqoftë, një denim i vështirë i pret ata në ahiret. Bekimin të cilin nuk e kanë në këtë botë do të jetë i pranishëm për ta edhe në ahiret. Ky fakt me rëndësi është treguar në Kur'an si vijon:

Kush është që dëshiron fitimin e botës tjetër (ahiretin), Ne do t'ia shtojmë fitimin e tij, e kush e dëshiron vetëm fitimin e kësaj bote, Ne ia japim, po në botën tjetër ai nuk ka hise.(Esh-Shura':20)

Kush është që ka për qëllim vetëm këtë botë, Ne atij që duam i japim në të aq sa duam, e pastaj atij i bëjmë të hyjë në xhehennem i nënçmuar, i përbuzur. (Isra':18)

ALLAHU E SHTON BEKIMIN E TIJ MBI ATA QË JANË MIRËNJOHES



Cdo person është nevojtar për Allahun në çdo moment të jetës. Prej ajrit që e thith dhe ushqimit që e han, prej mundësisë se shfrytzimit të kontrollit të dikujt e deri të aftsia për të folur, prej të qënit i sterhuar e deri te të qënit një shpirt i lumtur. Njeriu jeton plotësisht nga ajo se çka Allahu ka krijuar dhe përgatit për të. Prapëseprap, shumica e njerëzimit nuk e kuptojnë dobësinë e tyre dhe se ata janë nevojtarë për Allahun. Ata supozojnë së gjerat zhvillohen ngadal ose se ata sigurojnë çdo gjë vetëm me mundin e tyre. Ky është një gabim i madh, gjithashtu edhe mosmirënjohje për Allahun. Ironikisht, njerëzit të cilët i japin falënderimet e tyre për një dhuratë të parëndësishme, harxhojnë tërë jetën e tyre duke injoruar bekimet e panumërta të cilat Allahu ua jep atyre gjatë jetës së tyre. Sido që të jet, aq të mëdha janë të mirat që ju janë dhanë një personi, sa që ai kurrë nuk do të mund t'i numëroi ato. Allahu e tregon këtë fakt në ajetin:

Po edhe nëse përpiqeni t'i numëroni dhuntitë (të mirat) e All-

llahut, nuk do të mund të arrini t'i përcaktoni ato. Me siguri All-llahu shumë fal dhe shumë mëshiron. (Nahl: 18)

Pavarsisht nga ky fakt, shumica e njerzve harroin të falenderojnë për ndonjëren nga këto të mira që ata kanë. Arsyeya për këtë është treguar në Kur'an: djalli, i cili premtoi se do t'i largoi njerëzit prej rrugës së Allahut, tha se dëshira themelore e tij është me i shti njerëzit që të jenë jofalenderues ndaj Allahut. Paraqitja mospërfillëse e djallit te Allahu shpreh rëndësinë e falënderimit Allahun:

Mandej, do t'ju sillem atyre para, prapa, nga e djathta dhe nga e majta e tyre, e shumicën e tyre nuk do ta gjejsh që të falënderohen (të besojnë)!” (All-llahu) Tha: “Dil nga ai (Xhenneti), i urrejtur, i dëbuar. Kush prej tyre vjen pas teje, Unë kam për ta mbushur Xhehennemin me të gjithë ju. (A'raf: 17-18)

Besimtarët, në anën tjetër, në vetdije të dobsis se tyre dhe me përulje para Allahut, shprehin falënderimet e tyre për çdo të mirë të dhuruar nga Allahu. Pasuria dhe posedimi nuk janë te vetmet te mira për te cilat besimtarët e falënderojnë Allahun e tyre. Duke ditur se Allahu është Pronari dhe Poseduesi i çdo gjëje, besimtarët e shprehin mirënjohjen e tyre të brendshme për shendet të mirë, bukuri, dituri, mençuri, dashuri ndaj besimit dhe urrejtje ndaj mosbesimit, për te kuptuarit, mendjehollsinë, largpamësinë dhe për aftësië. Ata janë falënderues që janë të udhëzuar drejt dhe që janë në shoqëri me besimtarët. Një pamje të bukur, manovrim i lehtë me punët e tyre, përmbusheje të dëshirave të tyre, njoftime për gëzime të mëdha, drejtues i respektueshëm apo çfardo e mirë tjetër e bën besimtarin që menjëherë të kthehet të Allahu, t'i shprehë mirënjohjet e tij ndaj Allahut dhe reflektohet në faljen dhe mëshirën e Tij.

Si përgjigjëje për morale të mira të shfaqura, besimtarët i pret shpërblimi. Ky është edhe një nga sekretet e treguara në Kur'an: Allahu i rritë të mirat e Tij në ata të cilët janë mirënjohes. P.sh. Allahu u

dhuron edhe ma shumë shendet dhe forcë për ata të cilët i paraqësin falënderimet e tyre te Allahu për shendet të mirë dhe forcë që kanë. Allahu u jep edhe më shumë dituri dhe pasuri atyre te cilët janë mirënjohes për diturinë dhe pasurin e tyre. Kjo është për arsye se ata janë njerëz të sinqertë të cilët janë të kënaqur me çka Allahu jep dhe janë të kënaqur me të mirat dhe të cilët e marrin Allahun si shok të tyre. Allahu e tregon këtë sekret në Kur'an si vijon:

Dhe (përkujtoni) kur Allahu juaj njoftoi bindshëm: “Nëse falënderoni, do t'ua shtojë të mirat, e nëse përbuzni, s'ka dyshim, dënimi Im është i vështirë!” (Ibrahim: 7)

Të qenit mirënjohes është gjithashtu edhe shenjë e afërsisë dhe dashurisë së ndonjërit te Allahu. Njëziti të cilët falënderojnë kanë mendjehollsinë dhe mundësinë e pranimit të bukurive dhe të mirave që Allahu krijon. I derguari i Allahut (saas) gjithashtu na drejton te kjo kur ai tha:

Kur Allahu të ju jep pasuri, hareja e dhuratave dhe të mirave të Allahut duhet të reflektohet të ju³

Në anën tjetër, një përsosur dhe jomirënjohes do të shoh vetëm papërsosuri dhe gabime madje edhe në ambientin natyror më të bukur, prandaj do të jetë i palumtur dhe i pa kënaqur. Në të vërtetë, sikur një qëllim i parëndësishëm në krijimin e Allahut, këta njerëz, gjithmonë vijnë në kontakt me siç duket rrethana të papërshtatshme dhe ngjarje të pakëndshme. Në anën tjetër, Allahu shfaq më shumë bujari dhe të mira të Tij në ata të cilët kanë një sinqeritet dhe mendjehollësi në botëkuptimet e tyre

Se Allahu i rrit të mirat e Tij në ata të cilët janë mirënjohës është një nga sekretet e Kur'anit. Megjithatë, njeriu duhet ta ketë në mendje se sinqeriteti është një kusht paraprak për të qenë mirënjohës. Pa dyshim, udha e ndonjërit për të treguar mirënjohjen e tij pa u drejtuar sinqerisht te Allahu dhe duke ndier se paqja e brendshme e faljes dhe mëshirës së

pakufij të Allahut, e cila është vetëm për të impresionuar njerëzit, do të jetë e dukshme mungesa e sinqeritetit. Allahu e dinë çka zemra fsheh, dhe do të jetë dëshmitare për josinqeritet. Ata te cilët kanë synime të brendshme të josinqerëta mund t'i fshehin prej njerëzve, por jo prej Allahut. Njerëzit e tillë mund të shfaqin falënderimin e tyre me sjellje të rreme kur nuk ka sëmundje, por në kohërat e vuajtjeve, është e mundëshme që ata mund lehtë të kalojnë në mosmirënjohësa.

Kjo do të jetë e njohur gjithashtu së besimtarët e vërtetë mbesin mirënjohës ndaj Allahut edhe në kushtet më të veshtira. Ndonjëri që shikon nga jashtë mund të shohë se zvoglimi i disa të mirave e gëzojnë besimtarin. Mirëpo, besimtarët, të cilët janë të aftë të pranojnë aspektet e mira të çdo ngjarje dhe situatë, shohin të mira edhe në këtë. Psh, Allahu thotë se Ai do t'i sprovovë njerëzitë me frikë, uri dhe humbje të shendetit ose jetës. Në këso situatash, besimtarët gezohen dhe ndjenë mirënjohje, duke shpresuar se Allahu do t'i shpërblejë ata me të mira të xhennetit si kompensim për patundëshmerinë e tyre që e treguan në sprovë. Ata e dinë se Allahu nuk e ngarkon asnjërin më shumë se që ai mund të durojë. Palekundëshmeria dhe bindja për një dituri të ketillë i bënë ata të jenë të qetë dhe mirënjohës. Prandaj, është një veti e qartë e besimtarëve të tregojnë një dedikim dhe premtimi të paluhatëshëm dhe Allahut ka premtuar të zgjerojë të mirat e Tij në robërit e Tij mirënjohës në të dy botërat, në këtë dhe në ahiret.

SEKRETET E BESIMIT TË NJËRIT NË FATIN DHE MBËSHTETJA E TIJ NË ALLAHUN



Mbështetja në Allahun është një cilësi e veçantë e besimtarëve të cilët kanë besim të thellë, të cilët mund të çmojnë fuqinë e Allahut, dhe të cilët janë të afërt me Allahun. Ka sekrete të rëndësishme dhe të mira në mbështetjen në Allahun. Mbështetja në Allahun nënkupton një bindshmëri dhe besim të caktuar në Allahun dhe në fatin që Ai e krijon. Allahu i ka krijuar të gjitha krijesat, shtazët, bimët, sikur që i ka krijuar edhe sendet e pa jetë -- secilin me synimin ose fatin e tij. Dielli, hëna, detrat, liqenjët, drunjët, lulet, milingonen e vogël, çdo gjethë që bjen, çdo njëren grimcë të pluhurit në tavolinen tënde, një gurë në të cilin ti merr thue, këmishen të cilën ti e ke blerë dhjetë vjet më parë, pjeshkën në frigoriferin tënd, nënën tënde, shokët e tu të shkollës fillore, ty -- me pak fjalë çdo gjë ka fatin e tij i cili është paracaktuar miliona vite më parë në shikimin e Allahut. Fati i çdo krijese është i shënuar në libër, i

cili është quajtur në Kur'an "Nëna e Librit". Momenti i vdekjes, momenti i rëmjes së gjethës më të imët, momentin kur pjeshka në frigoriferin tënd fillon të kalbet, dhe të gjitha fazat e gurit gjer sa ti merr thua në të- me pak fjalë, çdo ngjarje, e rëndësishëme ose e parëndësishëme - është e shënuar në këtë libër.

Besimtarët kanë besim në fatin dhe ata e dijnë se Allahu e ka krijuar fatin e tyre në variantën më të mirë për ta. Kjo është pse, në çdo moment të jetës së tyre, ata mbështeten në Allahun. Me fjalë të tjera, ata e dijnë se Allahu krijon të gjitha ngjarjet me pajtim me qëllimin e parashikuar dhe se ne çkado që Allahu krijon ka të mira. Psh ngjitja e ndonjë sëmundje vdekjeprurëse, konfrontimi me një armik të pamëshirëshëm dhe të papëlqyeshëm, të qenit i nënshtruar akuzimeve të pavërteta pavarësisht nga ajo se jeni i pafajshëm, ose takimin me ngjarjet më trishtuese që ndokush mund t'i paramendojë, nuk e levizin besimin e besimtarëve as që shkakton ndonjë frikë në zemrat e tyre. Ata e mirëpresin çka Allahu ka krijuar për ta. Besimtarët nxjerrin kënaqësi të madhe për takimin e situatave të cilat zakonisht i tmerrojnë ose ju sjellin dëshprim jobesimtarëve. Kjo është për arsye se edhe skenari më tmerrues është planifikue përpara prej Allahut për me i sprovue ata. Ata të cilët ju përgjigjen këtyre situatave me palëkundëshmeri dhe mbështeten në Allahun dhe në fatin që Ai krijon, do të meritojnë dashuri dhe përfitime të kënaqësive të Allahut. Ata e fitojnë xhennetin për gjithmonë. Prandaj, besimtarët pëlqejnë komoditetin dhe kënaqësinë në mbështetjen në Allahun gjatë tërë jetës së tyre. Kjo është një e mirë dhe sekret që Allahu u a zbulon besimtarëve. Allahu thotë në Kur'an se:

Atëherë mbështetu në All-llahun, se All-llahu i do ata që mbështeten (Ali-Imran: 159)

Pejgamberi i Allahut (saas) gjithashtu e ka theksuar këtë kur ai tha:
Një robë i Allahut nuk ka besim të vertetë përderisa ai te mos besojë

*në fatin (me anët e mira dhe të këqija të tij) dhe të dijë se ai nuk mund të parandalojë diçka që i ndodh atij (e mirë e keqe) dhe se ai nuk mund të nxen diçka që i ka kaluar (e mirë e keqe)*⁴

Edhe një pikë e përmendur në Kur'an për mbështetjen në Allahun është ‘marrja e paramasave’. Kur’ani na informon neve për paramasa të shumta të cilat besimtarët mund t’i marrin në situata të ndryshme. Në shumë ajete, Allahu gjithashtu tregon sekretin se ato paramasa të cilat janë pranuar si formë e adhurimit ndaj Allahut, nuk mund ta ndrojnë fatin. Profeti Jakubi (as) i ka këshillua bijët e tij që të marrin disa paramasa gjersa të hyjnë në qytet, por pastaj ai ja u përkujtojë atyre që të mbështeten në Allahun. Ky ajetë i përshtatshëm është si vijonë:

Po ai (Jakubi) tha: “O bijt e mij, mos hyni (në Egjipt) për një derë, po hyni nëpër dyer të ndryshme. Unë nuk mund të largoj prej jush asnjë send nga caktimi i All-llahut, vendimi nuk është i tjetërkujt vetëm i All-llahut, vetëm Atij iu kam mbështetur dhe vetëm Atij le t’i mbështeten ata që besuan. (Jusuf: 67)

Sikur që shihet nga fjalet e Profetit Jakubit (as) besimtarët pa dyshimë marrin masa paraprake, por ata e dinë se nuk mundën të ndrojnë atë që Allahu e ka vendosur për ta. Psh një person duhet t’i respektojë rregullat e trafikut e jo të vozisë pa kujdes. Kjo është një paramasë e rëndësishme dhe një formë e adhurimit e kryer për jetën e tij por edhe për të tjerëve. Sidoqoftë, nëse Allahu ka vendosur që ai person të vdesë në aksident të veturës, kurrfarë paramasash nuk mund të mirren që ai të shpetojë. Nganjëherë një veprim paraprak mund të duket se atij personi i ka mundësuar të shpetojë nga vdekja. Ose dikush mund të marr një vendim kritik, i cili e ndërron tërë anën e jetës së tij; ose dikush mund të shpetojë nga një sëmundje vdekjeprurëse duke treguar forcën dhe rezistencën e tij. Sidoqoftë, të gjitha këto ndodhin për arsye se Allahu e ka urdhëruar kështu. Disa njëzëz i keqinterpretojnë ngjarjet e tilla si ‘kapërcim i fatit të ndonjërit’ ose ‘ndryshim i fatit të

ndonjërit”. Por, kurrkush, as edhe ai person që duket më i fuqishmi dhe më i vendosuri në botë, nuk mund të ndrojë atë që e ka urdhëruar Allahu. Asnjë njëri nuk ka asi fuqie. Në të kundërtën, çdo gjallesë është e pafuqishme përpara urdhërit të Allahut. Fakti se disa persona nuk e pranojnë faktin, nuk e alarmon të vërteten. Në fakt, mohimi i fesë nga ata është urdhëruar gjithashtu. Allahu e shpallë këtë në Kur’an si vijonë:

Nuk ndodh asnjë fatkeqësi në tokë e as në trupin tuaj, e që të mos jetë në shënime (libër - Levhi Mahfudh) para se të ngjajë ajo, e kjo për All-llahun është lehtë. Ashtu që të mos dëshproheni tepër për atë që u ka kaluar, e as të mos gëzoheni tepër me atë që Ai u ka dhënë, pse All-llahu nuk e do asnjë arrogancë që u lavdërohet të tjerëve. (Hadid: 22-23)

Siç u tha në ajetin e mësipërm, çdo ngjarje që ndodhë është e paracaktuar dhe e shkruar në libër në shikimin e Allahut. Prandaj, Allahu i thotë njëriut mos të ankohet për atë që ka mund t’i ketë kaluar atij. Psh një person që e humbë tërë pasurinë e tij në zjarr apo në një sprovë eksperimentale tregtare, kjo humbje është sepse ashtu është vendosur, është e pamundshme për të që të pengojë që keto të ndodhin. Kështu që, do të ishte e pakuptimtë që të ketë arsye për ankime në këso humbje. Allahu i sprovon njerëzit me ngjarje të ndryshme të cilat janë vendosur për ta. Ata të cilët mbështeten në Allahun kur të takojnë asi ngjarjesh fitojnë kënaqësi dhe dashurinë e Allahut. Ata të cilët nuk mbështeten në Allahun, në anën tjetër, kurrë nuk do të lirohen nga problemet, shqetësimet dhe hidhërimet gjat tërë jetës së tyre në këtë botë, dhe do të jenë të dënuar përgjithmonë në ahiret. është e qartë si kristali se mbështetja e ndonjërit në Allahun është dobi dhe rahatimi në të dy botrat në këtë dhe në ahiret. Me anë të shpalljes së këtyre sekreteve besimtarëve, Allahu i ka lehtësuar ata nga veshtirësitë dhe i ka shpërblyer në sprovën e tyre në këtë botë me jetë të lehtë.

NË ÇDO NGJARJE KA TË MIRA



Allahu na informon neve se Ai krijon çdo ngjarje me të mira në të. Ky është edhe një sekret që e bën të mundshme për besimtarët të mbështeten në Allahun. Allahu thotë se edhe sendet të cilat duken të pafavorshme kanë shumë të mira në to:

... bëni durim që All-llahu të japë shumë të mira në një send që ju e urreni. (Nisa': 19)

... Por mund që ju ta urreni një send, e ai është shumë i dobishëm për ju, dhe mund që ju ta doni një send, e ai është dëm për ju. All-llahu di (fundin e çdo sendi) e ju nuk dini. (Bakare: 216)

Të vetëdijëshëm nga ky sekret, besimtarët kërkojnë të mira dhe bukuri në çdo ngjarje. Jo siç duket ngjarja e kundërt, mundimi ose ligështia i shqëtëson ose i brengosë ata. Ata vazhdojnë vetëpërmbajtjen e tyre edhe nese ekspërienca e tyre është e parëndësishme ose një përvojë serioze e rëndë. Muslimanët e sigurtë shohin të mira dhe qëllim hyjnor bile edhe në humbjen e tërë pasurisë së tyre të fituar në mënyrë të vështirë. Ata shprehin mirënjohje Allahut për dhurimin e

jetës. Ata besojnë se Allahu i ka mbrojtur ata prej bërjes se ndonjë akti të keq ose kundër lidhjes së madhe për pasuri. Prandaj, ata i shprehin falënderimet më të thella Allahut për arsye se çfardo humbje në këtë botë nuk krahasohet me humbjen në ahiret. Humbja në ahiret nënkupton dënim të përjetshëm dhe të padurueshëm. Këta të cilët e përkujtojnë vetën me ahiret, në çdo ngjarje shohin të mira dhe bukuri të cilat i drejtojnë në ahiret. Këta të cilët i tejkalojnë këto prova të rënda do t'i njohin dobësitë e tyre përpara Allahut, dhe do të rishikojnë sa shumë kanë nevojë për Allahun. Ata do të drejtohen te Allahu me më shumë përulesë gjatë lutjeve dhe ai përkujtim do t'i afrojë ata më afër Tij. Kjo sigurisht është një fitim i pa masë për ahiretin e përsosur. Këto, duke u mbështetur absolutisht në Allahun dhe duke treguar palëkundshmëri, ata do të fitojnë kënaqësinë e Allahut dhe do të shpërblehen me lumturi të përherëshme .

Njëri duhet të kërkojë të mira dhe bukuri jo vetëm në prova të rënda, por gjithashtu në zakonshmerit ditore. P.sh. duke djegur ushqimin, në mënyrë të përpikët mund ta qojë atë përsosur me marr paramas të shumta të cilat do të parandalojnë, me dëshirën e Allahut, një aksident më serioz në të ardhmën. Një i ri mund të dështojë nga një provim për pranim në fakultet, ai i ka humbur shpresat e tij për të ardhmen. Ai duhet, megjithatë, ta dijë se në deshtimin e tij ka të mira, gjithashtu; ai duhet të jetë i aftë të mendojë se Allahu mund të ketë dashur që ai të shmanget prej disa kushteve ose njërzve të pafavorshëm dhe në këtë mënyrë të ndihet i kënaqur me rezultatin. Si alternative, me mendua se Allahu në çdo ngjarje ka vendosur shumë të mira të cilat ose janë të dukshme ose janë larg nga imagjinata, besimtarët shohin bukuri në nënshtrimin e plot në udhëzimin e Allahut.

Një përsosur mund të mos shohë gjithmonë të mira dhe qëllime të shenjta prapa çdo ngjarje. Madje edhe nëse kjo është çështja, ai e dinë se në çdo ngjarje ka të mira padyshim. Ai paraqet lutjet e tij për Allahun

që t'i tregoj atij për çdo të mirë dhe qëllimë të shenjët të fshehur prapa çdo ndodhie.

Ata të cilët janë të vetëdijëshëm se çdo gjë ka qëllimin e krijimit të Allahut kurrë nuk i përdorin fjalët e kota “sikur të mos e kish bërë atë...” ose ”sikur të mos kisha thënë”etj. Gabimet, të metat ose siç duken ngjarjet e pafata para se gjithash përfshijnë te mira dhe secila prej tyre janë sprova te fatit. Allahu jep mesim të rëndësishëm dhe përkujtim për njëriun në fatin që e krijon për çdo person individualisht. Për ata të cilët mund të vlersojnë me mendjehollësi, nuk ka asnjë gabim ose fatëkeqësi, por mësim, paralajmërim dhe urtësi prej Allahut. P.sh. një musliman të cilit i digjet lokali do të kerkoj shpirtin e tij, dhe do të bëhet edhe më i sinqertë dhe më besnik në besimin e tij, duke menduar se ishte paralajmërim prej Allahut kundër kënaqsisë dhe dashurisë së tepërt me të mirat e botës.

Vazhdimisht, pa marrë parasysh se çka ndonjëri has në jetën e tij, provat e veshtira do të marrin fund të gjitha përfundimisht. Një person i cili përkujton një vuajtje do të jetë i habitur se nuk është asgjë më shumë se një kujtim i turbullt në mendjen e tij. Kjo është gjithashtu si njërrziti i kujtojnë skenat prej filmave. Në përputhje me rrethanat, një ditë do të vij dhe ekspëriencia e dhimbjes më të madhe, do të jetë vetëm kujtim, më shumë si një paraftyrim i një skene nga një film. Vetëm një send do të jetë: qëndrimi i supozuar i personit gjatë kohës së vuajtjes dhe nëse Allahu është i kënaqur me të apo jo. Një person nuk do të thirret për llogari për ekspëriencën. Për këtë, të qenurit në orvatje për të parë të mirat dhe qëllimin e shenjët të Allahut që i krijonë në situata të cilat takohet ndonjëri dhe një qëndrimi pozitiv do t'i sjellin besimtarit lumturi në të dy botrat. As pikëllimi e as frika nuk i pret këta besimtarë të cilët janë të vetëdijëshëm për këtë sekret. Ngjashmerisht, askush, asnjë ngjarje s'mund të frikësoj, dëmtoj ose shqëtësoj në këtë ose në botën tjetër (ahiret). Allahu e tregon këtë sekret në Kur'an si vijon:

Ne u thamë: “Dilni prej aty që të gjithë, e juve gjithësesi do t'u arrijë udhëzim prej Meje, e kush pranon udhëzimin Tim, për ata nuk ka as frikë as që do të brengosen”. (Bekare: 38)

Ta keni të ditur se të dashurit e All-llahut (evliatë) nuk kanë frikë (në botën tjetër) e as kurrfarë brengosje? (Ata janë ata) Të cilët besuan dhe ishin të ruajtur. Atyre u jepen myzhde në jetën e dunjasë (në çastin e vdekjes) dhe në jetën tjetër (për shpëtim në xhennet). Premtimet e All-llahut nuk mund të pësojnë ndryshim. E, ai është sukseksi i madh. (Junus: 62-64)

ALLAHU E TURBULLON TË KUPTUARIT E JOBESIMTARËVE



Se disa njerëz nuk mund ta kuptojnë Kur'anin është njëra prej sekreteve me shumë rëndësi e shpallur në Kur'an. Kjo në të vëtetë është një sekret i rëndësishëm, për arsye se Kur'ani është një libër shumë i qartë, i lehtë dhe i hapur. Çdokush që dëshiron mund ta lexoj Kur'anin dhe të mesoj urdhërat e Allahut, moralet e mira me të cilat Ai është i kënaqur, vetitë e xhennetit dhe të xhehennemit, dhe për shumë sekrete disa prej të cilave janë shpallur në këtë libër. Megjithatë, sikur një ligj i përhershëm i Allahut, disa njerëz nuk mund ta kuptojnë Kur'anin pavarësisht nga qartësia e tij. Gjithashtu, këta njerëz mund të jenë inxhinier atomik ose profesor të biologjisë, mund të kuptojnë fusha shumë të komplikuar të shkencës siç janë fizika, kimia ose matematika, mund ta kuptojnë budizmin, hinduizmin, zjarrëputizmin, materializmin ose komunizmin, dhe prap të deshtojnë në kuptimin e Kur'anit. Këta njerëz të cilët i adoptojnë strukturat e komplikuar të sistemeve jo Kur'anore disi nuk mund ta kuptojnë fenë

e qartë dhe të lehtë të Allahut, dhe dështojnë të kuptojnë bile edhe mësimet ma të dukëshme aty.

Të qënurit e tyre të paaftë për të kuptuar bile edhe faktet ma evidente është një mrekulli në vetëvete. Duke paraqitur se ata kanë një mungesë kaq serioze në kuptimin. Allahu sqaron se disa njerëz kanë karakter tjetër. Në anën tjetër, kjo pajis me prova në faktin se të gjitha zemrat, arsyet dhe të kuptuarit janë në duart e Allahu. Allahu deklaroi se Ai do të mbuloj zemrat dhe të kuptuarit e atyre të cilët janë pushtuar prej ndjenjave të madhështisë, kjo është për ata që nuk i binden Allahut. Fakti se ata kuptojnë çdo gjë përveç Kur'anit, tregon se Allahu i ka larguar ata prej shenjave të Tij, dhe ata janë refuzuar prej Kur'anit për shkak të josingëritetit të tyre. Disa nga ajetet që flasin për këtë janë:

Kur ti e lexon Kur'anin, në mes teje dhe atyre që nuk e besojnë botën tjetër, Ne e vëmë një perde të padukshme. Ndërkaq, në zemrat e tyre vëmë një mbulesë dhe shurdhim të thellë të veshëve të tyre që nuk mund ta kuptojnë atë. E kur e përmend ti në Kur'an Allahun tënd, vetëm Atë, ata ikin mbrapa dhe largohen. (Isra': 45-46)

Ka prej tyre që ty të dëgjon (kur lexon Kur'anin). Po Ne kemi krijuar mbulesë mbi zemrat e tyre që të mos e kuptojnë atë dhe në veshët e tyre sajuam shurdhim, dhe edhe sikur t'i shohin të gjitha faktet, ata nuk besojnë, derisa kur vijnë te ti e të polemizojnë ata që mohuan thonë: “Nuk është tjetër ky (Kur'ani) vetëm se mit i hershëm.” (En'am: 25)

Kush është më zullumqarë se ai që është këshilluar me argumentet e Allahut të vet, e ua kthen shpinën atyre dhe harron atë që vetë e punoi? Ne kemi vënë mbi zemrat e tyre mbulesë në mënyrë që të mos e kuptojnë atë (Kur'anin), kurse në veshët e tyre shurdhim, andaj edhe nëse i thërret ti ata në rrugë të drejtë, ata si të tillë nuk do të udhëzohen kurrë. (Kehf: 57)

Siç u tregua në ajetet, sekreti pse jobesimtarët nuk mund ta kuptojnë Kur'anin është se Allahu e ka vendosur një pengesë për kuptimin e tyre dhe i ka vulosur zemrat e tyre për arsye të mospranimit të tyre. Kjo është një mrekulli e madhe e cila paraqet Madhësinë e Allahut dhe se Ai është poseduesi i zemrave dhe mendimeve të çdo njeriu.

ALLAHU SHPËRNDAN KUPTIMIN NË ATA QË I FRIKOHEN ATIJ



E dhe një sekret i shpallur në Kur'an është se Allahu u jep atyre që i frikohen Atij mundësinë me gjykua dhe më dallua ndërmjet të vërtetës dhe të gabuarës. Na është referuar neve sikur “urtësi”. Allahu e shpall këtë sekret në Kur'an në suren El-Enfal si vijon:

O ju që besuat, nëse keni frikë All-llahun, Ai do të vërë udhëzim (në zemrat tuaja) për ju, do t'ua mbulojë të këqiat, do t'ua falë mëkatet. All-llahu është dhurues i madh. (Enfal: 29)

Siç u shpjegua në kapitullun e përparëm, Allahu e fsheh urtësinë dhe të kuptuarit në jobesimtarët. Këta njerëz, pa marr parasysh sa intelgjent ata mund të jenë, nuk mund ta kuptojnë bile edhe konceptet më të dallueshme që i takojnë fesë. Urtësia është një veti e veçantë për besimtarët. Shumica e njerzve e marrin si të gatshme se inteligjenca dhe urtësia nënkuptojnë të njëjtën gjë. Mirëpo inteligjenca është aftësi mendore që secili e posedon. Psh të qenurit një shkenctar anatomik ose

gjeni matematikor tregon inteligjencen. Urtësia, në anën tjetër, është pasojë e frikës që një person e ka ndaj Allahut dhe zbatimi me vetëdije, dhe nuk është e lidhur në asnjë mënyrë me inteligjencën. Një person mund të jetë shumë inteligjent, akoma ai mbetet pa urtësi nëse ai nuk ka frikë nga Allahu.

Prandaj, urtësia është një bekim që Allahu ua dhuron besimtarëve. Këta të hequr nga ky lloi i të kuptuarit nuk janë bile të vetëdijëshem për situatën e tyre. P.sh, ata të cilët mendojnë se janë burimi i forcës dhe posedimit, bëhen mendjemdhën. Kjo është thjesht një tregues i mungesës së urtësisë. Sepse nëse ata kanë urtësi, ata do ta kuptojnë realitetin se asgjë s'është e fuqishme sikur Dëshira e Allahut. Kjo vetëdije në fund do ta dërgonte ndonjërin ta drejtoj veten me përpulje. Ky person, megjithatë, nuk mendon se, nëse Allahu dëshiron, e tërë pasuria e tij mund të zvoglohet në përdësi për disa sekonda, ose se ai mundet ta has vdekjen, duke lënë gjithçka mbrapa në botë dhe duke pritur zjarrin të pranojë llogaritjen. Krejt këto janë më të sigurta dhe më reale se çka ndonjëri posedon në këtë botë. Vetëm besimtarët, të cilët i frikohen Allahut, e kanë këtë kuptim, dhe nuk shkon në drejtim të natyrës mashtruese të kësaj jete në këtë botë. Ata e kalojnë jetën e tyre duke kuptuar esencën reale të sendeve. Allahu e vendos kuptimin në besimtarët përmes besimit të tyre. Aq sa ata ndihen ma afër Allahut, të kuptuarit e tyre forcohet dhe ata bëhen ma të njohur me sekretet në krijimet e Allahut.

ATA QË BËJNË MIRË TAKOJNË MIRËSINË



E dhe një sekret që Allahu e shpall në Kur'an është se ata që bëjnë mirë do të shpërblehen me të mira në të dy botërat, këtu dhe në ahiret. Për këtë Allahu thotë:

Thuaj: “O robërit e Mi që keni besuar, keni frikë ndaj Allahut tuaj. Ata që bënë mirë në këtë jetë, kanë të mirë të madhe, e Toka e All-llahut është e gjërë, ndërsa të durueshmëve u jepet shpërblimi i tyre pa masë!” (Zumer: 10)

Megjithatë, njeriu duhet ta dijë se çka është “mirësia” aktuale. Secila shoqëri e ka zhvillua kuptimin e vet për mirësinë; të qënurit i këndshëm, dhurimi i parave të varfërve, veprimi me durim ndaj çdo lloji i trajtimit shpesh është kuptuar si shenjë e “mirësisë” në shoqëri. Mirëpo, në Kur'an Allahu na informon neve se çka është “mirësia” aktuale:

Nuk është tërë e mira (e kufizuar) të ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson All-llahut, ditës së gjykimit, engjëjve, librit, pejgamberëve dhe pasurinë që e do, ua jep të afërmve, bonjakëve, të vërfërve,

udhëtarëve, lypësve dhe për lirimin e robërve, dhe ai që e fal namazin, e jep zeqatin, dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë, dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Të tillët janë ata të sinqertit dhe të tillët janë ata të devotshmit. (Bekare: 177)

Sikur që ajeti i mësipërm na e tërhjek vemendjen tonë, mirësia e vërtet është me pasë frikë prej Allahut, me mbajtë vetëveten të zënë me përkujtimin e ditës së llogarive, të bindet me ndërgjegjëje dhe gjithmonë të angazhohet në veprime të cilat do ta kënaqin Allahun. Pejgamberi i Allahut Muhammedi (saas) gjithashtu i ka urdhëruar besimtarët me ju friksuar Allahut dhe me bë mirë:

Friksonju Allahut kudo që të jeni. Bëni mirë menjëherë pas një akti mëkatar me e fshi atë, dhe gjithmonë sillni mirë në mardhënjët e juaja me njerëzit.⁵

Allahu e ka shpallur në Kur'an se Ai i don ata të cilët gjithmonë bëjnë mirë në saje të besimit të tyre dhe për frikën dhe dashurinë e tyre për Allahun, dhe shton se Ai do t'i shpërblej ata me të mira:

Ndaj All-llahua u dha atyre shpërblimin e kësaj bote dhe shpërblimin më të mirë të botës tjetër; All-llahu i do punë mirët. (Ali 'Imran: 148)

... edhe në këtë jetë kanë shpërblim të mirë, por shpërblimi i tyre në botën tjetër është shumë më i mirë, e sa vend i mirë është ai i të devotshëmve. (Nahl: 30)

Ky është lajmë i mirë i caktuar në Kur'an për ata që bëjnë mirë, të cilët janë vetëflijuesë dhe të cilët përpiqën të fitojnë kënaqësinë e Allahut.

Allahu u jep këture njerëzve lajme të gëzuëshme për jetë të mirë në të dy botërat, këtu dhe ahiret , një rritje në bekime- në të dyat materialën dhe shpirtorën. Profeti Sulejman (as) të cilit ju është dhënë një mbretiri

e tëra, që nuk ju është dhënë askujt tjetër, dhe Profeti Jusuf (as) i cili që vendosur në kompetencen e thesarit të Egjiptit, janë shembuj të dhënë në Kur'an. Allahu na informon neve për të mirat që Ai i dhuroi Pejgamberit Muhammedit (saas) në ajetin:

"dhe të gjeti të varfër, e Ai të begatoi. (Duha: 8)

Njeriu duhet ta kujtoj se një jetë e bukur dhe e famshme nuk është një bekim i cili u është dhuruar vetëm generates së hershme të besimtarëve. Allahu premton se, në çdo kohë, Ai do tu jep robërve besimtar të Tij një jetë të mirë.

Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre. (Nahl: 97)

Besimtarët kurrë nuk vrapojnë pas botës; dmth, ata nuk demostrojnë lakmi për pasurinë e kësaj bote, për pozitë ose fuqi. Sikur që Allahu thotë në një ajet: ata i kanë shitur jetrat dhe pasurinë e tyre në kompensim për xhennetin. Profesionit ose Tregtia nuk i tërheq ata prej kujtimit të Allahut, përmbushja e lutjeve dhe shërbimi për fenë. Gjithashtu, ata tregojnë përulësi dhe nënshtrim edhe kur ata janë të sprovuar me uri ose humbje të pasurisë, dhe ata kurrë nuk ankohen. Një shembull i mirë ishin besimtarët të cilët emigruan në kohën e Pejgamberit. Ata imigruan në tjetër qytet, duke lënë mbrapa shtëpitë e tyre, profesionët, tregtinë, pasurinë dhe kopshtet dhe atje, ata ishin të kënaqur me pak. Si kompensim ata vetëm donin të fitonin kënaqësinë e Allahut. Kënaqësia e tyre dhe kujtimi i sinqertë i ahiretit ju mundsoj të fitojnë bekimin e Allahut dhe jetë të mira dhe dhurata. Këto dhurata dhe pasuri nuk e rriten lidhjen e tyre me këtë botë, por më tepër i shtyri ata të shprehin falënderimet e tyre për Allahun dhe për ta kujtuar Atë. Allahu i premton çdo desimtari i cili shpreh një moral të lartë në jetën në këtë botë.

Allahu ka premtuar se do t'ju shtoj punët e mira robërve të Tij të cilët bëjnë mirë

Allahu ka premtuar se do t'ju shtoj punët e mirat robërve të Tij të cilët bëjnë mirë. Disa nga ajetet që tregojn për këtë temë në Kur'an janë:

Kush vjen me një (punë) të mirë, ai (në ditën e gjykimit) shpërblehet dhjetë fish, e kush vjen me (vepër) të keqe, ai ndëshkohet vetëm për të. Atyre nuk u bëhet e padrejtë.(En'am: 160)

S'ka dyshim se All-llahu nuk bën pa drejtë as sa grimca, e nëse ajo vepër është e mirë, Ai e shumëfishon atë dhe Vetë Ai i jep shpërblim të madh. (Nisa': 40)

Shenja më e dallueshme se Allahu e shton çdo punë të mirë është dallimi ndërmjet jetës së kësaj bote dhe ahiretit. Jeta e kësaj bote është një kohë mjaft e shkurt, e cila mesatarisht zgjat 60 vjet. Mirëpo, ata të cilët e pastrojnë vetëveten dhe ngarkohen me punë të mira në këtë botë do të shpërblehen me një mirësi të përjetshme në ahiret si kompensim për atë që ata kanë bërë gjatë kësaj jete të shkurtë. Allahu e ka dhënë këtë premtim në ajetin:

Atyre që bëjnë vepra të mira, u takon e mira (Xhenneti) edhe më tepër (e shohin All-llahun)... (Junus: 26)

Njëri duhet të mendoj për konceptin “përhershmeri” në mënyrë që të kuptojë madhësinë e këtij shpërblimi. Le të supozojmë se të gjithë njëzë të cilët kanë jetuar në tokë deri tani dhe ata të cilët kanë me jetua në të ardhmen e kalojnë secilin sekond të jetës së tyre duke numëruar. Kjo paraqitje sigurisht do të bëhet shumë e madhe për ta përceptuar. Sidoqoftë, lidhur me “përhershmerinë”, edhe ky numër i pa kufij nuk do të ishte asgjë. Për arsye se “përhershmeria” kupton pafundshmeri, mos pasja e kufirit në kohë. Vendbanimi i atyre të cilët

shfaqin besnikëri ndaj Allahut në këtë botë do të jetë xhenneti në ahiret. Aty, ata do të qëndrojnë përgjithmonë, arrijnë çdo gjë që shpirti ua dëshiron dhe nuk do të kenë kufi për këtë. Kjo sigurisht është një shembull që duhet të reflektoj në mënyrë që të kuptohet madhësinë e mëshires dhe mirësisë se Allahut.

NË FYTYRAT E BESIMTARËVE KA SHKËLQIM, POR NË FYTYRAT E JOBESIMTARËVE KA TURPËRIM



Një prej sekreteve që Allahu e tregon në Kur'an është se besimi dhe mosbesimi reflektohen në fytyrat dhe lekurat e njërzve. Në shumë ajete, Allahu na informon se në fytyrat e besimtarëve ka shkelqim përderisa në ato të jobesimtarëve turpërim:

Do t'i shohësh ata duke iu afruar atij (zjarrit) të frikësuar nga nënshtrimi, se si e shikojnë me bisht të syrit tinëzisht (me një shikim të vjedhur)... (Shura: 45)

Atyre që bëjnë vepra të mira, u takon e mira (Xhenneti) edhe më tepër (e shohin All-llahun). Fytyrat e tyre nuk i mbulon pluhuri i zi as nënçmimi, ata janë banues të Xhennetit, aty janë

përgjithmonë. E ata që bënë të këqia, dënimi i së keqes është aq sa është ajo, ata i mbulon poshtërimi. Ata nuk mund t'i mbrojnë kush nga All-llahu, fytyrat e tyre, porsì t'i kishte mbuluar ndonjë copë e errët e natës. Ata janë banues të përjetshëm të zjarrit. (Junus: 26-27)

Siç u shpall në këto ajete, fëtyrat e jobesimtarëve janë të errësuar nga prishja. Në anën tjetër, besimtarët kanë shkëlqim në fytyrat e tyre. Allahu thotë se ata janë të njohur prej gjurmëve të segjideve në fytyrat e tyre:

Muhammedi është i dërguar i All-llahut, e ata që janë me të (sahabët) janë të ashpër kundër jobesimtarëve, janë të mëshirshëm ndërmjet vete, ti i sheh kah përulen (në rukuë), duke rënë me fytyrë në tokë (në sexhde), e kërkojnë prej All-llahut që të ketë mëshirë dhe kënaqësinë e Tij ndaj tyre. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e gjurmës së sexhdes... (Fath: 29)

Në ajetet tjera, Allahu informon se jobesimtarët dhe mekatarët janë të njohur prej fytyrave të tyre:

Kriminelët njihen me tiparet e tyre, andaj me rrëmbim kapen për flok dhe për këmbët e tyre. (Rrahman: 41)

E sikur të kishim dashur Ne, do t'i tregonim ty se kush janë ata, e do ti njihje konkret po me siguri do t'i njohësh përmë mënyrës së fjalës së tyre, e All-llahu i di vepra tuaja. (Muhammed: 30)

Është një mrekulli dhe një sekret i rëndësishëm i shpallur në Kur'an se, besimi i varur i ndonjërit ose keqbërja, bëjnë ndryshime fizike në fytyrën e ndonjërit. Ndjenjat shpirtrore shkaktojnë efekte fizike në trup; ndonëse konstrukti jetë i njëjtë, shprehja e ndryshimeve të fytyres ose fytyra është e errësuar ose e shkëlqyer. Një njëri i besimit, mundet, me dëshirën e Allahut, të shohë këtë mrekulli që Allahu e ekzekuton në njerëz.

SEKRETI QË ALLAHU I FSHIN PUNËT E KËQIJA



Qëllimi i besimtarëve është të fitojnë kënaqësi, mëshirë dhe xhennetin e Allahut. Mirëpo, njeriu është krijuar i dobët dhe harrestar; prandaj, bënë shumë gabime dhe ka shumë dështime. Allahu, i Cili i ngjeh robërit e Tij në mënyren më të mirë dhe i Cili është më mëshiruesi dhe më i mëshirëshim, na ka informuar neve se Ai do t'i fshij punët e këqija të robërve të sinqertë të Tij dhe do të ju jep një llogari të lehtë:

E përsa i përket atij që libri i vet i jepet nga e djathta, ai do të llogaritet me një llogari të lehtë, do të kthehet te familja e vet i gëzuar. (Inshikak: 7-9)

Pa dyshim, Allahu nuk e ndrron punën e keqë të çdo personi në të mirë. Vetit e atyre besimtarëve punët e këqija të të cilëve i fshin dhe i fal Allahu janë treguar në Kur'an.

Ata të cilët largohen prej punëve të gabuara seriozisht

Në një ajet, Allahu thotë:

"Nëse lagoheni prej mëkateve të mëdha, të cilat u janë të ndalueshme, Ne ju shlyejmë mëkatet e vogla dhe ju fusim në një vend të ndershëm." (Nisa': 31).

Besimtarët të cilët janë të vëmendshëm për këtë fakt vërejnë kufijtë e vendosur përmes përpikmërisë së Allahut dhe largohen nga kryerja e asaj që është e ndaluar. Nëqoftëse ata ndonjëherë gabojnë në harresë ose nga pavëmendshmëria, ata menjëherë i drejtohen Allahut me pendim dhe kërkojnë falje.

Në Kur'an Allahu na informon neve për robërit e Tij, pendimi i të cilëve nuk do të pranohet. Dmth, i atyre që duke i ditur urdhërat e Allahut, akoma me qëllim kryejn mekate, duke thënë "pa marr parasysh se çka ndodh unë do të jem i falur" është plotësisht një arsyetim me të meta. Sepse, Allahu falë punët e këqija të robërve të Tij të cilët i kryejn ato nga padituria dhe të cilët, pa humbar kohë, pendohen dhe nuk shfaqin këmbëngulje në ato punë dhe i ndreq për ta ato punë:

Pendim i pranueshëm te All-llahu është vetëm ai i atyre që kur bëjnë të keqen me mosdije shpejt pendohen; të tillëve All-llahu ju pranon pendimin, se All-llahu është më i dijsmi, më i urti. Nuk është pendim (i pranueshëm) i atyre që vazhdimisht bëjnë punë të këqia dhe vetëm atëherë kur t'i vjen vdekja ndonjërit prej tyre, të thotë: "Unë tash u pendova!" e as i atyre që vdesin duke qenë jobesimtarë. Ndaj tyre kemi përgaditur dënim të ashpër.(Nisa': 17-18)

Sikur që këshillon ajeti, menjanimi i menjëhershëm nga mëkatet është esenciale nëse një përsôn don që punët e tij të këqija të fshihen dhe të mos pendohet në ditën e gjykimit. Një besimtar i cili bënë mëkat, në anën tjetër, nuk duhet të humbë kohë në kërkimin e faljes nga Allahu.

Ata të cilët ngarkohen në punë të mira

Në ajetet tjera, Allahu thotë se Ai do të mbulojë punët e këqija të atyre të cilët punojnë mirë. Disa nga ajetet për këtë janë në vijim:

Ditën e kijametit, kur Ai u tubon juve, ajo është ditë e mashtrimit (ditën e kijametit duket se kush është mashtruar). kush beson All-llahun dhe bën vepra të mira. Ai ia shlyen të këqijat e tij dhe atë e fut në Xhennete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj; aty do të jenë përgjthmonë, e ai është shpëtimi i madh.(Tegabun: 9)

Përveç ati që është penduar dhe ka bërë vepër të mirë, të tillëve All-llahu të këqijat ua shëndrron në të mira. All-llahu është mëshirues, ndaj Ai falë shumë. (Furkan: 70)

Secili veprim dhe të gjitha sjelljet e shfaqura për të kërkuar përkrahjen e Allahut janë “punët e mira”. Psh, çdo qëndrim siç është komunikimi i porosive të fesë së Allahut njerëzve, përkujtimin e dikujt që nuk është i mbështetur të Allahu rreth fatit, pengimi i ndokujt nga thashethamet, mbajtja e shtëpisë dhe trupit pastër, zgjerimet e fushëpamjeve duke lexuar dhe mësuar, folja me mirësjellje, përkujtimin e njerëzve për ahiretin, dashamirë për të sëmuret, shfaqja e dashurisë dhe keqardhjes për të vjetrit, fitimi i parave përmes udhëve legale që ai mund t’i shfrittoj për të mirën e njerëzve, menjanimin e të ligës me të mirën dhe durimi, krej këto mund të bëhen punë të mira kur ato janë bërë për të fituar kënaqësinë e Allahut. Ata që deshirojnë që punët e tyre të këqija të zvoglohen dhe të transferohen në të mira në ahiret do të duhej që gjithmonë të zgjedhin të veprojnë në udhën që Allahu do të jetë i kënaqur më së shumti. Për kësi qëllimi, njeriu duhet që vazhdimisht të kujtoj llogaritjen në ditën e gjykimit. Është e qartë se si do të veprojë çdonjëri, psh, nëse ndonjëri do të ishte vendosur të qëndroj përpara zjarrit të xhennemit, atij do t’i tregoheshin punët e këqija që ai i ka bërë në këtë jetë, dhe do të ishte njoftuar se ai duhet të punoj në udhën e drejt për me qënë i falur. Një person që e sheh

zjarrin, i cili e ndëgjon dëshprimin, keqardhjet dhe rënkimet e njerëzve të xhehennemit nën atë dënim të vështirë dhe i cili do të ishte deshmitar i dënimit të xhehennemit me sytë e tij, sigurisht do të vepronte në mënyrën që ma së shumti e kënaq Allahun dhe do të përpiqej me përpjekjet maksimale të tij. Ky njëri do të lutej në kohë, do të kryente punë të mira, kurrë nuk do të ishte i pakujdesshëm, kurrë nuk do të guxonte të zgjedhë një veprim i cili do të kishte vlerë ma të vogël të Allahu kur e din se është një tjetër që ka vlerë ma të madhe te Allahu. Sepse xhehennemi, i cili qëndron drejt përpara tij, do ta përkujton çdoherë atë për jetën e përjetshme dhe për dënimin e Allahut. Një person i tillë nuk do t'i lëshojë punët e mira të tij. Ai menjëherë dhe saktisht do të kryente çka vetdija e tij urdhëron atë të bëjë. Ai do të ishte tepër i përpikët dhe këmbëngules në lutjet. Pra, në jetën e kësaj bote, punët e këqija të vetëm atyre të cilët kryejnë punë të mira, i frikohen Allahut dhe ditës së gjukimit, sikur ta kishin parë xhehennemin dhe të ishin kthyer prap në këtë botë, ose sikur ata gjithmonë ta shihnin zjarrin pranë tyre, do të tranësformohen në të mira. Këta besimtar janë të sigurt për ahiretin dhe ata shumë i frikohen dhe përpiçen t'i shmangen dënimit të Allahut.

QËLLIMI I SHENJËT NË SHPENZIMIN NË RRUGËN E ALLAHUT



Një nga veprimet ma të rëndësishme të adhurimit që e fshinë ndytësirën materiale dhe shpirtërore, dhe i mundson njeriut të dicitloj shpirtin e tij dhe kështu të arrij gjendjen e moralit të lartë që Allahu do të jetë i kënaqur me të, është shpenzimi në rrugën e Allahut për arsye të mirësisë. Allahu i ka thënë Pejgamberit (saas) të marr lemoshë nga pasuria e besimtarëve dhe t'i thjeshtsoj dhe pastroj ata në këtë mënyrë.

Merr prej pasurisë së tyre (të atyre që pranuan gabimin) lëmoshë që t'i pastrosh me të dhe t'u shtosh (të mirat)... (Tevbe: 103)

Mirëpo, veprimi i shpenzimit që t'i thjeshtsoj dhe pastroj njerëzit është ajo që bëhet sipas mënyrës që është caktuar në Kur'an. Njerëzit besojnë se vetë kanë përmbushur së tepërmi detyrën e tyre kur ata u japin disa te imta lupsave, kur ata u japin të varfërve disa nga teshat e tyre të vjetra ose kur ata e ushqëjnë ndonjë person të uritur. Pa dyshim

këto veprime do të shpërblehen në vështrimin e Allahut nëse ato ishin kryer me qëllimin e fitimit të kënaqësisë së Allahut. Sidoqoftë, në Kur'an janë kufijtë e caktuar. P.sh. Allahu e urdhëron njeriun të shpenzoj çkado që është tepricë e nevojave të tij:

... Të pyesin ty edhe se ç'do të japin. Thuaj: “Tepricën!” Kështu ua sqaron All-llahu juve argumentet ashtu që të mendoni (çka është mirë e çka është keq). (Bekare: 219)

Njeriu do të jetojë shumë pak në këtë botë. Pasuria që është mbi tepricën e nevojave të njeriut është tepricë e të mirave, ajo çka është me rëndësi është, se nuk është shuma e dhënë, por nëse ndonjëri jep singërisht çka ai realisht mund të jap. Allahu ka njohri për të gjitha sendet dhe Ai e ka lënë në vetëdijen e njeriut të zgjedh gjërat që nuk ka nevojë për to aktualisht. Dhënja është një formë e adhurimit shumë e lehtë për ata të cilët nuk janë të pushtuar për ambiciet botërore dhe të cilët nuk janë shitur për këtë botë, por janë të etur për ahiret. Allahu na ka urëdhuar neve të japim nga pasuria jonë që të shmangemi nga lidhja për këtë botë. Kjo është një mënyrë me pastruar vetëveten nga lakmia. Pa dyshim, kjo formë e adhurimit është shumë e rëndësishme për besimtarët në respekt të llogaritjeve të tyre në ahiret. Pejgamberi i Allahut (saas) gjithashtu ka thënë ai i cili shpenzon në rrugën e Allahut është i favorizuar:

Dy njerz janë të favorizuar: njëri është ai të cilit Allahu ja ka dhënë Kur'anin dhe i cili jeton sipas tij. Ai e pranon si legale çfarëdo që e urdhëron sikur legale, dhe si jolegale çfarëdo që urdhëron si jolegale. Tjetri është ai të cilit Allahu i ka dhënë pasuri dhe i cili e ka shpërndarë këtë pasuri midis të afërmeve të tij dhe ka shpenzuar në rrugën e Allahut.⁶

Njeriu duhet të jap atë që e do për novojtarët

Njerëzit shpesh tentojnë me i bërë diku një të mirë nëse ajo e mirë nuk i dëmton interesat e tyre. P.sh. kur ndokush dhuron mall për nevojtarët, ai shpesh jep ato gjëra që nuk janë më të dëshirueshme, ose nuk i pelqëjnë, ose jashtë modes, ose nuk i përshtaten më

Allahu, megjithatë, urdhëron njeriun që të jap atë që ma së shumti e donë për vetëvetën. Ndonjëri do ta ketë shumë vështirë që të japë pronën e dashur, por zemërgjersia e tillë është e nevojshme për pastrim dhe arritjen e ndershmerisë. Ky është një sekret i rëndësishëm që Allahu e ka shpallur për njerëzimin. Allahu ka shpallur se njeriu s'mund në asnjë mënyrë tjetër, të arrijë mirësinë:

Kurrë nuk do të arrini sinqeritetin e plotë me besim (as kënaqësinë e lumtur në Xhennet) derisa të mos e jepni më të dhëmbshmen (më të dashurën) e pasurisë suaj. Çkado që jepni (për Allahun), All-llahu atë e di. (Ali 'Imran: 92)

O ju që besuat, jepni nga më e mira e asaj që e fituat dhe nga ajo që ju dhamë prej tokës, e mos nxitoni ta jepni atë më të pavlefshmen nga ajo, e që ju nuk do ta pranoni për vete pos symbyllas. Dhe dini se All-llahu nuk ka nevojë për ju, ngase është i Madhëruar. (Bekare: 267)

Shpenzimi në rrugën e Allahut është një mënyrë e afrimit më afër te Allahu

Për një besimtar, asgjë nuk është më e dashur se fitimi i kënaqësisë dhe dashurisë së Allahut. Një besimtar kërkon mënyrën për me u afruar te Allahu gjatë gjithë jetës së tij. Për këtë Allahu thotë:

O ju që besuat! Kinie frikë All-llahun dhe kërkon i afrim te Ai, luftoni në rrugën e Tij që të gjeni shpëtim. (Ma'ide: 35)

Sikur një sekret dhe një lajm të mirë për besimtarët, Allahu ka

shpall në Kur'an se çka është shpenzuar do të jetë një mënyrë e arritjes më afër Atij. Prandaj, për një besimtarë, dhurimi i asaj që ai donë dhe çka është përtej nevojave të tij nuk është një mundim, por më parë një rast i çmuar për me demonstrue devotshmërinë dhe dashurinë për Allahun. Për këtë Allahu thotë:

Po, ka edhe disa nga beduinët që besojnë All-llahun dhe botën tjetër dhe atë që e japin e konsiderojnë afrim te All-llahu dhe bekim te i dërguari. Veni re, ato janë afrime te All-llahu për ta, e All-llahu do t'i përfshijë në mëshirën e Tij. All-llahu falë dhe është mëshirues. (Tevbe: 99)

Çkado që është shpenzuar në rrugën e Allahut do të kompensohet

Edhe një sekret i shpallur në Kur'an në respekt të dhurimit të pasurisë se ndonjërit është se çkado që është shpenzuar sigurisht do të zavendosihet. Ky është premtim i Allahut. Ata që shpenzojnë pasurinë e tyre në rrugën e Allahut pa frikë nga varfëria, janë të prezentuar me bekime mahnitëse gjatë gjithë jetës së tyre. Çkado që shpenzohet në rrugën e Allahut do të paguhet prapa në tërësi. Disa nga ajetet që janë të lidhura me premtimin janë:

“Nuk është obligim yti (Muhammed) udhëzimi i tyre (në rrugë të drejtë), All-llahu e shpie në rrugë të drejtë ate që do. Çkado që të jepni nga pasuria, e keni për veten tuaj, po mos jepni për tjetërkë, por vetëm për hir të All-llahut, e çkado që t'u jepni të tjerëve nga pasuria, ajo do t'u kompensohet në mënyrë të plotë duke mos ju dëmtuar.” (Bekare: 272)

... çkado që shpenzoni për rrugë të All-llahut, ajo do t'ju kompenzohet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtë. (Enfal: 60)

Thuaj: “S'ka dyshim se Allahu im është Ai që jep furnizim të

begatshëm atij që do nga robërit e vet dhe Ai ia pakëson atij, e çkado që të jepni, Ai e kompenson atë dhe Ai është dhuruesi më i madh. (Sebe': 39)

Besimtarët deshirojnë të fitojnë kënaqësinë e Allahut dhe xhennetin kur ata japin pasurinë e tyre dhe përforcojnë vetëveten; por si një sekret i shpallur nga Allahu, çkado që ata shpenzojnë do të ju kthehet atyre. Siç u tha në ajet, Allahu zavendson çka është shpenzuar. Këto shpërblime janë bekime në të dyat, në këtë botë dhe, mbi të gjitha, dhurata që në xhente Allahu ka përgadit për besimtarët. Në anën tjetër, e kundërta e atyre që dhurojnë, Allahu zvoglon furnizimin për ata njerëz të cilët janë dorështërnguar në dhënjën e pasurisë së tyre ose të cilët deshirojnë të akumulojnë më shumë pasuri duke mospërfillur kufijt e Allahut. Një nga ajetet tregon gjendjen e atyre që marrin kamatën:

All-llahu zhduk kamatën dhe shton lëmoshën, All-llahu nuk e do asnjë besëpreme dhe mëkatar. (Bekare: 276)

Allahu na informon neve për bollëkun që arrijnë ata që dhurojnë pasurinë e tyre:

Shembulli i pasurisë së atyre që e japin në rrugën e All-llahut është si një kokërr prej të cilës mbijnë shtatë kallinj, ndërsa në secilin kalli ka nga njëqind kokrra. All-llahu ia shumëfishon (shpërblimin) atij që dëshiron, All-llahu është Bujar i Madh, i di qëllimet. (Bekare: 261)

O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të krenuar e me ofendim siç bën ai që ia jep pasurinë e vet sa për sy e faqe të njerëzve, e nuk beson All-llahun dhe botën tjetër. Shembulli i tij është si një gur i madh e i lëmuar pëbmi të cilin ka pak dhe, e kur e godet atë një shi i madh e lë të zhveshur (lakuriq). Ata (formalistët) nuk arrijnë asgjë nga ajo që punuan. All-llahu nuk udhëzon popullin pabesimtar. E shembulli i atyre që pasurinë e vet

e japin nga bindja e tyre e duke kërkuar kënaqësinë e All-llahut, i përngjan një kopshti në një rrafshnaltë që i bie shi i madh, e ai jep fruta të dyfishtë. Po edhe nëse nuk i bie shi i madh, i bie një rigë (që i mjafton). All-llahu sheh atë që vepron. (Bekare: 264-265)

Secila nga këto ajete është sekret që Allahu e shpallë për besimtarët në Kur'an. Besimtarët shpenzojnë pasurinë e tyre vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe xhennetin e Tij. Mirëpo, duke qënë të vetëdijshëm për këto sekrete të shpallura në Kur'an, ata gjithashtu shpresojnë për bekimin dhe mirësinë e Allahut. Sa më shumë që shpenzojnë të mirat e tyre dhe përforcojnë vetëveten në rrugën e Allahut dhe sa më të përpikët që ata bëhen në vërejtjen se çka është e ndaluar dhe çka e lejuar, më shumë Allahu e shton pasurinë e tyre, i bënë detyrat e tyre të lehta, dhe i pajis me më shumë raste për me shpenzue në rrugën e Tij. Çdo besimtar që i frikohet Allahut dhe nuk fsheh frikë në zemrën e tij për të ardhmën, do ta përvojë këtë sekret në drejtimin e jetës së tij.

EFEKTI I PUNËVE TË MIRA DHE FJALËVE TË MIRA



Njerëzit janë në kërkim të papajtueshëm për rrethinën paqësore ku ata mund të jetojnë në siguri, të kënaqen dhe shoqërin që e duan. Përkunder këtij dëshirimi, megjithatë, ata kurrë nuk vënë përpara një përpjekje për kujdesjen e këtyre vlerave, por më parë ata bëhen shkaktarët e konflikteve dhe vuajtjeve. Shpesh njerëzit presin që të tjeret të kujdesen për paqën dhe sigurinë dhe të jenë të shoqërueshëm. Kjo i kushtohet marrëdhënjeve familjare, marrëdhënja midis punëtorëve të një kompanie, paqës sociale sikur që edhe për çështjet ndërkombëtare. Sidoqoftë, mirëmbajtja e miqësis, paqja dhe siguria kërkojnë altruizëm. Konflikti dhe nervozizmi nuk mund të menjanohen kur njerëzit insistojnë që fjala e fundit të jetë e tyre, kur ata konsiderojnë vetëm rahatën e tyre dhe s'janë të gatëshëm me bë çfardo kompromisi apo sakrifice. Mirëpo, besimtarët të cilët i frikohën Allahut veprojnë ndryshe. Ata janë bujar, durimtarë dhe falin. Bile edhe kur nuk janë gabim, ata heqin dorë nga të drejtat e tyre, duke marrë parasysh paqën dhe sigurinë e shoqërisë dhe lumturinë e të tjerëve mbi interesin

përsional të tyre, dhe paraqësin sjellje xhentile. Ky është një tiparë fisnik që Allahu i urdhëron besimtarët ta kenë:

Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj, (të keqen) ktheje me mirësi, se atëherë ai, mes teje dhe të cilit ka armiqësi, do të bëhet (si) mik i afërt. Mirëpo, këtë nuk e arrin kush, pos atyre të durueshmëve, dhe nuk e arrin kush, pos atyre me virtyt të lartë. (Fusilet: 34-35)

Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Allahut tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Allahu yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit. (Nahl: 125)

Siç u tha në ajetin, si shpërblim për këtë punë të mirë të besimtarëve, Allahu i ndrronë armiqët e tyre në “shokë krahrori”. Kjo është një nga sekretet e Allahut. Pas të gjithave, të gjitha zemrat janë në duar të Allahut. Ai e ndrron zemrën dhe dëshirën e kujt do Ai.

Në një ajet tjetër, Allahu e tërhjek vëmendjet tonë te efekti i fjalës së mirë dhe të butë. Allahu i urdhëron Profetët Musen dhe Harunin (as) të shkojnë te faraoni dhe të flasin butësisht. Përkundër padrejtësisë, paftyresis dhe pamëshirshmëris së faraonit, Allahu i ka urdhëruar Profetët e tij që të flasin me të me fjalë të buta. Allahu e ka shpjeguar arsyen në Kur’an:

Shkoni që të dy te faraoni, se ai vërtet e ka tepruar. Atij i thuani fjalë të buta, ndoshta ai mendohet e frikësohet. (Ta Ha: 43-44)

Këto ajete e informojnë besimtarin se çfarë qëndrimi, ata duhet të pretendojnë ndaj jobesimtarëve, armiqëve të tyre dhe njëzve të paturp. Kjo me siguri nxit për durim, vendosje, thjeshtësi dhe mençuri. Allahu e ka shpallur si sekret se Ai do t’i shpërblejë punët e efektshme të besimtarëve dhe do t’i ndrronë armiqët e tyre në miq kur ata ndëgjojnë urdhërat e Tij dhe punojnë në pajtim me moralet e mira.

SEKRETI QË ALLAHU I PAJISË NJERËZIT ME VEND



Një nga gabimet serioze që njerëzit e bëjnë është se ata e konsiderojnë çdo gjë si një pasojë e diçkafi tjetër. Psh, siç u përmend në faqët paraprake, ata mendojnë se ata do të mbesin pa para nëse ata shpenzojnë në rrugën e Allahut. Mirëpo, është një sekret në krijimet e Allahut për të cilin ata nuk dinë; se Allahu do ta rris bekimin e Tij në ata të cilët japin në çështjen e Allahut në të dy botërat, këtu dhe në ahiret. Sigurisht, Allahu i mundson njeriut t'i kuptojë këto si një çështje dhe efekt për funksionimin e botës. Psh, puna e dikujt që jep pasurinë e tij për çështjen e Allahut, është lehtë të shpërblehet dhe të ardhurat e tij janë të rritura nga Allahu. Ose, siç u shpjegua në kapitullin paraprak, njëri mund të drejtohet me forcë t'i bëjë ballë një personi të tërbuar për arsye se ai beson se fjalët nuk do ta qetësojnë atë. Mirëpo, për një person i cili i ndëgjon urdherat e Allahut, sekretet që Allahu i ka shpallur në Kur'an japin të vetmën zgjidhje

Një nga këto sekrete të shpallura në Kur'an është një urdhër tjetër i Allahut:

O ju që besuat, kur t'ju thuhet: zgjerohuni (bëni vend) në vend ndeje, ju zgjerohuni, se All-llahu bën zgjërime për ju, e kur t'ju thuhet: ngrituni! Atëherë ju ngrihuni, All-llahu lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri. All-llahu është i njohur mirë me atë që punoni. (Muxhadele: 11)

Allahu urdhëron besimtarët të zbatojnë thirrjen për bërjen e vendit në mbledhje për të posardhurit ose të rrallojnë grumbullin kur të jetë e nevojshme. Kjo, poashtu tregon vëmendjen dhe mirësinë, është gjithashtu një shenjë e dëgjueshmërisë. Allahu ka treguar se Ai do t'i siguroj vende të bollëshme për besimtarët dhe do t'i ngris ata në rank si kundërshtëpërblim për sjelljen e tyre. Allahu mban qëllimin dhe zemren e çdo njeriu në dorën e Tij. Nëse Ai është i kënaqur me sjelljen e tyre, Ai mund t'i jap këtij personi çdo dhuratë dhe bukuri që Ai dëshiron. Për këtë arsye, besimtarët presin rezultat dhe shpërblim për çdo gjë nga Allahu. Kur ata bëjnë vend në mbledhje, ata nuk presin mirënjohje nga njëri, por shpresojnë kënaqësi e Allahut, për paqën që Ai do të ju jep zemrave të tyre dhe për ngritjen në rank.

ALLAHU SIGURISHT U NDIHMOM ATYRE TË CILËT E NDIHMOJNË FENË E TIJ



Allahu shpallë një sekret në Kur'an si vijon:

O besimtarë, nëse ju ndihmoni (fenë) All-llahun, Ai u ndihmon juve dhe u forcon këmbët tuaja. (Muhammed: 7)

Besimtarët gjatë gjithë jetës së tyre, bëjnë përpjekje serioze për me i përhapë vleratë e Kur'anit midis njerzëve dhe përhapjen e porosisë së Allahut. Në anën tjetër, gjatë gjithë historisë, ka pasë grupe të jobesimtarëve të cilët kanë qënë kundër besimtarëve dhe janë munduar t'i pengojnë ata me forcë dhe shtypje. Në Kur'an, Allahu thotë se Ai është gjithmonë me besimtarët kundër jobesimtarëve, se Ai do t'i bëjë punët e tyre të lehta, dhe se Ai do te ju ndihmoj dhe përkrah besimtarët. Besimtarët të cilët vendosin përpjekje serioze në rrugën e Allahut e përjetojnë këtë në çdo moment të jetës së tyre. Allahu i bjenë punët e

tyre te një rezultat me lehtësime, dhe u jep atyre suksese dhe bukuri. Bile në situata shumë të vështira, Ai i pajis besimëtarët me lehtësime. Bile në rastet kur ata me besim të dobët thonë “mjerisht,” i hapin udhen dëshpërimit dhe nuk shohin rrugdalje, Allahu e ka dërguar ndihmen e Tij për besimtarët dhe i ka bërë ata të jenë fitues.

Besimtarët të cilët janë të sigurt se Allahu i ndihmonë dhe i përkrah ata, kurrë nuk e humbin shpresën dhe presin me padurim me pa se si Allahu do ta vendosë një ngjarje. Pejgamberi Musa (as) dhe populli i tij janë një shembëll për këtë. Pejgamberi Musa (as) dhe populli i Izraelit lëshuan Egjiptin për me u mbrojtë nga mizoria e Faraonit. Por Faraoni dhe ushtria e tij shkuan pas tyre. Kur Pejgamberi Musa (as) dhe populli i Izraelit arriten të deti, disa nga ata të cilët patën besim të dobët i kapi panika dhe humbën shpresën, duke menduar se ata do t'i kapë Faraoni, sidoçoftë Pejgamberi Musa (as) tha:

"... me mua është Allahu im, Ai do të më udhëzojë". (Shu'ara': 62)

Dhe kështu e shprehu besimin e tij në përkrahjen e Allahut për besimtarët. Në të vërtetë, Allahu ndau ujrat e detit dhe i lejoj Pejgamberit Musa (as) dhe shoqëruesve të tij të kalojnë në bregun tjetër të sigurt. Në ndërkoh, Ai e mbylli detin mbi Faraonin dhe ushtaret e tij, të cilët u fundosen.

Një besimtarë, që është afër Allahut, i cili e merr Allahun si shok të tij dhe e dinë se Ai i përkrah ata që besojnë, do të shohë manifestimin e këtij sekretit në çdo moment të jetës së tij. Sigurisht, mrekullit sikur ndarja e detit janë shenja që Allahu i paraqet për disa Pejgamber të tij. Megjithatë, nëse besimtarët sinqërisht mendojnë, në pasqyrimin e krijimeve të Allahut dhe të ajeteve Kur'anore në çdo incident, ata mund të shohin mrekulli sikur manifestimet e përkrahjes dhe ndihmës së Allahut në çdo situatë.

Allahu ju ndihmon besimtarëve gjithashtu përmes rrugëve të padukshme

Në shumë ajete, Allahu i ka informuar besimtarët për përkrahjen që Ai u jep atyre. P. sh., në një ajet, Allahu ka thënë se Ai do t'i bëjë armiqët që t'i shohin muslimanët dyfish më shumë se që janë:

Ju (jehudi) patët një përvojë të madhe në ato dy grupet që u konfrontuat ndërmjet vete. Njëri grup luftonte në rrugën e Allahut, e tjetri ishte pabesimtar, dhe me shikimin e syve të tyre i shihnin se ishin dy herë më shumë se besimtarët. Po, All-llahu me ndihmën e vet përforcon atë që do. Vërtetë, në këtë është një përvojë e madhe për ata që kanë mendje të kthjelltë. (Ali 'Imran: 13)

Allahu u ndihmon besimtarëve me anë të zbrapsjeve të intrigave të kurdisura kundër tyre

Siç u përmen më parë, jobesimtarët shkaktojnë vështirësi të ndryshme për besimtarët dhe kurdisin intriga kundër tyre në mënyrë që t'i pengojë ata nga rruga e Allahut. Por Allahu informon në Kur'an se të gjitha intrigat kundër besimtarëve do të zbrapsen, do të kthehen kundër intriguesve dhe nuk do t'i dëmtoj besimtarët në çfarëdo mënyre. Disa nga këto ajete janë:

... E kur u erdh atyre pejgamberi, atyre nuk u shtoi tjetër vetëm se largim.(Largim) Për shkak të mendjemadhësisë dhe dredhisë së keqe, por dredhia e keqe nuk godit tjetër vetëm ata që kurdisën. Pra ata nuk janë duke pritur tjetër vetëm gjurmët e të parëve, e në ligjin e All-llahut kurrë nuk do të hasësh devijim. (Fatir: 42-43)

Nëse ju përjetoni ndonjë të mirë, ata i dëshpron ajo, e nëse u godet ndonjë e keqe, ata gëzohen për atë. Po, në qoftë se ju bëheni të durueshëm dhe ruheni (mëkateve), dinakëria e tyre nuk do të t'u

dëmtojë aspak. Është e sigurt se All-llahu e ka në dorë atë që punojnë ata. (Ali 'Imran: 120)

Jeta e Pejgamberit Jusufit (as) është shembull në këtë kuptim, sepse planet e kurdisura kundër besimtarëve në fund do të kthehen në favor të tyre kundër atyre që kurdisin. Siç është shpallur në Suren Jusuf, vëllazerit e Pejgamberit Jusufit (as) të cilët ishin të prishur nga zilia, sajuan një plan dhe e gjuajtën atë në pus. Kur Pejgamberi Jusufi (as) ishte ende i ri, edhe një plan është sajuar nga gruaja e guvernatorit, në shtëpinë e të cilit Pejgamberi Jusuf (as) jetonte. Premtimi i Allahut detyroj deshtimin e këtyre intrigave dhe mbrojti nga dëmtimi. Duke përcjellur sajimet, Allahu vendosi Pejgamberin Jusufin (as) në autoritet mbi thesarët e vendit. Pas të gjitha këtyre, Pejgamberi Jusufi (as) e komentoj se intrigat e jobesimtarëve janë të destinuara për dështim: **Këtë (e bëra thotë Jusufi) për ta ditur ai (ministri) se unë nuk e tradhtova tinëzisht dhe së vërtet All-llahu nuk realizon dredhinë e tradhtarëve.** (Jusuf: 52)

PËRÇARJET SHKAKTOJNË HUMBJEN E FUQISË



Një nga sekretet e rëndësishme që Allahu shpalli për besimtarëve është të mos përçahen. Përndryshe fuqia e tyre do të mënjanohet dhe ata do të jenë të dobët në zemër. Ajet i ndërlidhur është:

Dhe respektojeni All-llahun e të dërguarin e Tij, e mos u përçani mes vete e të dobësoheni e ta humbni fuqinë (luftarake). Të jeni të durueshëm se All-llahu është me të durueshmit. (Enfal: 46)

Virtytet Kur'anore lidhen me përvulësinë. Ata që mbështeten në vlerat morale të Kur'anit shuajnë përçarjet, gjejnë zgjidhje të problemeve, i bëjnë gjërat më të lehta për njërit dhe nuk shfaqin lakmi. Në mungesë të moralit Kur'anor, përçarjet dhe konfliktet janë të pashmangshëm. Është plotësisht natyrale që çdonjëri ka opsione të ndryshme. P.sh. njëzet njerëz mund të propozojnë njëzet zgjidhje të ndryshme për një problem. Secila zgjidhje mund të jetë me vend apo e qëndrueshme në vetëvete. Në qoftë se çdo njëri insiston në të qenuri

me vend, është e qartë se aty do të ketë rrëmujë dhe konflikt. Në kësi rasti, ma parë se unifikimi i konsensusit të njëzetë njerëzve, aty do të ketë grindje dhe ambicie personale që do të pengojnë punët e mira të angazhuara për çështjen e Allahut. Si rrjedhim, e tërë fuqia e këture njëzet njerëzve do të zhduket, unioni dhe vllazërimi mes tyre do të jetë i tretur.

Besimtarët duhet të ndiejnë një dashuri të thellë për njëri tjetrin, bërjen e sakrificave dhe vendosjen e një solidariteti dhe bashkpunimi të fortë midis tyre. Posaqërisht në kohët e vështira, ata duhet ta mbajnë vetëveten të okupuar me përkujtimin e Allahut, dhe të jenë më shumë durimtar dhe përkrahes ndaj njëri tjetrit. Përçarjet e zvoglojnë fuqinë, ndërsa bashkpunimi e rrit fuqinë midis besimtarëve. Në një ajet tjetër, Allahu e ka shpallur sekretin se nese besimtarët nuk janë miq dhe mbrojtës të njëri tjetrit, do të ketë çrregullim dhe korrupsion në tokë:

Ata që e mohuan të vërtetën janë miq të njëri-tjetrit. E nëse nuk e bëni atë (të ndihmoni e të kujdeseni njëri-tjetrin), bëhet trazirë dhe rrëmujë e madhe në tokë. (Enfal: 73)

Secila nga këto është sekret që Allahu e ka shpall dhe i ka ngarkuar muslimanët me përgjegjësi. Asnjë musliman s’duhet të konsideroj një grindje me një tjetër musliman të vogël, duke thënë: “ani çka nëse ne jemi grindur?” Për arsye se, siç na informon Allahu neve, secila grindje midis muslimanëve, do të thotë zvoglim i fuqisë së besimtarëve për të cilën muslimanët do të japin llogari te Allahu. Kjo është pse Pejgamberi i dashuri ynë (saas) ka thënë:

*Frikësonju Allahut. Bëni paqë midis juve. Sigurisht, Allahu bënë paqë midis muslimanëve*⁷

Muslimanët nuk duhet të shikojnë gabimet apo deshtimet e njëri tjetrit, por më parë të mbulojnë gabimet e muslimanëve të tjerë me keqardhje. Fuqia që besimtarët e nxjerrin nga ky bashkim, do të thotë përkushtim i tërë energjisë në përhapjen e fesë se Allahut dhe moralet

e Kur'anit. Me bashkim ata mund të koncentrohen në komunikimin e shenjave të ekzistimit të Allahut me anën e punëve shkencore dhe paraqësin sherbime për tu lavdruar për njerëzimin. Njeriu duhet të përkujtoj, megjithatë, se secili paraqët sherbimet e tij posaqërisht për fitimin e jetës së përjetshme në ahiret dhe të jetë i mbrojtur nga denimi i Allahut.

VETËM NË PËRKUJTIMIN E ALLAHUT ZEMRAT GJEJNË KËNAQËSI



T ë gjithë njerëzit që jetojnë në tokë kërkojnë mënyra të arrijnë lumturinë e vërtetë. Shpresat janë vendosur në një qëllim të arritjes së lumturisë. Disa e kërkojnë lumturinë në një jetë mode të pasur, disa në një karrier me prestigj, një martesë të mirë, operacion plastik, pranim në univerzitet. Ndonjëherë ndodhë që këto qëllime të realizohen, mirëpo, rezultati i çfarëdo lumturie është zakonisht jetëshkurtër . Apo shpesh aty nuk ka as pak argëtim dhe kënaqësi në arritjen e qëllimit. Mirëpo, nuk ka qënë askush në tokë i cili ndonjëherë ka arritur lumturi të vërtetë përmes këtyre metodave. Ka shumë të dhëna që ngacmojnë apo shqëtësojnë edhe ndokënd i cili beson se qëllimi i lumturisë complete është arritur.

Lumturia e vërtetë, paqja, kënaqësia dhe lehtësia mund të gjinden vetëm në përkujtimin e Allahut. Allahu e shpall këtë fakt në një ajet:

Ata që besuan dhe me të përmendur All-llahun, zemrat e tyre qetësohen; pra ta dini se me të përmendur All-llahun zemrat stabilizohen. (Rra'd: 28)

Ky është një sekret shumë me rëndësi që Allahu e tregon për njerëzimin në Kur'an. Të pavetëdijshëm për këtë fakt, shumë njerëz e kalojnë jetën e tyre me mashtrimin se dhuratat botërore do të u sjellin kënaqësi. Sikur ata kurrë nuk do të vdesnin dhe takonin ditën e llogaritjes, ata do të përpiqëshin me lakmi për me posedue vlerat që i përkasin kësaj bote.

Sidoqoftë ky është një mashtrim i madh. Asgjë e poseduar në këtë botë nuk mund të sjell paqe të vërtetë dhe lumturi. Vetëm besimtarët të cilët janë sinqerisht të devotshëm për Allahun dhe të cilët janë të ditur për mëshirën e Allahut, mëshirëbërjen dhe mbrojtjen mbi ta, mund ta arrijnë gjendjen paqsore të zemrës. Allahu premton këtë çlirim në zemrën e një personi i cili i sheh fakte në krijimet e Allahut dhe e përkujton Atë në çdo kohë. Prandaj i kotë është kërkimi i lehtësimit apo paqës me çfardo mënyre tjetër

DINAKËRIA E DJALLIT ËSHTË E DOBËT



Armiku më i madh i njeriut, që nga Ademi (as), gjithmonë ka qenë djalli. Djalli premtoj se ai vetë do t'i drejtoj njerëzit në rrugën e gabuar kur Ademi (as) është krijuar, dhe ka angazhua vetën për këtë çështje duke sajuar plane që e bëjnë botën të paraqitet joshëse dhe tërheqëse për njerëzimin. Kur'ani gjithashtu na informon neve se ky plan është i pa fuqi dhe se ai nuk mund të ushtroj autoritet mbi njerëzit:

Ata që besuan luftojnë në rrugë të All-llahut, e ata që nuk besuan luftojnë në rrugë të djallëzuar. Luftoni pra miqtë e djallit, s'ka dyshim se intriga e djallit është e dobët.(Nisa': 76)

Në të vërtetë, djalli realizoi mendimin e vet ndaj tyre, ndaj edhe e dëgjuan atë, përpos një grupi besimtarësh.E ai (djalli) nuk pati kurrfarë pushteti ndaj tyre, përveç që (dija e Jonë të dalë në shesh) të dihet ai që beson në botën tjetër, prej atij që është në dyshim për të. E Allahu yt është përcjellës ndaj çdo gjëje.(Sebe': 20-21)

Në fakt, mënyrë e Allahut për bërjen e gjërave të lehta për njerëzit është, plani i djallit është i dobët dhe se ai nuk ka fuqi mbi njerëzit.

Djalli është e vetmja forcë negative kundër fesë dhe dobësia e tij nënkupton se besimtarët nuk do të përjetojnë asnjë vështirsi në jetesën sipas fesë. Mirëpo, që kjo të ndodhë, është i domosdoshëm besimi i sigurtë. Në Kur'an, Allahu na informon neve se ata me besim të sigurtë nuk do të jetë të prekur nga dredhit e djallit:

(Iblisi) Tha: “Allahu im, për shkak që më përzune (më largove), unë do t'ua zbukurojë (të këqiat) atyre sa të jenë në tokë (në këtë botë) dhe të gjithë ata do t'i largoj nga rruga e drejtë!”. Përveç robërve të Tu, të cilët i ke bërë të sigurtë.(Hixhr: 39-40)

Në një ajet tjetër, Allahu ka treguar se djalli nuk do të ketë fuqi mbi ata që besojnë dhe të cilët mbështeten në Allahun:

Vërtet, ai (shejtani) nuk ka kurrfarë fuqie kundër atyre që besuan dhe i janë mbështetur Allahut të tyre.Mbizotërimi i tij është vetëm mbi ata që e përkrahin atë dhe mbi ata që për shkak të tij u bënë idhujtarë.(Nahl: 99-100)

Sekreti se si t'i ikim shpresave të kota dhe përshpëritjeve të djallit

Përkundër paaftësisë së djallit ndaj besimtarëve, ai mundët nganjëherë të provjë t'i ngacmoj ata me përshpëritjet e tij, për arsye të një krimi apo një gabimi që ata e kanë bërë.

Edhe një sekret tjetër me rëndësi që Allahu e zbulon në Kur'an, është si me iu ik përshpëritjeve të djallit. Kjo është një temë shumë e rëndësishme për ata besimëtar të cilët i frikohen Allahut dhe shpresojnë të arrijnë xhennetin, sepse përshpëritjet e djallit janë fjalë mashtruese që e devijojnë njëriun nga rruga e Allahut dhe e mbajnë atë të zënë me çështje të kota dhe të parëndësishme. Djalli mundohet t'ia mbush ndjenjat e hidhërimit, frikës dhe shqëtësimit nga njerëzit, të mbjell mosmarrëveshje midis tyre, t'i nxit të kenë dyshime për Allahun,

për Kur'anin dhe fenë (dinin). Ai i mbush ata me shpresa të pavërteta. Disa nga ajetet që na tregojnë për përshpëritjet e djallit janë:

"Do t'i shmangë (nga e vërteta), do t'i bëjë të shpresojnë në gjëra të kota; do t'i urdhëroj dhe ata dotë shqyejnë veshët e bagëtive; do t'i urdhëroj dhe ata do të shëmtojnë krijesat e All-llahut. E kush bën mik djallin, e jo All-llahun, ai ka dështuar sheshazi. Ai u premtun atyre dhe i bën të shpresojnë, por djalli nuk premtun tjetër vetëm se mashtrim. (Nisa': 119-120)

"i cili bën cytje në zemrat e njerëzve" (an-Nas: 5)

Pa marr parasysh se çka ju përshpërit djalli besimtarëve, ai nuk do të jet i aftë t'i shkund nga udhëzimi i Allahut përderisa ata e përcjellin rrugën që Allahu u ka treguar. Allahu ju sjell ndër mend besimtarëve që të përkujtojnë Allahun kundër djallit:

E nëse të godet shejtani me ndonjë vesvese, ti kërko strehim te All-llahu, sepse vërtet Ai dëgjon e di. Vërtet, ata që janë të ruajtur, kur i prek ndonjë iluzion nga djalli, ata përkujtojnë (All-llahun), nga djalli, ata përkujtojnë (All-llahun), dhe atëherë shohin (të vërtetën). (A'raf: 200-201)

Siç kuptohet nga ajeti, besimtarët rrinë të gatshëm në përshpëritjet e djallit. Ata nuk humbin kohë duke menduar në përshpëritjet e tij dhe, të vetëdijshëm se Allahun nuk do të ishte i kënaqur, ata kurrë nuk i lejojnë vetës të largohen me pesimizëm, frikë apo shqëtësim, të cilat të gjitha janë ndjenja negative të shmangura nga besimtarët. Kur besimtarët janë të shqëtësuar me diçka që nuk është në përputhje me moralin Kur'anor, ata menjëherë e njohin atë si një përshpëritje e dëmshme e djallit e cila nuk do ta kënaq Allahun. Ata e largojnë përshpëritjen e djallit nepërmasë të përkujtimit të Allahut dhe të ajeteve Kur'anore.

DËGJIMI I SHUMICËS E LARGON NJERIUN NGA UDHA E DREJTË



Pretendimi se bindja e përgjithshme e shumicës është e drejtë, shpesh e mashtron njerëzimin. Në të vërtetë, kur pyeten për arsyen kryesore të një akti të posaqëm apo qëndrimi, shumica e njërzve përgjigjen “për arsye se shumica bën ashtu.” Mirëpo, Allahu na informon se dëgjimi i shumicës është largim nga udha e drejtë:

Në qoftë se u bindesh shumicës (mohuese që janë) në tokë, ata do të largojnë ty nga rruga e All-llahut. Ata nuk ndjekin tjetër vetëm supozime dhe nuk janë tjetër vetëm se rrenacakë. (En’am: 116)

Në një ajet tjetër, Allahu thotë se shumica e njërzve nuk do të besojnë:

Po ti edhe pse lakmon (për besimin e tyre), shumica e njërzve nuk do të besojnë. (Jusuf: 103)

Në suren Ma’ide, Allahu përmend bollëkun e “mekatit” dhe i thërret njerëzit për me e menjanue me mençuri.

Thuaj: “Nuk është e njejtë e keqja dhe e mira, po edhe nëse të mahnit ty shumimi i së keqes, pra keni frikë All-llahun (e mos pranoni të keqen) o ju të zotët e mendjes, ashtu që të shpëtoni. (Ma'ide: 100)

Si pasojë, çka shumica bëjnë, besojnë apo si mbrohën kurrë nuk mund të jetë një burim i besueshëm apo referim. Njerëzit mundohen të përcjellin shumicën nën ndikimin e”instiktit të turmës.” Mirëpo, besimtarët që punojnë në përputhje me këtë sekret të shenjët që Allahu e jep në Kur’an nuk e përcjellin shumicën, por vetëm zbatojnë urdhrat e Allahut dhe fesë së Tij. Edhe nëse janë vetëm, ata kurrë nuk fshehin dyshime për besimin e tyre dhe rrugën që e përcjellin.

SEKRETET NË ZGJERIMIN DHE ZVOGLIMIT TË BEKIMEVE



Në Kur'an, Allahu zbulon arsyen se pse Ai dhuron bekime apo i merr ato përsëri nga njerëzit:

Këtë (masë ndëshkuese) e bëri ngase All-llahu nuk ishte ndryshues i një begatie, të cilën ia ka dhuruar një populli, derisa të ndryshojë ai vetë në vetvete (të bëhet përbuzës i së mirës) dhe ngase All-llahu dëgjon (çka thonë) dhe di (çka punojnë). (Enfal: 53)

Ai (njeri) ka përcjellës një pas një, para tij dhe prapa tij, që me urdhërinë e All-llahut e ruajnë atë. All-llahu nuk e prish gjendjen e një populli (nuk ua largon të mirat) përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre. Po, kur All-llahu vendos ta ndëshkojë një popull, atë nuk ka kush që ta zbrapsë. Ata. (njerëzit) nuk kanë mbrojtës tjetër pos Tij. (Rra'd: 11)

Ajo çka është shpallur në këto ajete është sekret shumë me rëndësi për të cilat njerëzit janë të pavetëdijshëm ose e injorojnë. Allahu thotë se Ai do të zgjeroj bekimet e atyre njerëzve të cilët angazhohen me punë të mira, dhe do ta zvoglojë bekimet e atyre të cilët kryejnë mekate, dhe se bekimet në njerëzit do të pasqyrohen në pajtim me ndrrimet në qëndrimet dhe sinqeritetin e tyre

Besimtarët të cilët e dinë këtë sekret të Allahut mundohen të shohin qëllimet e fshehta në krijimet e Allahut në çdo situatë, me të cilën ata takohen dhe, mbesin të vemendshëm për këtë temë. Ata kurrë nuk ndihen të pavarur, por përpiçën shumë për arritjen e moralit përpikët të përshkruar në Kur'an, dhe t'i përmirësojnë mekatët dhe dështimet e tyre. Në këtë kuptim, ata kurrë nuk guxojnë të ngurrojnë në shfaqjen e moralit të përsosur dhe përmirësimin e sjelljes së tyre.

BINDJA NDAJ TË DËRGUARIT ËSHTË BINDJE NDAJ ALLAHUT



Njëra nga veprimet ma të rëndësishme të adhurimit që Allahu i urdhëron besimtarët në Kur'an është bindja ndaj të dërguarve të Tij. Allahu thotë se Ai ka dërgur të dërguar për me i dëgjuar, dhe besimtarët, në çdo moshë, kanë qënë të provuar në dëgjueshmërinë e tyre ndaj të dërguarve. Të dërguarit janë njerëz që bartin porosinë e Allahut dhe urdhërat e Tij për njerëzit, dhe paralajmrojnë për ditën e ringjalljes dhe për shenjat e Tij. Ata janë të sinqertë dhe njerëz të bekuar të cilët janë të zgjedhur nga Allahu prej njerëzve të tjerë, me punët, qëndrimet dhe moralet e porsosura të cilëve janë shembullor. Ata janë shokët e Allahut të cilët janë afrur pranë Tij. Siç thuhet në ajetet më poshtë, dëgjueshmëria ndaj të dërguarve është shenjë e dëgjueshmërisë ndaj Allahut.

Kush i bindet Pejgamberit, ai i është bindur All-llahut, e kush e refuzon, Ne nuk të dërguam roje kundër tyre (Nisa': 80)

I derguari i Allahut, Muhamedi (saas), gjithashtu ka thënë se lajme të gëzueshme janë për ata të cilët janë dëshmitar për këtë fakt:

Ju dëshmoni se nuk ka përendi përveç Allahut dhe se unë jam i dërguar i Tij, a po? Nëse po, lajmet e gëzuara janë tuajat. Kur'ani është asi litari që njëri skaj shtrihet deri te Allahu e tjetri shtrihet deri te ju. Mbajuni fortë për të. nëse bëni kështu, ju kurrë nuk keni me gabue apo me u rrezikue⁸

Jodëgjueshmëria ndaj të dërguarit është drejtëpërdrejt jodëgjueshmëri ndaj Allahut dhe fesë së Tij. Ky është një sekret me rëndësi që Allahu e shpall në Kur'an. Në një ajet, Allahu e tregon gjendjen e atyre që e dëgjojnë të dërguarin dhe atyre që nuk e dëgjojnë:

Këto janë (dispozita) të caktuara prej All-llahut. Kush i bindet All-llahut, (urdhërave të Tij) dhe të dërguarit të Tij, atë e dërgon në xhennete nën të cilin burojnë lumenj. Aty do të jenë përgjithmonë. E ky është shpëtim i madh. Kush e kundërshton All-llahu dhe të dërguarin e Tij, dhe i shkel dispozitat e Tij, atë e shtie në zjarr të përjetëshëm. E për të është një dënim i rëndë (Nisa': 13-14)

Allahu ka shpallur shumë detale në Kur'an për dëgjueshmërinë e të dërguarve dhe e ka bërë të qartë se si duhet të jenë dëgjueshmëria dhe nënshtrimi i vërtetë, si edhe lloji i dëgjueshmërisë që është i pranuar në vështrimin e Tij. Siç shihet gjithashtu në këto ajete, kryerja e të gjitha kërkesave të fesë dhe pasqyrimi i tepërt për shkak të tij nuk është adekuate. Nëse një person dështon në adoptimin e qëndrimit dhe parimeve morale lidhur me dëgjueshmërinë e të dërguarit në kuptimin që Allahu e ka caktue në Kur'an dhe shpreh papërsosshmeri në dëgjueshmërinë e tij, mund të jetë që Allahu të gjitha punët e tija t'i anuloj. Disa nga ajetet relevante janë ekzaminuar më poshtë në pjesë :

Ata nuk janë besimtarë përderisa nuk e nënshtrojnë vetën plotësisht ndaj të dërguarit

Allahu shpall një sekret shumë me rëndësi në suren En-Nisa:

Për Allahun tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty as të asaj para teje) derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht. (Nisa': 65)

Në këtë ajet, një sekret shumë me rëndësi është shpallur për dëgjueshmerinë ideale ndaj të dërguarit. Shumica e njerëzve e dinë konceptin e dëgjueshmërisë. Mirëpo, dëgjueshmëria ndaj të dërguarëve është shumë ndryshe prej të gjitha formave tjera të dëgjueshmërisë, që njerëzit i dijnë. Siç Allahu thotë në ajetin e më sipërm, besimtarët duhet t'i binden të dërguarit përzemërsisht, pa fshehtë dyshimin ma të vogël apo shfaqjen e çfarëdo hezitimi. Nëse ndonjëri dyshon në atë që thotë i dërguari dhe konsideron se idetë e tij janë më të sakta se të dërguarit, atëherë kjo, siç sugjeron ajeti, thelbësisht do të thotë se ai nuk është besimtarë i vertetë.

Besimtarët me besim dhe nënshttrim të vërtet e dinë se çka i dërguari thotë është më së miri për ta. Edhe nese këto fjalë janë në kundërshtim me interesat e tyre personale, ata e pranojnë dhe i binden atij energjikisht dhe me entuziazëm. Kjo sjellje e mirë është një shenjë e besimit të drejtë, dhe Allahu u jep lajme të gëzuara për shpëtim për ata të cilët dëgjojnë të dërguarin me kësi bindje. Disa nga ajetet në të cilat Allahu jep lajme të mira janë:

E kush do që i bindet All-llahut dhe të dërguarit, të tillët do të jenë së bashku me ata që All-llahu i shpërbleu: (me) pejgamberët, besnikët e dalluar, dëshmorët dhe me të mirët. Sa shokë të mirë janë ata!(Nisa': 69)

Kush respekton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, ia ka frikën All-llahut dhe i përmbahet udhëzimit të Tij, të tillët janë ata që do të arrijnë atë që dëshirojnë. (Nur: 52)

Thuaj: “Respektojeni All-llahun, respektojeni të dërguarin!” Nëse ata refuzojnë, atëherë atij i takon përgjigjsia me çka është i ngarkuar ndërsa juve përgjigjsia me çka jeni të ngarkuar, nëse i bindeni atij, atëherë keni gjetur të vërtetën. I dërguari ka obligim vetëm komunikimin e qartë. (Nur: 54)

Siç u tha më lart, ata që e dëgjojnë të dërguarin do të jenë të udhëzuar drejtë. Gjatë gjithë historisë, të gjithë popujt janë sprovuar me dëgjushmerinë e tyre ndaj të dërguarve. Allahu gjithmonë i ka zgjedhur të dërguarit nga populli. Në këtë tekst, disa mendjengushtë dhe njerëz të pa ditur nuk e kan kuptuar si t’i binden një njeriu nga mesi i tyre apo një njeriu i cili nuk është më i pasur se ata. Mirëpo, Allahu i ka zgjedhur të dërguarit e Tij, i ka pajisur me përkrahje nga vështrimi i Tij dhe u ka dhënë dituri dhe fuqi. Esenca e arsyes pse këta njerëz dështojnë që plotësisht ta kuptojnë është se, Allahu zgjedhë kënd të doj Ai. Besimtari i sinqertë përziemërisht i bindet dhe e respekton atë që e ka zgjedhë Allahu, dhe bëhet shumë i devotshëm. Ai e din se, çdoherë që e dëgjon të dërguarin, ai në fakt e dëgjon Allahun. Ata të cilët janë të nënshtruar Allahut dhe fesë janë gjithashtu plotësisht të nënshtruar të dërguarit të Tij. Allahu tregon situatën e atyre të cilët e nënshtrorjnë vetën ndaj Tij si vijon:

Nuk është ashtu (si thonë ata), po ai që është dorëzuar All-llahut dhe është bamirës, ai e ka shpërblimin e vet te Allahu i tij, për ata nuk ka frikë, as nuk kanë pse të mërziten. (Bekare: 112)

Veprat e atyre të cilët e ngritin zërin e tyre mbi zërin e peygamberit bëhen të pavlefshme

Në një ajet, Allahu thotë:

O ju që keni besuar, mos ngritni zërin tuaj mbi zërin e Peygamberit dhe mos iu ngërmoni atij si i ngërmoheni njëri-tjetrit, e të zhduken veprat tuaja duke mos ditur ju. Ata që ulin zërat e tyre pranë të dërguarit të All-llahut, All-llahu zemrat e tyre i ka përshtatur për devotshmëri, ata kanë falje mëkatesh dhe shpërblim të madh. (Huxhurat: 2-3)

Pejgamberi i Allahut gjithmonë i thërret besimtarët në rrugën e drejtë, dhe më të bukur. Sigurisht ka raste kur këto thirrje të pejgamberve bien në konflikt me interesat e njerëzve rreth tyre.

Mirëpo, ata që besojnë dhe dëgjojnë të dërguarin nuk e ndjekun mendimin e tyre, por ma parë dorëzohen në fjalët e Allahut, pejgamberit të Tij dhe Kur'anit. Në anën tjetër, ata me besim të dobët apo ata që nuk mund t'i mbajnë dëshirat e tyre nder kontroll mund të shfaqin jodëgjueshmëri apo dobsim mbi thirrjen e të dërguarit. Siç u tha në ajet, zërat e tyre, fjalimet dhe fjalët që ata i shqiptojnë mund të nxjerr në shesh sëmundjen në zemrat e tyre dhe dobësin e tyre në dëgjueshmëri. Ata mund të jenë aq të paditur që të kundërshtojnë çka i dërguari thotë dhe t'i ngrisin zërat e tyre mbi zërin e tij. Allahu na informon se veprimet e këtyre njërzve do të anulohen. Allahu ka informuar se të gjitha përpjekjet e përsosur të till, edhe nese ai punon ditë e natë në mënyrë që të përhapë fenë, do të viejnë në asgjë në raport me jodëgjueshmërinë e tij.

Ky është një sekret shumë me rëndësi i shpallur në shumë ajete në Kur'an. Allahu i ka urdhëruar njerëzit të bëjnë punë të mira, të shërbejnë energjikisht dhe vendosmërisht për të mirën e Islamit, të punojnë në pajtueshmëri me moralet e mira të përshkruara në Kur'an, të jenë zemërgjerë, të palëkundur, durimtarë, të sinçertë dhe të

besueshëm. Pa dyshim, të gjitha këto janë forma të rëndësishme të adhurimit që do t'i ndihmojnë në ahiret. Megjithatë, siç pamë në suren “Huxhurat”, një veprim i vetëm i qëndrim jorespektues ndaj të dërguarit të Allahut mund t'i shëndrrojë të gjitha veprimet e atij personi në të padobi. Kjo, padyshim, na kujton neve edhe një herë sa me rëndësi është ta nderojmë dhe respektojmë të dërguarin e Allahut.

Allahu u a merr forcën atyre të cilët nuk i binden të dërguarit

Incidenti i Talutit dhe armatës së tij e treguar në Kur'an është edhe një përkujtim, i cili vendosë kuptim të fuqishëm në rëndësinë e dëgjimit të të dërguarit të Allahut. Si është shpallur në Kur'an, kur Taluti, i dërguari i Allahut, dual me forcat e tij kundër armikut, ai i paralajmroj njerëzit e tij kundër pirjes nga lumi të cilin ata do ta kalojnë. Ajeti në lidhmëri është:

E kur doli (prej qytetit) Taluti me ushtrinë, tha: “All-llahu do t'ju sprovtojë me një lumë, e ai që pi prej atij, ai nuk është me mua, e kush nuk shijon atë, ai është me mua, përveç atij që me dorën e vet e pi një grusht!” Mirëpo, me përjashtim të një pakice prej tyre, të tjerët pinë nga ai. E kur e kaloi ai (Taluti) atë së bashku me te edhe ata që ishin besimtarë thanë: “Ne sot nuk kemi fuqi kundër Xhalutit dhe ushtrisë së tij!” Po ata që ishin të bindur se do ta takonin All-llahun thanë: “Sa e sa grupe të vogla me dëshirën e All-llahut kanë triumfuar ndaj grupeve të mëdha!” All-llahu është me durimtarët. (Bekare: 249)

Siç u pa në ajet, ata të cilët nuk e dëgjuan urdhërat e Talutit u bënë të dobët, ndërsa ata të cilët e dëgjuan Talutin u është dhënë forcë nga Allahu dhe me dëshirën e Allahut munden armikun edhe pse ata ishin shumicë. Këto janë sekrete që Allahu i shpalli njerëzimit në Kur'an. Fuqia, fitorja dhe epërsia nuk janë në pasuri materiale, status me

prestigj, të qenurit shumicë apo posedimi i epërsisë trupore. Kushdo që i zbaton kufijtë e Allahut, i bindet Atij dhe peygamberit të Tij, Allahu i bënë ata më të fortë se të tjerët, dhe i shpërblen me dhurata të panumërta, siç janë mençuria, shëndeti, bukuria, bekimi dhe pasuria. Për ata që janë të gatshëm me u qua me të derguarin e Allahut është përgaditur jetë e bukur e përhershme për ata në ahiret.

NJË NUMËR I VOGËL I BESIMTARËVE MUND TA MPOSHT SHUMICEN JOBESIMTARE



Një nga mrekullit e Allahut është se besimtarët, edhe pse janë pakicë, me Dëshirën e Allahut, gjithmonë i mposhtin armiqët e tyre. Ky është një sekret i rëndësishëm që Allahu shpalli në shumë ajete dhe i drejton jobesimtarët të gabojnë. Siç u pa në tregimin e Talutit, Allahu i ka bërë besimtarët fitimtarë për arsye të dëgjueshmërisë së tyre, edhe pse në fakt ata ishin një numër i vogël. Allahu përfundon tregimin e Talutit me këto fjalë:

"Sa e sa grupe të vogla me dëshirën e All-llahut kanë triumfuar ndaj grupeve të mëdha!" All-llahu është me durimtarët." (Bekare: 249)

Palekundëshmëria u sjell forcë të madhe besimtarëve

Siç theksohet herë pas here në këtë libër, ka shumë sekrete të fshehëta në ajetet e Kur'anit. Një nga këto sekrete është për palëkundëshmërinë. Allahu jep lajme të gëzuara se ata të cilët janë të palëkundur do të bëhen më të fortë. Mbaje mend se tërë fuqia i takon Allahut. Bile edhe forca e një personi i cili është kundër Allahut, në fakt, i takon Allahut. Allahu u jep disa aftësi njerëzve deri sa t'i vë ata dhe ata përreth tyre në sprovë. Në të njëjtën mënyrë Ai i merr aq lehtë sa edhe kur i jep, kurdo që Ai don. Allahu na informon neve se ata të cilët janë të palëkundur do të jenë të fortë, kjo është sepse, Ai do t'i përforcojë ata. Për këtë, Allahu thotë:

Po, nëse jeni të qëndrueshëm e të matur, e ata (armiqtë) t'ju vinë tash në këtë momoent, Allahu juaj ua vazhdon juve ndihmën me pesë mijë prej engjëjve të ushtruar (për luftë) ose të shënuar. (Ali 'Imran: 125)

Siç u tha në ajetin e mësipërm, nëse Allahu don, Ai mund t'i bëjë njerëzit fitues në mënyrë të padukëshme. Në përpjekjet e ndonjërit që të përkrah fenë e Allahut, psh, Allahu mund t'i siguroj mbështetje të lehtë që t'i mundsoj personit që të bëhet inspiruesi më i madh dhe ligjeruesi me ndikimin më të madh dhe që t'i kthej zemërat e njerëzve që e ndëgjojnë drejtë fesë. Si pasojë, askush nuk mund të fitoj një fitore apo shfaq ndikim në të tjerët mos me dashtë Allahu. Pronari i të gjithë arritjeve, fitoreve dhe inspirimeve është Allahu. Çka i ndodh njerëzimit ka për t'i përcjellë urdhërat e Allahut dhe vërejtje kufijte e Tij. Në një ajet tjetër, Allahu informon besimtarët se si të arrijnë forcë të madhe:

O Pejgamber! Nxiti besimtarët për luftë. Nëse prej jush janë njëzet të durueshëm, (trima të fqishëm), do t'i mundni dyqind, e nëse janë njëqind, do t'i mundni njëmijë sish që nuk besuan, për shkak se ata janë njerëz që nuk kuptojnë (pse luftojnë).

All-llahu ju bëri lehtësim tash duke ditur se jeni dobësuar. Nëse prej jush janë njënjëqind të durueshëm, do t'i mundni dyqind, e nëse prej jush janë një mijë, me ndimën e Allahut do t'i mundni dy mijë. All-llahu është me ata që janë të durueshëm. (Enfal: 65-66)

Siç thotë Allahu në këto ajete, nëse besimtarët nuk kanë dobësi në vetëvete, dhe janë të vendosur në palekundëshmëri dhe besim, fuqia e një besimtari mund të barazohet me të dhjetë njerëzve. Në këtë kontekst, fjala “forca” mbanë domethënë tjetër, ndryshe nga fuqia fizike. Psh, përpjekjet e një besimtari të bartë porosinë e fesë dhe t'i thërret njerëzit në rrugën e Allahut mund të jetë e barabartë me përpjekjet e dhjetë njerëzve. Si rrjedhim, dituria e një besimtari mund të barazohet me diturinë e dhjetë njerëzve. Një punë e mirë e bërë nga besimtari vetëm për fitimin e kënaqësisë së Allahut, mund të barazohet me punët e mira të dhjetë njerëzve bashkarisht. Një besimtar i vetëm mund të ftojë më shumë njerëz se dhjetë jobesimtar që mund t'i largojnë nga rruga e Allahut dhe mund të jetë një mënyrë e përmirësimit të besimit të tyre. Një besimtarë i vetëm mund të shkatërroj çka dhjetë jobesimtarët bisedojnë dhe ëndrojnë atë me të vërtetën.

Ky sekret që Allahu e shpallë në Kur'an është e një rëndësie të madhe. Për arsye se, nëse të gjithë muslimanët garojnë njëri-tjetrin drejt udhës së drejtë, pa marr parasysh sa i vogël grupi mund të jetë, Allahu do t'i bëjë ata fitues në çdo punë që ata e ndërmarrin. Psh, nëse është e tërë bota me njerëz jobesimtar, profesora jobesimtar nga universitetet e tërë botës të cilët i drejtojnë të gjithë njerëzit në çdo vend në jobesim, Allahu e paraqet një grup të vogël të muslimanëve të fuqishëm, të aftë dhe bollë të ditur tu tregojnë të gjithë këtyre njerëzve rrugën e drejtë. Allahu u lehtësonë besimtarëve punët e tyre ndërsa ua vështirson punët jobesimtarëve. Për këtë arsye, besimtarët të cilët e dijnë këtë sekret kurrë nuk duhet ta zvoglojnë përpjekjen e tyre dhe të thonë ”a do të ndihmojnë përpjekjet e mia me ndërrue këtë situatë” por më fortë të

jenë të sigurtë se Allahu do tu a shpërblej më efektshëm çdo punë të sinqertë që e kanë bërë me qëllimin e vetëm për kënaqsinë e Allahut. Një pjesë e shkruar për ekzistimin e Allahut, një fjalë që thërret njerëzit të Allahu apo një veprim në pajtueshmëri me vlerat morale të Kur'anit mund t'i drejtoj shumë njerëz në shpetim dhe të ngjallë në ta dashuri dhe frikë për Allahun. Ne duhet të mbajmë mend se ligjet dhe dukuritë efekt-pasojë që vlejnë për këtë botë janë vetëm çka është shpallur në Kur'an nga Allahu. Çdonjëri që mendon në përputhje me Kur'anin mund të kuptojë këto sekrete në krijimet e Allahut dhe, me Dëshirën e Allahut, ta arrijë një fuqi më të madhe dhe urtësi mbi dhe përtej çka ndonjë njeri mund të arrijë. Allahu u jep besimtarëve të vërtetë lajmin e mirë se ata do t'i mposhtin jobesimtarët përderisa janë të vendosur në besimin e tyre:

E mos u dobësoni (fizikisht) dhe mos u dëshproni (shpirtërisht) derisa ju jeni më të lartit, po qe se jeni besimtarë të sinqert. (Ali 'Imran: 139)

Siç u pa në ajet, kusht i kërkuar për me qenë fitues dhe më i mirë në të dy botërat, është besimi i sinqertë. Edhe një tjetër sekret i lidhur me këtë çështje në Kur'an është besim pa i bërë partner Allahut.

ALLAHU E BËNË FENË E TIJ MË TË LARTË KUR NDONJËRI E ADHURONË VETËM ATË



Një prej qëllimeve më të rëndësishme të një muslimanit në këtë jetë është përhapja e moraleve Kur'anore kudo në botë, që njerëzit t'i shërbejnë Allahut ashtu si duhet. Në Kur'an, Allahu u ka treguar besimtarëve udhen për arritjen e këtyre qëllimeve dhe i ka urdhëruar si më poshtë:

Atyre nga mesi juaj të cilët besuan dhë bënë vepra të mira All-llahu u premtoi se do t'i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si pat bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t'u dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe pas kësaj mohon, të tillë janë ata më të prishurit. (Nur: 55)

Sipas një sekreti që Allahu u shpalli besimtarëve, Allahu do të siguroj vendosjen e vlerave Kur'anore kudo në botë, nëse besimtarët

adhurojnë vetëm Allahun, pa i përshkruar Atij partner. Ky është një sekret shumë me rëndësi, sepse tregon se është përgjegjësi e çdo besimtari të përhap udhëzimet e Kur'anit midis njerëzve. Pasi që ky është rasti, çdo besimtar me ndërgjegjëje, saktësisht duhet t'i shmangët përshkrimin partner Allahut dhe të adhuroj vetëm Atë. Para se gjithash, përshkrimi partner Allahut është një mekat që Allahu nuk e fal dhe i cili e dërgon njeriun në xehennem. Megjithatë, mund të jetë që shumica e njerëzimit e lidhin këtë koncept me paganët të cilët i adhuronin idhujt. Njerëzimi gjithashtu duhet të jetë i kujdesshëm për "idhullin e fshehur". Në këtë formë të idhullit, ndonjëri mund lehtë të shpreh besimin e tij në Allahun, pranimin e Allahut si Një dhe i Vetmi Zotë dhe Krijues dhe të shfaq degjueshmëri ndaj Tij. Por, friksimi nga ndonjë gjallesë tjetër, pos Allahut, konsiderimi se pranimi dhe përkrahja e njerëzve të tjerë është më me rëndësi, konsiderimi se tregtia, familja dhe origjina janë ma të rëndësishëm se Allahu dhe luftimi në rrugën e tij, janë plotësisht idhujtari. Ndjenja e vërtetë e besimit siç u shpjegua në Kur'an mendon për kënaqësinë e Allahut mbi të gjitha. Dashuria e shfaqur ndaj të gjitha gjallesave tjera përveç se Allahut, mund të jenë vetëm mënyra për fitimin e kënaqësisë së Allahut. Ata të cilët ndihen borxhli ndaj njerëzve për ndonjë të mirë të dhënë atyre, të cilët i respektojnë ata si mbrojtës të tyre janë, në fakt, idhujtar. Kjo është për arsye se, i Vetmi që dhuron lloje të ndryshme të mjeteve jetësore njerëzve është Allahu; i Vetmi që ushqën, mbron dhe strehon çdo qenie të gjallë dhe u kthen atyre shendetin kur janë të sëmur, është vetëm Allahu. Nëse Allahu don, Ai e kthen njeriun e sëmur në të shëndosh me dorë të doktorit. Në këtë kuptim, është jologjike për dikën që t'i mbështet shpresat e tij vetëm në doktorin. Sepse, asnjë doktor nuk mund ta sheroj pacientin pa dëshirën e Allahut. Një personi që ju ka përmirsuar shendetin duhet ta shoh doktorin si një person që me aftësitë e të cilit Allahu ja ka kthyer shendetin dhe, prandaj, të shpreh respektin

e duhur për doktorin. Mirëpo, duke ditur se është në të vërtetë Allahu Ai që shëron, është Allahu të cilit ai duhet t'i jetë mirënjohës. Përndryshe, ai do t'i përshkruaj Allahut partner dhe do t'i përshkruaj një atribut të Allahut njeriut. Të gjithë muslimanët duhet t'i shmangën idhujtarive të fshehëta, dhe bëjnë shokë, të besuar dhe mbrojtës tjerë përveç Allahut.

JETA E KËSAJ BOTE ËSHTË NË FAKT SHUMË E SHKURTËR



Shumica e njerëzve janë të lidhur për këtë botë sikur se ata kurrë nuk do të vdesin, dhe kështu nuk jetojnë sipas fesë dhe me mendimin e vdekjes dhe ahiretit. Mirëpo, jeta e kësaj bote, për të cilën ata janë të lidhur aq fort, është shumë e shkurtër dhe kalimtare. Edhe atyre me jetë të gjatë sigurisht do të ju vijë rradha për vdekje një ditë. Kjo, jetë e kësaj bote nuk është aq e gjatë sa që duket të jetë. Allahu shpall këtë sekret për njerëzimin në shumë ajete Kur'anore:

Ai thotë: “E sa vjet keni kaluar në tokë?” Ata thonë: “Kemi qëndruar një ditë ose një pjesë të ditës, pyeti ata që dinë numërimin!” Ai thotë: “Mirë e keni, sikur ta dishit njëmend pak keni qëndruar!” A menduat se Ne u krijuam kot dhe se nuk do ktheheni ju te Ne? (Mu'minun: 112-115)

E ditën kur të bëhet kijameti (ditën e gjykimit), kriminelët betohen se nuk qëndruan (në dunja) gjatë, por vetëm një çast të shkurtër. Kështu kanë qenë ata që i bishtëruan të së vërtetës. (Rrum: 55)

Më sipër janë bisedat ndërmjet atyre që janë grumbulluar bashkarisht për llogari. Siç sugjerojnë edhe këto bisedime, pas vdekjes njerëzit kuptojnë se ata, në fakt, kanë qëndruar në këtë botë vetëm pak. Kjo, perioda, e cila duket të jetë gjashtë apo shtatë dekada në jetën e kësaj bote, është në fakt e shkurtër si një ditë apo bile shumë më e shkurtër. Kjo është e ngjashme me rastin e një njeriu i cili supozon se ai ka kaluar ditë, muaj apo bile edhe vjetë në ëndrrat e tij, por i cili, pas zgjimit, e kupton se ai ka ëndrruar vetëm për disa sekonda.

Disa parashikime do t'i mundsojnë njeriut të kuptoj shkurtsinë dhe karakterin e përkohshëm të jetës së kësaj bote. Psh, çdonjëri bënë plane të caktuara dhe i vendosë disa qëllime për jetën e tij. Keto plane dhe qëllime kurrë nuk mbarojnë. Ato përcjellin njëra tjetrën. Në mënyrë tipike, një person diplomon në shkollë të lartë, regjistrohet në fakultet, dhe fillon një punë në një kompani. Të gjitha këto janë, prapseprap, përvojë e shkurtër. Në rini, njëri vështir që imagjinon se do t'i arrij të tridhjetat. Tashmë pas një kohe të shkurtër ai i ka arritur të dyzetat.

Jeta e shkurtër e kësaj bote është një fakt i sigurt që Allahu e shpall në Kur'an që mund të kuptohet nga çdonjëri para vdekjes. Për ata që e kuptojnë këtë do të ishte budallaki ta lënë pas dore pafundshmërinë dhe jetën e vërtetë të ahiretit për një kesi jete të shkurtër dhe kalimtare. Disa nga ajetet në të cilat Allahu i paralajmron njerëzit për kohën e shkurtër të kësaj bote janë:

'O populli im, kjo jetë e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se një përjetim i përkohshëm, ndërsa bota tjetër është ajo e përhershmeja.' (Gafir: 39)

Vërtet, ata (idhujtarët) e duan shumë këtë jetë dhe e zënë asgjë ditën e rëndë që i pret. (Insan: 27)

NË ZEMRAT E JOBESIMTARËVE ALLAHU HEDH FRIKË



Allahu shpall në shumë ajete se Ai hedh frikë në zemrat e atyre të cilët nuk besojnë:

Edhe kur Allahu yt u kumtoi engjëjve se: “Unë jam me ju, pra, inkurajoni ata që besuan! Unë do të hedh frikë në zemrat e atyre që nuk besuan...” (Enfal: 12)

Ai është që në dëbimin e parë i nxori prej shtëpive të tyre ata nga ithtarët e librit, të cilët nuk besuan. Ju nuk menduat se ata do të dalin, e ata menduan se fortifikatat e tyre do t'i mbronin prej ndëshkimit të All-llahut, po All-llahu u erdhi atyre nga nuk e kishin menduar dhe në zemrat e tyre hodhi frikën ashtu që me duart e veta dhe me duar të besimtarëve rrëzonin shtëpitë e veta; pra merrni përvojë o ju të zotët e mendjes.(Hashr: 2)

Ajo që u tha në këto ajete është mrekulli nga Allahu. Përmes hudhjes se frikës në zemërat e tyre, Allahu dobëson forcën e atyre të cilët pengojnë besimtarët dhe të cilët kundërshtojnë Allahun dhe fenë

e Tij. Është e rëndësisë së madhe që besimtarët do të duhej të mendojnë në këto ajete dhe të nxjerrin mësimë për vete. Kjo është për arsye se, siç u përmend në kapitullin e mëparshëm, zemërat tona janë në dorën e Allahut, dhe Allahu mbjell çfarëdo që Ai don në zemërat e kujt do që Ai don. Detyra e besimtarit s'është të tentoj të shkaktoj ndikim në të tjerët, por vetëm të jetë i sinqertë. Psh, një besimtar është përgjigjs të këshilloj një person në dritën e ajeteve të Allahut. Mirëpo, ai person do të udhëzohet drejtë me këshillën e dhënë vetëm, pa marr parasysh sa i qartë ishte shpjegimi, nëse Allahu e udhëzon atë njëri në rrugë të drejtë. Me të njëjtat tipare, një besimtarë është i paaftë kundër rrezikut. Si rrjedhim, nuk ka fuqi me e friksue armikun. Por Allahu i mbronë dhe përkrahë besimtarët që janë të sinqertë dhe vendosin përpjekjet e tyre përpara për hirë të kënaqësis së Allahut. Psh, siç u tha në ajetin e mëparshëm, Ai hedh frikë në zemërat e armiqve të tyre, duke i bërë të zënë thellë me problemet e tyre. Në këtë mënyrë, Allahu u jep besimtarëve qetësim.

Allahu shkakton frikë të ndryshme në zemërat e jobesimtarëve. Aty është frika e vdekjes, ardhmerisë, lëndimit, fatkeqësisë natyrore apo frika e humbjes së pasurisë. Si rrjedhim, frika e vdekjes është më e madhja për arsye se një jobesimtar nuk beson në ahiret dhe është fort i lidhur për këtë botë. Duke besuar se ai do të dobësohet në asgjë dhe humbë të gjitha posedimet, frika e madhe për vdekje është në rritje. Në fund të fundit, kjo frikë shtonë dobësimin.

Allahu na tregon neve se në zemërat e jobesimtarëve është hudhur frika për arsye se ata i përshkruajnë Atij partner. Fundin që këta njerëz do ta takojnë është shpallur në Kur'an:

Ne do të mbjellim frikën në zemrat e atyre që nuk besuan sepse ata All-llahut i trillojnë e i mveshin zota të tjerë, duke mos pasur për të kurrëfarë fakti, ndaj vendbanimi i tyre do të jetë xhehennemi. Sa i shëmtuar është vendi i mizorëve.(Ali 'Imran: 151)

URTËSIA DHE FJALIMET BINDËSE JANË BEKIM NGA ALLAHU



Urtësia dhe fjalimet bindëse janë bekime nga Allahu siç është shpallur në ajetët Kur'anore:

Ai ia dhuron urtësinë atij që do, e kujt i është dhënë urtësia, atij pra i është dhuruar mirësi e madhe, përveç të mençurve këtë nuk e kupton kush.(Bekare: 269)

Ne ia forcua edhe sundimin atij, i dhamë mençuri dhe aftësi bindëse. (Sad: 20)

Urtësia dhe fjalimi madhështorë janë dhurata të mëdha. Një temë mund të shpjgohet nga njerëz të ndryshëm me stile të ndryshme. Sidoqoftë, stili më impresiv është ai më i urti dhe më bindësi. Një shpjegim i tillë e bënë vëmendjen e njerit të përqëndrohet, e zgjonë atë nga pavëmendshmë- -ria, inkurajon mendimin në gjërat e ditura por shpesh të harruara. Një përsosje me aftësi të fjalimeve bindëse nuk bënë fjalime të panevojshme të gjata, por i shpreh mendimet dhe vështrimet

më së shkurti, shumë të ngjeshur, akoma në mënyrën më të kuptueshme dhe madhështore të mundshme. Shpjegimet nga një njeri i mençur në një temë janë të kufizuara në disa fjali të sinqerta, dhe kështu bënë ndikim të fortë në të tjerët. Një gjë meriton të përmendet këtu - fjalimet bindëse nuk janë aftësi që mund të mësohen-. Nuk ka rregulla apo pika të ndërlikuara. Kërkon vetëm sinqeritetin dhe lutjen për bekimin e Allahut. Allahu, në rrjedhen e fjalimit të njërit, frymëzon me këtë urtësi kë të don Ai.

Kryevepra ma e madhe e urtësisë dhe fjalimit impresiv është sigurisht Kur'ani, i cili është fjala direkte e Allahut. Kjo urtësi është e veçantë për të gjitha librat e shpallur nga Allahu njerëzimit. Kjo është shpallur në ajetët në vijim: **Atyre u patën ardhur aso lajmesh (të popujve të lashtë), ku ka mjaft qortime, (për ata që kuptojnë). Urtësi e përsosur (është Kur'ani)! Po sa bëjnë dobi qortimet!** (Kamer: 4-5)

NJERIU GJITHASHTU DO TË PËRGJEGJET PËR MENDIMET DHE QËLLIMET E TIJ



Në Kur'an, Allahu urdhëron njeriu të jetojë sipas principeve të fesë vullnetarisht dhe besnikrisht:

... ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aqë më mirë për te. Mirëpo, agjërimi është më i mirë për ju, sikur ta dini.(Bekare: 184)

Vazhdoni rregullisht namazet (faljet), e edhe atë namazin e mesëm, dhe ndaj All-llahut të jeni respektues (në namaze). (Bekare: 238)

Vërtet, Ibrahim i ka qenë shembëlltyrë e të mirave, adhures i All-llahut, besimtarë i drejtë dhe nuk ka qenë nga idhujtarët. (Nahl: 120)

Siç u pa në ajetët e mësipërme, Allahu e udhëzonë njerëzimin t'i kryejnë të gjitha lutjet e tyre me besnikëri. Gjatë kryerjes së lutjës, agjerimit, dhënjes së lëmoshës apo paraqitjes së dëgjueshmërisë, çka me të vërtetë ka rëndësi, është qëllimi i vërtetë dhe mendimet e përzemërta. Në Kur'an, Allahu na e tërheq vëmendjen tonë në ekzistimin e disa njerëzve të cilët kryejnë lutjet apo të cilët japin pasurinë e tyre vetëm për tu treguar. Mund fare mirë të ndodhë që këta njerëz nuk reflektohen në Allahun, dhe nuk mendojnë për pafuqin dhe nënshtrueshmërinë përpara Allahut gjatë lutjes, por vetëm kryejnë rituale. Si rrjedhim, njëri nga jashtë mund të duket se po bënë punë bëmirëse, mund të formoj shkolla apo t'i ndihmoj të varfërit. Mirëpo, veç nëse i ka bërë me qëllim të vetëm për fitimin e kënaqësisë së Allahut, duke menduar në faktin se njeriu është i dobët dhe nevojtar përpara Allahu dhe duke ndier frikë për ahiretin, përndryshe këto veprime mund të mos jenë të pranueshme nga Allahu. Allahu na tregon neve se gjaku i kafshës së sakrifikuar nuk arrin te Ai, por devotshmëria (takva) është ajo që arrin te Ai:

Tek All-llahu nuk arrin as mishi e as gjaku i tyre, por te Ai arrin bindja e juaj. Ai ashtu ua nënshtroi ato juve që ta madhëroni All-llahu për udhëzimet që ua bëri. Bamirësve merru myzhde. (Haxh: 37)

Ndër besimet më të gabuara është se njerëzit supozojnë se ata do të jenë përgjigjs vetëm për veprimet e tyre. Sidoqoft, Allahu na informon neve se njeriu do të jap llogari për qëllimet e tij, mendimet dhe bile edhe çka ai fsheh thellë në zemëren e tij:

Të All-llahut janë ç'ka në qiell dhe ç'ka në tokë, e për atë që e keni në shpirtin tuaj, e shfaqët haptazi ose e mbajtët fshehtë, All-llahu do t'ju marrë në përgjegjësi, e Ai ia fal atij që do dhe dënon atë që do. All-llahu ka mundësi për çdo send. (Bekare: 284)

Allahu ka njohuri për zemëren e përsosur, për ndërgjegjëjen,

mendimet dhe çka mban ai fsheht prej tjerve. Allahu ndërhyt ndërmjet një njeriu dhe zemëres se tij. Prandaj, njeriu nuk mundet të mbaj asgjë fsheht nga Allahu. Çdo dyshim që i kalon në mendje, çdo përshpëritje e djallit, mendimet e tij aktuale për besimtarët, besimi i tij në Kur'an, çfarë kalon nëpër mendjen e tij gjatë lutjes, janë të gjitha të ditura një nga një për Allahun dhe të regjistruara nga Allahu. Psh, Allahu e din kur ndonjëri i kryen lutjet fjetur, apo kur ai fsheh mendime kontradiktore. Njeriu do t'i takoj secilën nga këto në ditën e fundit. Pastrimi i zemëres se ndonjërit, jetesa sipas fesë, jo duke i dalluar vetëm ritualet por gjithashtu duke qënë i sigurtë dhe i vendosur, janë mënyrat që ne do të arrijmë shpëtimin. Thjesht do të ishte pakujdesi me lënë pas dore pafundshmërinë dhe jetën e vërtetë të ahiretit për një jetë të shkurtë dhe të shpejtë. Më posht janë disa ajete në të cilat Allahu e paralajmëron njerëzimin për përkohshmërinë dhe karakterin e jetës së kësaj bote:

O populli im, kjo jetë e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se një përjetim i përkohshëm, ndërsa bota tjetër është ajo e përhershme. (Gafir: 39)

Vërtet, ata (idhujtarët) e duan shumë këtë jetë dhe e zënë asgjë ditën e rëndë që i pret.(Insan: 27)

ALLAHU ËSHTË AI I CILI VENDOS DASHURINË NË ZEMËRAT E NJERËZVE



Në shumë ajete, Allahu shpall se është Ai i Cili vendos dashurinë dhe dhembshurinë në zemërat e njerëzve. Psh, Allahu ka thënë në ajetin vijues se është Ai i Cili i grumbullon besimtarët dhe i bashkon zemërat e tyre sikur të vllëzërve:

Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e All-llahut, e mos u përçani! Përkujtojeni nimetin e All-llahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranoni fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai bashkoi zemërat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të jeni vëllezër. Madje ishit në buzë të greminës së xhehennemit, e Ai ju shpëtoi prej tij. Po kështu All-llahu ua sqaron juve argumentet e veta që ju të gjeni të vërtetën e lumtur. (Ali 'Imran: 103)

Në ajetet tjera, Allahu na informon neve se është Ai i Cili u jep besimtarëve butësinë dhe keqardhjen.

... ashtu Ne i dhamë atij urtësi kur ishte fëmijë. Dhe nga ana jonë i mundësuam të jetë i butë, i pastër dhe respektues (i dëgjueshëm). (Merjem: 12-13)

Nuk ka dyshim se ata që bënë vepra të mira, atyre i Gjithëmëshirshmi do t'u krijojë (në zemërat e tyre) dashuri. (Merjem: 96)

Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vet lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë. (Rum: 21)

Allahu gjithashtu thotë se Ai do të vendosë dashuri ndërmjet besimtarëve dhe atyre që janë armiq të tyre. Është e qartë se Allahu mban kontrollin mbi të gjitha zemërat e të dy palëve besimtarëve dhe njerëzve të tjerë. **Pritet që All-llahu të verë miqësi ndërmjet jush dhe atyre që kishit armiqësi, All-llahu është i fuqishëm, All-llahu falë mëkatet, është mëshirues.** (Mumetehine: 7)

VDEKJA E BESIMTARËVE DHE JOBESIMTARËVE NUK DO TË JETË E NJËJTË



Në Kur'an, Allahu e hap një sekret për vdekjen, i cili është i panjohur për shumë njerëz- çfarë përsone i vdekur aktualisht përjeton, nuk është çka njerëzit tjerë vërejnë nga pamja e jashtme. Allahu na thotë neve në Kur'an si në vijim:

Përse, pra kur arrin shpirti në fyt, e ju në atë moment shikoni (se ç'po i ngjet). E Ne jemi më afër tek ai se ju, por ju nuk shihni. (Waki'a: 83-85)

Edhe një sekret që Allahu e shpall për vdekjen është terrori i madh dhe vuajtjet që i përjetojnë jobesimtarët në momentin e vdekjes. Njerëzit përreth nuk kanë mundësi për të parë këtë terror. Allahu e lidhë këtë fakt në ajetet e Tij si vijon:

E kush është më gabimtar i madh se sa ai që trillon rrenë ndaj Allahut, ose thotë: “Mua po më shpallet e nuk i është shpallur

asgjë, ose se sa ai që thotë: “Do të thur diçka të ngjajshme me atë që e ka zbritur All-llahu”. E, sikur t'i shihje mizorët kur janë në agoni të vdekjes, e engjëjt kanë shtrirë duart e veta (me ndëshkim) e (u thonë): “Shpëtojeni pra vetveten (nëse mundeni)”. “Tash përjetoni dënimin e turpshëm për shkak se e thoshit të pavërtetën për All-llahun, dhe ndaj argumenteve të Tij ishit kryeneç. (En'am: 93)

Po ty të mos duket e mirë pasuria e tyre dhe fëmijët e tyre. All-llahu deshi t'i mundojë me të në këtë botë dhe t'u dalë shpirti duke qenë mohues. (Tewbe: 85)

Në pajtueshmëri me këtë sekret të shpallur në Kur'an, një jobesimtarë mund të duket se ka vdekur i qetë në shtratin e tij. Mund të duket për njerëzit përreth sikur ai nuk ka kaluar nëpër çfarëdo mundimi apo vuajtje në çastin e vdekjes, por se sytë e tij vetëm janë mbyllur. Mirëpo, Allahu na informon neve se një jobesimtarë ndjenë një vuajtje të thellë që ne nuk mund ta shohim. Se si engjujt e marrin jobesimtarin në vdekje është shpjeguar në Kur'an në vijim:

E si do të jetë atëherë puna e tyre kur engjëjt t'ua marrin shpirtin duke i rrahur fytyrave dhe shpinave të tyre? E atë (dënim) për shkak se ata ndoqën rrugë të cilën All-llahu e urren, kurse e urrejtën atë që Ai e pëlqen, prandaj ua asgjësoi veprat e tyre. (Muhammed: 27-28)

Sikur t'i kishe parë engjëjt kur ua marrë shpirtin atyre që mohuan (do të shihje tmerr), u binin fytyrave dhe shpinave të tyre (para, prapa): “Shijoni dënimin e djegëjes!” Këtë (dënim e morët) për shkakun e asaj që fituat. All-llahu nuk është i padrejtë për robtë e Tij (Enfal: 50-51)

Përkundrazi nga kjo vdekje e vështirë e jobesimtarëve, besimtarët përjetojnë vdekje shumë të lehtë. Psh, një besimtarë i cili ka luftuar në luftë pranë pejgamberit (saas) dhe është shpuar me një shpatë, u

lehtësua nga të gjitha format e frikës, përjetoj një moment të qetë të vdekjes. Siç na informon neve Allahu në ajete, shpirtërat e besimtarëve do të merren në gjendje të pastër dhe ata do të jenë të mirëpritur nga engjujt me përshëndetje dhe lajme të mira. Allahu e ka përshkruar vdekjen e besimtarëve si vijon:

... engjëjt ua marrin shpirtin, duke u thënë: “Selamun alejkum” - gjetët shpëtimin, hyni në xhennet, për hir të asaj që vepruat. (Nahl: 32)

LUTJA E LARGON NJERIUN NGA E KEQJA



Lutja (namazi) është porositur për besimtarët në kohë të caktuara të ditës, siç u caktua në Kur'an. Allahu ka premtuar se do t'i shpërblej ata të cilët kujdesen saktësisht për lutjet e tyre dhe të cilët janë të përhershëm në lutjet e tyre. Edhe një shpërblim tjetër që ata të cilët e kryejnë lutjen do të pranojnë është shpallur në Kur'an si vijon:

Ti lexo atë që po të shpallet nga libri (Kur'ani), fal namazin, vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irituarat, e përmendja e All-llahut është më e madhja (e adhurimeve); All-llahu e di çpunoni ju. (Ankebut: 45)

Siç thotë Allahu në ajetin e mësipërm, ata të cilët e kryejnë namazin janë të ruajtur nga gjërat e turpshme dhe nga e keqja. Allahu frymëzon largimin nga keqbërjet e tilla.

Njëri i cili saktësisht ruhet dhe kryen namazin siç është përshkruar në Kur'an, është ai i cili i friksohet Allahut. Njëri që rrin në këmbë, përkulet dhe gjunjëzohet përpara Allahut në kohët e caktuara të ditës sigurisht do të largohet nga veprimet e këqija dhe si pasojë të ndjejë

thellë në zemër frikën nga Allahu. Ndërgjegjëja e njerëzve të tillë, me dëshirën dhe inspirimin e Allahut, do t'i mbaj ata larg nga e keqja dhe gjërat e turpshme. Edhe nese ata bëjnë diçka gabim për shembull, ata do t'i kuptojnë keqbërjet përderisa luten dhe mendon përpara Allahut në fuqin e pafund të Tij. Kështu ata do të pendohen dhe shmangen nga keqbërjet në të ardhmen.

ATA QË JANË MBYTUR NË RRUGEN E ALLAHUT NUK JANË TË VDEKUR



Allahu ka shpallur në Kur'an se ata të cilët vdesin në rrugën e Tij në fakt nuk janë “të vdekur”, por janë të gjallë në praninë e Tij. Ky fakt është i lidhur në ajetin që vijon:

Kurrsesi të mos mendoni se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në rrugën e All-llahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer te Allahu i tyre. Janë të gëzuar me atë që u dha All-llahu nga të mirat e Tij, dhe atyre që kanë mbetur ende pa i bashkuar rradhëve të tyre, u marrin myzhde se për ta nuk ka as frikë dhe as që kanë pse të brengosen. Ata janë të gëzuar me begati e dhurata që ua dha All-llahu, e s'ka dyshim se All-llahu nuk ua humb shpërblimin besimtarëve. (Ali 'Imran: 169-171)

E për ata që u mbytën në rrugën e All-llahut mos thoni: “Janë të vdekur”, Jo, ata janë të gjallë, por ju nuk kuptoni (gjallërinë e tyre). (Bekare: 154)

Udhëheqja e shehidave është plotsisht në praninë e Allahut, dhe fakti se ata janë të mirëseardhur në xhennet është edhe një sekret tjetër që Allahu e shpall në Kur'an.

... E ata që ranë dëshmorë në rrugën e All-llahut, atyre kurrsesi nuk ua humb veprat (por ua shton). Ata do t'i udhëzojë dhe do të përmirësojë gjendjen e tyre. Dhe do t'i shtie në Xhennetin, të cilin ua ka bërë të njohur atyre. (Muhammed: 4-6)

Allahu i tyre iu përgjegj lutjes së tyre (e tha): Unë nuk ia humb mundin asnjërit prej jush, mashkull qoftë apo femër. Ju jeni njëri nga tjetri por ata që u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe emigruan, u munduan vetëm pse ishin në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, atyre patjetër do t'ua shlyej mëkatet e tyre dhe do t'i vejë në xhennete në të cilët burojnë lumenj. Ai është shpërblim nga ana e All-llahut, se më i miri i shpërblimeve është tek All-llahu. (Surah Ali 'Imran: 195)

E ata që për hir të All-llahut braktisën atdheun e tyre, (e duke luftuar) u vranë ose vdiqën, All-llahu do t'i shpërblejë me shpërblimin më të mirë, e s'ka dyshim All-llahu është më i miri shpërbljes. Ata do t'i vë në një vend ku do të jenë të kënaqur. All-llahu di më së miri (kush çka meriton) dhe është shumë i butë. (Haxh: 58-59)

Faktet e shpallura në ajetet e mësipërme për ata të cilët janë mbytur në rrugën e Allahut janë një ndër sekretet e Kur'anit, të cilët nuk i dinë shumica e njerëzve.

ALLAHU ËSHTË DHURUESI I NDERIT



S humë njerëz të cilët nuk besojnë në ahiretin duan pushtetin, forcën dhe epërsinë në botë, duke pretenduar se jeta e tyre është vetëm ajo e kësaj bote. Gjatë gjithë jetës së tyre, ata përpiçën me lakmi për këtë qëllim. Ata i kanë vlerësimet dhe kriteret e veta për të qenurit të fuqishëm, i fortë dhe i ndershëm. Sipas kriterit të tyre, njëri duhet të jetë i pasur, të ketë funksion kryesues në shoqëri dhe reputacion. Nese do të humbnin ndonjëren nga këto, ata mendojnë se i tërë respekti, nderi dhe autoriteti kanë përfunduar. Ata janë, megjithatë, duke gabuar. Ky gabim është shpjeguar në Kur'an:

Dhe kur ata në vend të All-llahut adhuruan zota tjerë për t'u krenuar me ta. Përkundrazi, ata (idhujt) do të tërhiqen prej adhurimit të atyre dhe do të bëhen armiq të tyre. (Merjem: 81-82)

Poseduesi i vetëm i pushtetit dhe fuqisë është Allahu dhe Ai i jep pushtet dhe fuqi kujdo që Ai dëshiron. Prandaj, ata të cilët drejtohen në mënyra tjera të arrijnë pushtetin dhe epërsinë ndryshe nga lutja Allahut janë në fakt duke i bërë shokë Atij. Kjo është për arsye se as pasuria, as

autoriteti, as statusi që ka një përsôn nuk do ta pajis një përsôn me pushtet. Veç kësaj, është çështje e një momenti të vetëm për Allahun që t'ia marr një përsôn pushtetin. Psh, kryesori qëveritar mund të humb tërë pasurinë e tij, autoritetin dhe statusin e tij në një moment, për arsye se i vetmi posedues i të gjithave është Allahu.

Allahu dhuron pushtet dhe nder në robërit e Tij të cilët janë shokë të Tij, të cilët janë përzemërsisht të devotëshëm ndaj Tij dhe të cilët e zbatojnë Kur'anin. Një përsôn që jeton sipas Kur'anit kurrë nuk bënë çfarëdoqoftë që ka mundësi me i sjell humbjen e nderit, të ndjen keqardhje apo turp në praninë e Allahut. Besimtarët e vërtetë nuk i frikohen askujt dhe asnjë pushteti, kurrë nuk ia mbajnë anën ndokujtë. Ata vetëm duan të arrijnë kënaqësinë e Allahut dhe i frikohen vetëm Allahut. Kjo është pse ata nuk kanë çfarëdo dobësie apo ndonjë ndjenjë të pamjaftueshmërisë. Megjithëse ata tani nuk zotrojnë çfarëdo posedimesh, pasuri, rank apo autoritet, Allahu u dhuron pushtet dhe nder atyre. Një përsôn i till, ndërkohë, mbanë epërsinë dhe nderin e të qenurit besnik dhe të jeton sipas moraleve të Kur'anit. Për këtë Allahu thotë si në vijim:

... Ndërsa e tërë krenaria i takon All-llahut, të dërguarit të Tij dhe besimtarëve, por hipokritët këtë nuk e dinë. (Munafikun: 8)

SEKRETET E ZBULIMIT TË RRUGËS SË DREJTË



Pothuajse secili i ka të drejtat dhe gabimet e veta. Kriteri i përdorur për t'i përkufizuar këto të drejta dhe gabime ndryshon shumë. Një libër, një person, një poetikan, apo, nganjëherë, një filozof mund të jetë udhëzues në jetën e një personi. Mirëpo, udha e drejt, e cila është udha e vetme që shpie në shpëtim, është feja që Allahu e ka zgjedhur. Në këtë udhë, qëllimi i vetëm është fitimi i kënaqësisë, mëshires dhe xhennetit të Allahut. Udhët tjera, pa marrë parasysh sa tërhjekse mund të dukën, janë mashtruese dhe drejtojnë në shkatërrim, pamundësi, hidhërim dhe dënim të vështirë në të dy botërat, këtu dhe në ahiret.

Ata që janë të udhëzuar në rrugën e drejtë janë një sekret i shpallur në Kur'an. Ata janë robërit që Allahu i ka udhëzuar në rrugën e drejt të Tij dhe të cilët e fitojnë xhennetin e Tij. Çka duhet të posedojmë për meqenë të udhëzuar në rrugën e drejt?

Besimi me bindshmëri

Para se gjithash, njëri duhet të ketë besimin në mënyrë që të jetë i udhëzuar në rrugën e drejtë. Nese njëri beson se poseduesi dhe krijuesi i vetëm i qiellit dhe tokës dhe çdogjëje në mes është Allahu dhe është i sigurtë se arsyeja e eksistimit të tij në këtë botë është të jetë rob i Allahut, dhe të përpiçët të fitoj kënaqësinë e Allahut, Allahu gjatë gjithë jetës së tij e udhëzon atë në rrugëjn e drejtë. Besimi në Allahun, në ahiretin dhe në Kur'an duhet të jetë një besim i vendosur dhe i sigurtë. Ndonëse disa njerëz thonë se ata janë besimtar, ata mund të kenë dyshime. Kur ata janë se bashku me jobesimtarët dhe janë nën ndikimin e tyre, njerëzit e tillë mund të shfaqin dobësinë dhe të marrin qëndrim armiqsor kundër Allahut dhe fesë së tij. Mirëpo, ata që Allahu i udhëzon në rrugën e drejtë kanë një besim të vendosur dhe të patundur:

E, edhe për ta vërtetuar të dijsmit se me të vërtetë ai (Kur'anin) është vërtetë prej Allahut tënd dhe kështu t'i besojnë atij (Kur'anit) dhe (zemrat e tyre) të bindën ndaj tij. E All-llahu patjetër do t'i udhëzojë ata që besuan në rrugën e drejtë. (Haxh: 54)

Kthimi te Allahu me nënshtrim të plotë

Për besimtarë' kthimi me nënshtrim të plotë është edhe një sekret i të qenurit i udhëzuar në rrugën e drejtë. Për njërin që beson në Allahun dhe i frikohet ahiretit, kjo jetë nuk ka kënaqësi për të.

Kur qëllimi i vetëm është me fitua kënaqësinë e Allahut, besimtarët e vërtetë kthehen te Allahu në të gjitha veprimet e tyre, dhe duke ditur se Allahu i sprovon ata, ata e nënshtrajnë vetëvetën në fatin që Allahu e ka paracaktuar. Allahu ka informuar se ata të cilët e nënshtrajnë vetën te Ai do të jenë të udhëzuar në rrugën e drejtë:

Si bën të mos besoni, kur juve janë duke iu lexuar (duke iu shpallur) ajetet e All-llahut dhe kur në mesin tuaj gjendet i derguari i Tij? E kush i përmbahet fesë së All-llahut, ai padyshim është i udhëzuar në rrugën e drejtë. (Ali 'Imran: 101)

Ai u përcaktoi juve fe atë që i pat përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. (I porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të. Për idhujtarët është rëndë kjo në çka ju i thirrni ata. All-llahu veçon për të (për besim të drejtë) atë që do dhe e udhëzon atë që i drejtohet Atij. (Shura: 13)

Zbatimi i këshillës së dhënë

Edhe një tjetër urdhër nga Allahu të robët e Tij të cilët deshirojnë që të jenë të udhëzuar në rrugën e drejtë është si në vijim:

... Po sikur të zbatonin atë që këshilloheshin do të ishte më mirë për ta dhe do t'i përforconte më shumë. Dhe atëherë do t'u jepnim atyre nga ana Jonë shpërblim të madh. Dhe do t'i udhëzonim në rrugë të drejtë. (Nisa': 66-68)

Besimtarët që i frikohën Allahut përpiqën që të pastrojnë vetëvetën nga keqbërjet e tyre dhe që të arrijnë moralin e përsosur, me çka Allahu do të jetë shumë i kënaqur. Mirëpo, njërit i duhet përlësia që të jetë i falur nga gabimet dhe pranoj udhëzimin për rrugën e drejtë. Një person i thjeshtë i cili përpiqet që të pastroj vetën do që, së pari, përpikërisht t'i zbatoj urdhërat e Allahut. Përveç kësaj, besimtarët e sinqertë janë shokë dhe mbrojtës të njëri tjetrit. Ata urdhërojnë për punë të mira dhe ndalojnë nga të këqijat. Prandaj, duke ditur se paralajmrimi i një besimtari është e një rëndësie të madhe për llogarin e njërit në ahiret, besimtarët do të duhej gjithashtu të jenë përcptues në këshillimet e njëri tjetrit. Ai i cili e zbaton këshillën e mirë do të udhëzohet në rrugën

e drejtë. Allahu u jep lajme të mira robërve të Tij të cilët i largohen përcjelljes së shejtanit dhe i dëgjojnë ata të cilët thërrasin për te Allahu dhe te urdhërat e Tij:

Ndërkaq, ata që u larguan prej adhurimit të idhujve dhe ju drejtuan All-llahut, ata kanë gëzim të madh, e ti përgëzoj robërit e Mi! Të cilët i dëgjojnë fjalët dhe pasojnë atë më të mirën prej tyre. Të tillët janë ata që All-llahu i udhëzoi në rrugën e drejtë dhe të tillët janë ata të mençurit. (Zumer: 17-18)

UNI I NJERIU URDHËRON PUNË TË KËQIJA



Uni i njeriut është forca urdhëruese përmbranda tij dhe i dinë të dy prishjet dhe si t'i largohet atyre. Me fjalë të tjera, uni është ai i cili inspiron për punë të këqija dhe të liga. Allahu i ka shpall këto dy tipare të unit në Kur'an si në vijim:

Pasha unin(nefsin) dhe Atë që e krijoi atë! Dhe ia mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij. Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten. (Shams: 7-9)

Uni është përmendur në ajete si burim i të gjitha prishjeve dhe veprimeve të këqija të njerëzve. Duke pasur kësi tipari, uni është në mesin e armiqve më të dalluar të njerëzimit. Uni është vetjak dhe mendjemadh; gjithmonë dëshiron t'i kënaq dëshirat dhe kotësitë e veta. Përkujdeset vetëm për nevojat e veta, e intereson dhe e kërkon vetëm kënaqësinë. Drejtohet me të gjitha metodat që ta provokoj njerëzimin pasi që nuk është gjithmonë e mundshme t'i plotësoj dëshirat e veta përmes rrugëve legale. Fjalët e Pejgamberit Jusuf (as) shpjegojnë këtë fakt në Kur'an si në vijim:

Unë nuk e çfajtoj veten time, pse uni është shumë nxitës për të keqën, përveç atë që ka mëshiruar Zoti im, se Zoti im është që fal e mëshiron shumë. (Jusuf: 53)

Se uni i ndonjërit fuqishëm inspiron për punë të këqija dhe të liga është një sekret shumë me rëndësi i shpallur besimtarëve që i frikësohen Allahut. Kështu, ata e dinë se kurdisja e unit kurrë nuk do të pushojë, as për një moment të vetëm. Përmes joshjes, vazhdimisht tenton që ta largoj njeriun nga rruga e Allahut. Në përputhje me këtë sekret, uni kurrë nuk do të qëndrojë i heshtur; do t'i çfajësoj veprimet e veta ndër të gjitha rrethanat, do ta dojë vetën më shumë se të tjerët, do të bëhet më mendjemadh, do të dëshiroj që të ketë të gjitha të mirat dhe do të dëshiroj të çoj një jetë me kënaqësi. Shkurtimisht, do të drejtohet në çdo mënyrë që ta bëjë një person të shfaq qëndrim të kundërt me moralin me të cilin Allahu është i kënaqur.

Në të vërtetë, sjellja dhe stili i jobesimtarëve, të cilat nuk pajtohen me moralet e Kur'anit, janë plotësisht të formuara nga uni i tyre. Duke mos pasur frikë nga Allahu, jobesimtarët nuk mund të paraqesin dëshirën të dëgjojnë ndërgjegjëjen e tyre por ma parë e përcjellin unin e tyre. Përçarjet, konflikti i interesave dhe palumturi në rankimin në shoqëri në të cilën feja është hedhur anash, i kanë rrënjët e tyre në individë që janë zhytur në unet e tyre dhe interesat e tyre dhe si pasojë, humbin të gjitha tiparet e tyre të njerëzishme siç janë dashuria e vërtetë, respekti dhe sakrifica.

Kjo është arsyeja pse ky sekret i shpallur nga Allahu është i rëndësishëm së madhe. Sa kohë që ndonjëri e mbanë këtë sekret në mend, ai mund të nderrmarr paramasa kunder unit të tij dhe të marr udhën e drejtë të sjelljes. Uni mund të dicitlinohet duke e bërë vetëm të kundërtën nga ajo që ai urdhëron. Psh, kur uni urdhëron përtacinë, njeriu duhet të punoj edhe më shumë. Kur uni urdhëron egoizmin,

njeriu duhet të bëhet më vetë sakrifikues. Kur uni urdhëron koprracinë, njeriu duhet të bëhet më dorëhapur.

Përveç anës së lig të shpirtit, nga surja esh-Shems, ne e dimë se Allahu gjithashtu frumëzoi në shpirtë ndërgjegjëjen e cila e bënë personin që ta mposht shpirtin e tij nga përmbushja e dëshirave të ulëta. Domethënë, pranë një frymëzimi që nxit shpirtin në ligësi, shpirti gjithashtu është i hapur për nxitje në drejtësi. Çdonjëri është i vetëdijshëm për këta zëra përshpëritës dhe e njeh të ligin dhe atë të drejtin. Sidoqoftë, vetëm ata të cilët i frikohen Allahut zbatojnë zërin e ndërgjegjëjes së tyre.

SEKRETET E BEGATISË DHE PASURISË TË CAKTUARA PËR NJERËZIT



Ntërë gjithësia i takon Allahut, dhe Ai i jep çka Ai do kujt do që Ai do. Allahu është Ai që i jep furnizim njeriut, i Cili i bënë ata të pasur dhe u jep atyre prodhime të shumëta. Siç Allahu thotë në një ajet, Allahu e rrit furnizimin e çdo njerit robër të Tij siç Ai do, apo, në mënyrë të ngjashme, ua kufizon atyre. Allahu e bënë këtë për një arsye të caktuar dhe nga urtësia. Të dy palët si ata të cilëve u është rrit furnizimi dhe ata të cilëve ju është kufizuar furnizimi, në fakt janë të vënë në sprovë nga Allahu. Ata të cilët nuk bëhën mendjemdhënjë dhe të prishur për atë që u është dhënë, por i shprehin Allahut falënderim për çdo furnizim, të cilët e vendosin besimin e tyre në Allahun dhe shfaqin palëkundshmëri kur pasuria e tyre kufizohet, këta janë robërit me të cilët Allahu është i kënaqur. Fjalët e Pejgamberit Sulejmanit (as), e përmendur në Kur'an, e bënë të qartë se bekimet që Allahu i furnizon njerëzit me, janë aktualisht një pjesë e sprovës:

E ai i cili kishte dituri nga libri tha: “Unë ta sjell atë ty sa çel e mshel sytë (këtij i tha sille)!” E kur e pa atë (fron) të vendosur pranë tij (Sulejmani) tha: Kjo është dhuntia e Zotit tim që t’më sprovovë mua se a do ta falënderoj, apo mos do ta përbuzë. E kush falënderon, ai falënderon për të mirën e vet, e kush përbuz, Zoti im (s’ka nevojë), është i pa nevojë e bujar!” (Neml: 40)

Fjalët e Pejgamberit Sulejmanit (as), kur tha“ kjo dhuratë është pjesë e Allahut tim që të më sprovovë mua që të sheh nëse unë do të shprehi falënderim apo të shprehi mosmirënjohje” shpjegojnë një nga arsyet se pse njerëzve u janë dhënë dhurata.

Çka Allahu përcakton si “tërhykje e kësaj bote” në Kur’an- duke përf- -shirë: pasurinë, fëmijët, gratë, të afërmit, pozitën, autoritetin, inteligjencën, bukurinë, shendetin, tregtinë fitim prurëse, sukseset, shkurtimisht, gjithçka është dhënë që ta vë nën kontroll në sprovë.

Sekretet në begatitë që u jepën jobesimtarëve

Shumë ka njerëz në botë të cilët, edhe pse nuk kanë besim në Allahun, shijojnë një jetë të gjatë, gëzojnë bekime të panumërta, posedojnë tokë pjellore dhe rrisin fëmijë të shëndosh. Këta njerëz, në vend që të përpiqen që të fitojnë kënaqësinë e Allahut, kanë degjeneruar për arsye të këtyre bekime--ve dhe mbesin larg nga Allahu. Këta njerëz, të cilët kanë humbur në gjatësi të mëdha në drejtimin e një jete të pabindur ndaj Allahut të tyre dhe të cilët kanë kryer shumë e më shumë mëkate për çdo ditë, duke konsideruar se çka ata posedojnë si të mira për vetvete. Mirëpo, Kur’ani e tërheq vemendjen tonë te një sekret tjetër dhe qëllimi hyjnor prapa këtyre bekimeve dhe kohës së dhënë:

Po ty të mos duket e mirë pasuria e tyre dhe fëmijët e tyre. All-llahu deshi t’i mundojë me të në këtë botë dhe t’u dalë shpirti duke qenë mohues. (Tawba: 85)

Të mosmendojnë ata që nuk besuan se afatin që u dhamë Ne atyre

të jetojnë, është në dobi të tyre. Ne i lamë të jetojnë vetëm që shtojnë edhe më shumë mëkate, se ata i pret dënim nënçmues. (Ali 'Imran: 178)

Andaj, ti (Muhammed) lëri ata edhe një kohë në atë mashtrimin e tyre. A mos mendojnë ata se me atë që jemi duke u dhënë atyre nga pasuria dhe fëmijët, Ne nxitojmë t'u ofrojmë atyre të mirat? Jo, kurrsesi, por ata nuk janë kah e kuptojnë. (Mu'minun: 54-56)

Siç u shpjegua në këto ajete, çka këta njerëz posedojnë faktikisht nuk është mirë për ta. Koha e dhënë atyre është vetëm që tu shtohen mëkatet e tyre. Kur afati i tyre mbaron, as pasuria e tyre, as fëmijet, as pozita e tyre nuk mund t'i mbrojnë ata nga denimi i vështirë. Në të vërtetë, Allahu e ka lidh situatën e gjeneratës së kaluar të cilët jetuan në pasuri dhe begati të furnizimit, që takuan një dënim të vështirë si vijon :

E, sa e sa gjenerata kemi shkatërruar para tyre e që ishin më të pajisur dhe më të dukshëm. (Merjem: 74)

Ajeti vijues shpjegon arsyen pse këtyre njerëzve u është dhënë kohë shtesë:

Thuaj: “Atij që është në humbje (në mosbesim), le t'ia vazhdojë atij i Gjithfuqishmi për një kohë, e kur do ta shohin atë që po u premtohet: ose dënimin (në këtë jetë) ose kijametin, atëherë do ta kuptojnë se kush do të jetë në pozitë më të keqe dhe më i dobët në përkrahje!” (Merjem: 75)

Allahu është i Drejti dhe Mëshiruesi më i Madh, Ai krijon çdo gjë me urtësi dhe mirësi, dhe çdo njëri është ripaguar plotësisht për atë që ai ka bërë. Duke qënë të vetëdijshëm për këtë, besimtarët vlerësojnë ngjarjet me qëllim që të shohin urtësinë dhe mirësinë që Allahu krijon në çdo ngjarje. Përndryshe, njerëzit do të jetonin një jetë me mashtrime, të larguar nga realiteti.

SEKRETI SE PSE ALLAHU NUK I DËNON MENJËHERË JOBESIMTARËT



Një nga sekretet e shpallura në Kur'an, është se njerëzit nuk janë menjëherë të ndëshkuar për veprimet e këqija që ata i kryejnë, por dënimi është shtyrë deri në kohë të caktuar. Kjo është shpallur në ajetin në vijim:

E sikur All-llahu t'i kapte njerëzit sipas veprave (të këqija) të tyre, nuk do të mbetej asnjë gjallesë, por Ai i afatizon deri në momentin e caktuar, e kur të vijë afati i tyre, s'ka dyshim se All-llahu i ka parasysh robërit e vet! (Fatir: 45)

Zoti yt është që falë shumë dhe bën mëshirë të madhe, sikur t'i ndëshkonte ata për atë që kanë vepruar, do t'ua ngute atyre tash dënimin, por ata kanë momentin e caktuar, e pos Tij nuk do të gjejnë ata strehim. (Kehf: 58)

Se shumë njerëz nuk janë ndëshkuar menjëherë për veprimet e tyre të këqija mund t'i drejtoj ata të mendojnë se ata kurrë nuk do të mbahën përgjegjës për punë e tyre të liga. Ky supozim i pengon ata nga kërkimi i pendimit, ndjimit keqardhje dhe korrigjimin e gabimeve të tyre. Gjithashtu, kjo u shton pafytyrësinë e tyre. Të qenurit pa urtësi, ata nuk mund të parashikojnë se kjo do të ju sjell dënimin e tyre edhe më shumë të padurueshëm në ahiret. Në Kur'an, Allahu thotë:

Të mosmendojnë ata që nuk besuan se afatin që u dhamë Ne atyre të jetojnë, është në dobi të tyre. Ne i lamë të jetojnë vetëm që shtojnë edhe më shumë mëkate, se ata i pret dënim nënçmues. (Ali 'Imran: 178)

Kjo është një vonesë e krijuar nga Allahu vetëm ta vë njeriun në provë. Mirëpo, sigurisht është një kohë e caktuar në shikimin e Allahut që secili njeri do të shpaguaj për çka ai ka qënë i zënë. Kur kjo kohë e caktuar mbaron, nuk mund të ketë vonesë as të afrohet më afër, as për një moment. Allahu na informon neve se secili sigurisht do të shpaguhet:

E, sikur të mos ishte vendimi dhe afati i caktuar më heret nga Allahu yt, dënimi do t'i kapte ata. (Ta Ha: 129)

Mirëpo, atyre u jap afat, se kapja (dënimi) Ime është e fortë.. (A'raf: 183)

PËRFUNDIM



Cdo njëri që e lexon Kur'anin dhe e len të vendoset në zemëren dhe shpirtin e tij, i cili konsideron jetën, ngjarjet dhe njerëzit për rreth tij me qëndrimin e një përsonei besimtarë, dhe i cili e merr Allahun për shokë të vetëm mund t'i shohë sekretet e shpallura në Kur'an. Çdo ngjarje, e rëndësi- -shëme apo jo, nxën vend rrjedhimisht; asgjë nuk paraqitet si rezultat i një rastësie. Një sekret, qëllim i shenjët dhe i mirë i Allahut vendoset prapa secilit prej tyre. Nëse njerëzit veprojnë sinqerisht dhe gjithmonë kthehen te Allahu, atëherë ata mund t'i vlerësojnë këto sekrete dhe urtësinë prapa tyre.

Njëri që i kupton sekretet e Kur'anit dhe e vëren eksistimin e këtyre sekreteve në jetë afrohet më afër Allahut dhe konsolidon shoqëri me Të. Këta njerëz kanë kuptim ma të mirë për Allahun, Krijuesin e qiejve dhe të tokës dhe të arrijnë vlerësim më të mirë të fuqisë, urtësisë dhe diturisë së Tij. Ata kuptojnë se nuk ka asnjë shokë apo mbrojtës tjetër pos Allahut. Ata ndiejnë emocine dhe kënaqësinë e të pamurit dhe kuptimin e urtësisë dhe sekreteve që Allahu krijon në çdo moment të vetëm. Allahu zbulon më shumë sekrete në krijimet e Tij për kësi njerëzish. Edhe nëse jeta e këti përsonei duket e ngjashme me të tjerëve, Allahu, faktikisht, krijon diçka të jashtëzakonshëme për atë përsonei në

çdo minut. Allahu do t'ua paraqët këto çdo njërit që sinqërisht dëshiron të shoh urtësinë dhe sekretet e Tij në krijimet e Tij.

Siç Allahu thotë në Kur'an:

**Ne këtë (që u përmend) ka mjaft për një popull të dëgjueshëm.
(Enbiya': 106)**

MASHTRIMI I EVOLUCIONIT



Darvinizmi, me fjalë të tjera teoria e evolucionit, u prezantua me qëllim të mohimit të faktit të krijimit, por që në të vërtetë nuk është asgjë përveç një marrëzi e dështuar joshkencore. Kjo teori, e cila pretendon se jeta lindi rastësisht nga materia e pajetë, u zhvlerësua nga faktet shkencore të “projektimit” të qartë në gjithësi dhe në gjërat e gjalla. Në këtë mënyrë, shkenca vërtetoi se Allahu krijoi gjithësinë dhe gjallesat në të. Propaganda e zhvilluar sot për të mbajtur në jetë teorinë e evolucionit mbështetet kryekëput në shtrembërimin e fakteve shkencore, interpretimin e paragjykuar dhe gënjeshtat dhe pavërtetësitë e maskuara si shkencë.

Mirëpo kjo propagandë nuk mund ta fsheh të vërtetën. Fakti se teoria e evolucionit është mashtrimi më i madh në historinë e shkencës ka ardhur në shprehje shumë e më shumë në botën shkencore gjatë 20-30 viteve të fundit. Hulumtimet e bëra pas viteve të 80-ta në veçanti kanë zbuluar se pohimet e Darvinizmit janë krejtësisht të pabaza, gjë që është thënë nga një numër i madh i shkencëtarëve. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veçanti, shumë shkencëtarë prej fushave të

ndryshme biologjia, biokimia dhe paleontologjia pranojnë gjymtinë e Darwinizmit dhe e përdorin konceptin e projektimit inteligjent për të shpjeguar zanafillën e jetës. Ky “projektim inteligjent” është një shprehje shkencore e faktit se Allahu i krijoi të gjitha gjallesat.

Ne kemi ekzaminuar rënien e teorisë së evolucionit dhe provat e krijimit në mënyrë shumë të hollësishme shkencore në shumë prej punimeve tona dhe vazhdojmë ta bëjmë këtë. Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje, do të jetë shumë e dobishme që ta bëjmë një përmbledhje të saj këtu.

Dështimi shkencor i Darwinizmit

Teoria e evolucionit, edhe pse është një doktrinë që i ka fillimet në Greqinë e lashtë, u përqaftua gjerësisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit Origjina e Llojeve të Çarlls Darvinit. Në këtë libër, ai doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe kanë ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. Teoria e Darvinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor konkret, siç e pranoi edhe ai vet, ajo ishte vetëm një “supozim”. Veç kësaj, ashtu siç e pranoi Darvini në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë”, teoria dështoi përballë një sërë çështjesh vendimtare.

Darvini mbështeti të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, të cilat shpresonte që do të zgjidhnin këto vështirësi. Mirëpo, në kundërshtim me atë që ai shpresonte, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre vështirësive. Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmbledhet në tre tituj kryesorë:

- 1) Teoria nuk arrin të shpjegoj se si ka zënë fill jeta në tokë.
- 2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që tregon se “mekanizmat e

evolucionit” të propozuara nga kjo teori, posedojnë asnjë force evoluese.

3) Të dhënat fosile provojnë pikërisht të kundërtën e ideve të parashtruara nga kjo teori.

Në këtë pjesë, do të shtjellojmë në vija të përgjithshme këto tri çështje themelore:

Pengesa e parë e pakapërcyeshme: Zanafilla e jetës

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në Tokën primitive 3.8 miliardë vjet më parë. Si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona specie të gjalla e të komplikuar dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet asnjë gjurmë në të dhënat fosile janë disa nga pyetjet në të cilat teoria nuk është në gjendje të jap përgjigje. Por në fillim, duhet të pyetemi: Si u krijua kjo “qelizë e parë”?

Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çfarëdo ndërhyrje të mbinatyrshme, ajo supozon se “qeliza e parë” është shfaqur rastësisht pa asnjë projektim, planifikim apo rregullim, përbrenda ligjeve të natyrës. Sipas kësaj teorie, materia e pajetë duhet të ketë krijuar rastësisht qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më të pakundërshtueshme të biologjisë.

“Jeta rrjedh nga jeta”

Darvini, në librin e tij, nuk ka folur kurrë mbi zanafillën e jetës. Koncepti primitiv shkencor në periudhën kur jetoi ai supozonte se gjallesat zotërojnë një konstrukt shumë të thjeshtë. Sipas teorisë së krijimit të rastësishme që besohet në mesjetë, lëndët e pajetë/inorganike, duke u bashkuar, mund të formojnë një qenie të gjallë. Në atë periudhë ishte shumë i përhapur mendimi se insektet

formoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të provuar diçka të tillë janë bërë eksperimente nga më të çuditshmet: Një leckë e ndotur me pak grurë mbi të, në një anë, ndërsa në anën tjetër një shkencëtar, duke pritur që pas një kohe të formoheshin minj.

Gjithashtu mendohej se shfaqja e krimbave në një copë mishi ishte dëshmi e krijimit të vetvetishëm/spontan. Por më vonë do të kuptohej se ata krimba nuk formoheshin vetvetiu në mish, por nga larvat e padukshme për syrin që sillleshin nga mizat.

Madje edhe kur Darvini shkroi librin Origjina e Llojeve, besimi se bakteret formoheshin nga materia e pajetë ishte një gjë e pranuar gjerësisht në botën e shkencës.

Por vetëm 5 vite pas botimit të librit të Darvinit, Lui Paster shpalli përfundimet e arritura pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata që rrëzuan plotësisht krijimin spontan, i cili përbënte gur-themelin e teorisë së Darvinit. Në ligjëratën e tij triumfale në Sorbonë në vitin 1864, Pasteri tha: *“Kurrë më nuk do të rimarr veten krijimi spontan prej grushtit vdekjeprurës të dhënë nga ky eksperiment i thjeshtë.”*⁹

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i kundërshtuan për një kohë të gjatë zbulimet e Pasterit. Mirëpo shkenca, e cila po përparonte duke nxjerrë në dritë ndërtimin kompleks të qelizës së organizmit të gjallë, e përforcoi edhe më tepër pavlefshmërinë e pretendimeve mbi krijimin e rastësishëm të jetës.

Përpjekjet e pafrytshme të shekullit njëzet

Evolucionisti i parë, i cili u mor me çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e njëzet ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të krijohej rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme dhe Oparin do të detyrohej ta bënte këtë rrëfim:

Mirëpo, fatkeqësisht, çështja e zanafillës së qelizës përbën ndoshta pikën më të errët të gjithë studimit të evolucionit të organizmave.¹⁰

Pasuesit evolucionist të Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai që u ndërmor në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar gazrat, që ai pretendonte se kishin ekzistuar në atmosferën primitive në një ambient eksperimental dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, Milleri formoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Mezi kishin kaluar disa vite para se të zbulohesh se ky eksperiment, i cili atëherë u paraqit si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në këtë eksperiment ishte shumë më e ndryshme nga kushtet reale të Tokës.¹¹

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Milleri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte reale.¹²

Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit të njëzet për të shpjeguar zanafillën e jetës përfunduan pa sukses. Xhefri Bada, gjeo-kimisti i njohur nga Instituti Skrips i San Diegos, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën “*Earth (Toka)*”, pranon këtë fakt:

Sot, duke e lënë pas shekullin e njëzet, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në shekullin e njëzet: Si zuri fill jeta në tokë?¹³

Ndërtimi i ndërlikuar i jetës

Shkaku kryesor që çështja mbi zanafillën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë është se madje ata organizma të gjallë që mendohej të jenë më të thjeshtat kanë ndërtim jashtëzakonisht të ndërlikuar. Qeliza e një

gjallese është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë njeriu. Sot, madje edhe në laboratorët më të përparuara të botës, duke bashkuar materie kimike organike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përfitojmë një qelizë të vetme.

Kushtet që nevojiten për formimin e një qelize janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësi. Probabiliteti që proteinat, njësia bazë e qelizës, të sintetizohen rastësisht është 1 në 10950 (për një proteinë mesatare me 500 aminoacide). Në matematikë probabilitetet më të vogla se 1050 konsiderohen të pamundura.

Molekula e ADN-së përmban informacionet gjenetike si një bankë informacionesh me kapacitet të pabesueshëm. Nëse do ta hidhnim në letër informacionin që përfshin ADN-ja e njeriut, do të krijohesh një bibliotekë me 900 volume enciklopedike me nga 500 faqe secili.

Në këtë pikë shfaqet një dilemë shumë interesante: ADN-ja mund ta kopjoj/përsëris vetveten vetëm me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimave). Mirëpo, sinteza e këtyre enzimave mund të realizohet vetëm me anë të informacionit të koduar në ADN. Pasi që ato të dyja janë të varura nga njëra tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për kopjim/përsëritje. Kjo e sjellë skenarin se jeta ka zënë fill vetvetiu në një rrugë pa krye. Prof. Lesli Orgel, një evolucionist me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, e pranon këtë fakt në botimin e revistës *Scientific American* të Shtatorit të vitit 1994:

Është krejtësisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nukleike, duke qenë të dyja komplekse për nga ndërtimi, të jenë krijuar vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Po ashtu duket e pamundshme ta kemi një të tjetrën. Dhe kështu, në shikim të parë, njeriut do t'i duhej të vjen në përfundimin se, në të vërtetë, jeta kurrë nuk ka mundur të zë fill me anë të mjeteve kimike.¹⁴

Padyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta u “krijua” në mënyrë

të mbinatyrshe. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë të qartë teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohoj krijimin.

Mekanizmat imagjinarë të evolucionit

Çështja e dytë e rëndësishme që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme është se të dy konceptet e paraqitura nga kjo teori si “mekanizma të evolucionit”, u kuptua se në të vërtetë nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në tërësi në mekanizmin e “seleksionimit natyror.” Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit të tij: *Origjina e Llojeve nëpërmjet seleksionimit natyror*...

Seleksionimi natyror pohon se ato gjallesa që janë më të fuqishme dhe që i përshtaten më mirë kushteve natyrore të vendbanimeve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetë. P.sh., në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbijetojnë vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet nga individët më të fortë dhe më të shpejtë. Mirëpo, sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të shkaktojë evoluimin e sorkadheve e t'i kthejë në një lloj tjetër gjallëse, për shembull, në kuaj.

Për këtë arsye, mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet, ndaj në librin e tij *Origjina e Llojeve* u detyrua të pohonte:

*Seleksionimi natyror s'mund të bëjë asgjë përderisa nuk shfaqen dallime dhe ndryshime të dobishme individuale.*¹⁵

Ndikimi i Lamarkut

Si mund të formoheshin këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t'i përgjigjej nga këndvështrimi i të kuptuarit

primitiv të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Shevalie Lamark (1774-1829), i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcollën brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, të cilat kishin fituar gjatë jetës së tyre. Ai pohonte se këto cilësi, të cilat u akumuluan nga një brez në tjetrin, bënë që të formohen specie të reja. Për shembull, ai pohonte se gjirafat evoluuan nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën nga njëri brez në tjetrin Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm. Në librin e tij Origjina e Llojeve, për shembull, ai thotë se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit me kohë u shndërruan në balena.¹⁶

Por zbulimet e Gregor Mendelit (1822-1884) të ligjeve të trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkencë e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e njëzet, hedhën poshtë plotësisht legjendën e përcjelljes së karakteristikave të fituara në brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefektiv.

Neo-darvinizmi dhe mutacionet

Për të gjetur një zgjidhje, darvinistët nxorën në dritë “Teorinë Sintetike Moderne”, apo siç njihet ndryshe Neo-Darvinizmin, në fund të viteve 1930. Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e gjallesave për shkak të faktorëve të tillë të jashtëm si rrezatimi apo gabimet në përsëritje, si “shkaqe të ndryshimeve të dobishme” përveç mutacionit natyror.

Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u formuan si rezultat i një procesi me anën e të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave (p. sh., veshët, mushkëritë dhe krahët) iu nënshtruan “mutacioneve,” domethënë çrregullimeve gjenetike. Por ekziston një fakt i prerë shkencor që plotësisht e hedh poshtë këtë teori:

Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat, përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: ADN-ja zotëron një ndërtim shumë të ndërlikuar dhe çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund vetëm t'i shkaktojë dëm asaj. Gjeneticisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si në vazhdim:

Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi që janë të rastësishme, më parë se ndryshime të rregullta në strukturën e gjeneve; çfarëdo ndryshimi i rastësishëm në një sistem tejet të rregullt do të ndikojë për të keq, jo për të mirë. Për shembull, nëse një tërmet do të dridhte një ndërtim tejet të rregullt siç është një ndërtesë, do të ndodhte një ndryshim i rastësishëm në kornizën e ndërtesës, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishte një përmirësim.¹⁷

Nuk çudit fakti se deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm, domethënë, i cili është parë të zhvilloj kodin gjenetik. Është vërtetuar se të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni, i cili është paraqitur si një “mekanizëm i evolucionit,” është në të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë të gjymtuara. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri.) Natyrisht, një mekanizëm shkatërrues nuk mund të jetë “mekanizëm evolutiv.” Seleksionimi natyror, në anën tjetër, “s’ mund të bëj asgjë i vetëm,” siç e pranoi edhe Darvini. Ky fakt na tregon se nuk ekziston ndonjë “mekanizëm evolutiv” në natyrë. Pasi që nuk ekziston asnjë mekanizëm evolutiv, asnjë proces i tillë i imagjinuar i quajtur “evolucion” nuk ka mundur të ndodhë.

Të dhënat fosile: asnjë gjurmë e formave kalimtare

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që sugjerohet nga teoria evolucionit nuk ka ndodhur kurrë.

Sipas kësaj teorie, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga një paraardhës. Një specie, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, u shndërrua në diçka tjetër dhe të gjitha speciet u krijuan në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë një periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Po të kishte qenë kështu, lloje të shumta kalimtare duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.

Për shembull, disa krijesa gjysmë peshk–gjysmë zvarranik duhej të kishin jetuar në të kaluarën të cilat kishin fituar disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut të cilat ato tashmë i kishin. Apo duhej të kishin ekzistuar disa zvarranik-zogj, të cilët fituan disa tipare të zogjve përveç tipareve të zvarranikëve që ato tashmë i kishin. Meqë këto gjallesa do të duhej të kishin ekzistuar në një periudhë kalimtare, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë të metash. Evolucionistët, këto qenie imagjinare që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, i quajnë “forma kalimtare”.

Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë do të duhej të kishte me miliona dhe madje miliarda sosh për nga numri dhe llojllojshmëria. Ajo që është më me rëndësi, mbetjet e këtyre qenieve të çuditshme do të duhej të haseshin në të dhënat fosile. Darvini, në librin Origjina e Llojeve, këtë fakt e shpjegon kështu:

Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta që lidhin speciet e të njëjtit grup, duhet të kenë ekzistuar sigurisht... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre të mëparshme do të mund të gjendeshin vetëm në mbetjet fosile.”¹⁸

Shpresat e venitura të Darvinit

Mirëpo, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në mbarë botën, ende nuk është gjetur asnjë formë kalimtare. Të gjitha fosilet, në kundërshtim me atë që shpresonin evolucionistët, tregojnë se jeta në Tokë u shfaq rastësisht, krejt papritur dhe plotësisht e formuar.

Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, edhe pse një evolucionist, e pranon këtë realitet:

Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, hasim gjithmonë e më tepër jo evolucion gradual, por shpërthim të papritur të një lloji në llogari të një tjetri.¹⁹

Me fjalë të tjera, te fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të përfunduar, pa asnjë formë të ndërmjetme në mes. Kjo është pikërisht e kundërta e supozimeve të Darvinit. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë që gjallesat janë krijuar. I vetmi shpjegim që një specie e gjallë të shfaqet papritmas e plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar është se ajo u krijua. Kjo e vërtetë është pranuar po ashtu nga biologu i mirënjohur evolucionist Douglas Futuyuma:

Krijimi dhe evolucioni janë dy shpjegimet e vetme që mund të bëhen rreth origjinës së qenieve të gjalla. Krijimi dhe evolucionin, në mes tyre, shter shpjegimet e mundshme për zanafillën e gjallesave. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose jo. Në rast se nuk janë zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga specie që kanë ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga ndonjë intelekt i plotfuqishëm.²⁰

Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në Tokë të formuara plotësisht dhe në gjendje të përkryer. Me fjalë të tjera “origjina e llojeve,” në kundërshtim me supozimin e Darvinit, nuk është evolucioni, por krijimi.

Përralla e evolucionit të njeriut

Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot kanë evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë kësaj periudhe të supozuar, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar “forma kalimtare” midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Ka katër “kategori” bazë në gjithë këtë skenar të imagjinuar:

1. Australopiteku
2. Homo habilis
3. Homo erectus
4. Homo sapiens

Evolucionistët i japin emrin “Australopitek” (që do të thotë “majmuni i jugut”), të ashtuquajturit paraardhës të parë të njeriut të ngjashëm me majmunët. Këto qenie të gjalla nuk janë në fakt asgjë tjetër, përveçse një specie e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lordit Solli Cukerman dhe Profesorit Çarlls Oksnard, dy anatomistë me famë botërore nga Anglia dhe SHBA-ja, rreth mbetjeve të australopitekeve tregojnë se këto qenie i përkisnin një lloji të majmunit të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore.²¹

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor “homo,” domethënë “njeri”. Sipas këtij pretendimi, qeniet e gjalla të serisë “homo” ishin më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë njëra-tjetrës me

një renditje të caktuar dhe përpiluan një plan imagjinar evolucionari. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht asnjë lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme nuk është provuar. Ernst Majër, njëri prej mbrojtësve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e njëzet në librin e tij Një argument i gjatë pohon se: “në veçanti (enigmat) historike si zanafilla e jetës apo e Homo sapiensit, janë tejet të vështira dhe mund madje t’i bëjnë ballë një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm.”²²

Kur konturojnë zinxhirin Australopitek > Homo Habilis > Homo Erektus > Homo Sapiens, evolucionistët nënkuptojnë se këto specie kanë qenë paraardhëse të njëra-tjetrës. Mirëpo, zbulimet më të fundit të paleo-antropologëve tregojnë se Australopiteku, Homo Habilis dhe Homo Erektus kanë jetuar në të njëjtën periudhë në pjesë të ndryshme të botës.²³

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si Homo Erektus ka jetuar deri në kohërat moderne. Homo sapiens, Neandertalët dhe Homo Sapiens Sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon.²⁴

Kjo, sigurisht, provon përfundimisht se këto specie nuk ishin paraardhëse të njëra-tjetrës. Stefën Xhej Gould, njëri prej paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse është evolucionist, e shpjegon qorrkakun në të cilin gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:

*Çfarë i ndodhi shkallës sonë, nëse bashkekzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitekët robust (shtatmëdhenj) dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit të tyre në tokë.*²⁵

Me pak fjalë, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet gjallë me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të krijesave imagjinare

“gjysmë-majmun-gjysmë-njeri”, që shfaqen në media apo libra shkollorë, domethënë, sinqerisht, me anë të metodave propagandistike, s’janë gjë tjetër veçse një mit pa asnjë bazë shkencore.

Lordi Solli Cukerman, një nga shkencëtarët më të njohur dhe më të spikatur të Mbretërisë së Bashkuar, e ka studiuar këtë çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e Australopitekut. Edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se, në të vërtetë, nuk ekziston asnjë pemë gjenealogjike midis majmunit dhe njeriut.

Cukerman gjithashtu bëri një “spektër interesant të shkencave”, duke i radhitur ato nga ato që ai i konsideronte si më shkencoret tek ato që i konsideronte si më joshkencoret. Sipas spektrit të Cukermanit, më “shkencoret,” duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, janë shkenca e fizikës dhe kimisë. Më pas vijnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat shoqërore. Në fund fare, në pjesën që konsiderohet të jetë si pjesa më “joshkencore”, radhitet “perceptimi jashtë-shqisor” – konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe në fund të fundit u vendos “evolucioni i njeriut”. Cukerman shpjegon kështu arsyetimin e tij:

Më pas zhvendosim regjistrin e të vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës të konsideruara si shkenca biologjike, si p.sh. perceptimi jashtë-shqisor apo interpretimi i historisë së fosileve të njeriut, ku për (evolucionistin) besnik gjithçka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarrtë (i evolucionit ndonjëherë është në gjendje të besojë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën kohë.²⁶

Siç shihet, evolucioni njerëzor nuk është gjë tjetër veçse një përmbledhje e “disa interpretimeve të paragjykuara të fosileve të zharrosura prej njerëzve të caktuar, të cilët ndjekin verbërisht teorinë e tyre.

Formula e Darvinit!

Përveç të gjitha provave teknike me të cilat jemi marrë gjer më tani, le ta shtjellojmë njëherë, se çfarë paragjykimi kanë evolucionistët me një shembull të thjeshtë që të kuptohet madje edhe prej fëmijëve:

Teoria e evolucionit pohon se jeta u krijua rastësisht. Sipas këtij pohimi, atomet e pajetë dhe të pavetëdije u bashkuan për të formuar qelizën dhe pastaj ata disi formuan gjallesat tjera, duke përfshirë edhe njeriun. Le të mendojmë për këtë. Kur i bashkojmë elementet që janë bazë e ndërtimit jetës si karboni, fosfori, nitrogjeni dhe potasiumi, vetëm një grumbull formohet. Pa marrë parasysh se çfarë trajtimi i nënshtrohet, ky grumbull atomesh nuk mund të formojë madje as edhe një gjallesë të vetme. Nëse dëshironi, le ta formulojmë një “eksperiment” në lidhje me këtë çështje dhe ta shtjellojmë në emër të evolucionistëve atë që ata vërtet e pohojnë pa e shprehur zëshëm me emrin “formula e Darvinit”:

Le të vendosin materialistët plot materiale të pranishme në përbërjen e gjallesave si fosfori, nitrogjeni, karboni, oksigjeni, hekuri dhe magneziumi në fuçi të mëdha. Veç kësaj, le të shtojnë në këto fuçi çfarëdo lloj materiali që nuk ekziston në kushte normale, por që ata mendojmë se është i domosdoshëm. Le të shtojnë në këtë përzierje aq sa të dëshirojnë amino acide – të cilat nuk kanë mundësi të formohen në kushte natyrore – dhe proteina – që një e vetme e ka probabilitetin e formimit 10 në 950 – sa të duan. Le t’ia ekspozojnë këto përzierje deri në masën që dëshirojnë nxehtësisë dhe lagështisë. Le t’i përziejnë këto me çfarëdo pajisje të përparuar teknologjike që të duan. Le t’i vënë shkencëtarët më të shquar pranë këtyre fuçive. Le të presin këta ekspert me radhë pranë këtyre fuçive për miliarda dhe trilionë vite. Le të lejohen të përdorin të gjitha llojet e kushteve që ata besojnë të jenë të domosdoshme për formimin e një njeriu. Pa marrë parasysh se çfarë bëjnë, ata nuk mund ta krijojnë një njeri prej këtyre fuçive, të themi një

profesor që ekzaminon strukturën e qelizës së tij nën një mikroskop elektronik. Ata nuk mund të krijojnë gjirafa, luanë, bletë, kanarina, kuaj, delfinë, trëndafila, orkide, zambakë, karafila, banane, portokaj, molla, hurma, domate, pjepra, shalqi, fiq, ullinj, rrush, pjeshka, pallojë, fazanë, flutura shumëngjyrëshe apo me miliona gjallesa si këto. Me të vërtetë, ata nuk do të mund të përfitonin as edhe një qelizë të vetme prej cilësdo prej tyre.

Thënë shkurt, atomet e pavetëdijshme nuk mund të formojnë qelizën duke u bashkuar. Ato nuk mund të marrin një vendim të ri dhe ta ndajnë këtë qelizë më dysh dhe pastaj të marrin vendime tjera dhe të krijojnë profesorët të cilët së pari shpikin mikroskopin elektronik dhe pastaj ekzaminojnë strukturën e qelizës së vet nën atë mikroskop. Materia është një grumbull i pavetëdijshëm, i pajetë dhe ajo vjen në jetë me krijimin e lartë të Allahut.

Teoria e evolucionit, e cila pohon të kundërtën e kësaj, është një gjykim plotësisht i gabuar i kundërt me arsyen. Të menduarit madje edhe vetëm për pak kohë për pohimet e evolucionistëve zbulon këtë të vërtetë, sikurse në shembullin më lartë.

Teknologjia e syrit dhe veshit

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë te syri, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes "Si shohim ne?" Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet "qendra e shikimit". Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një sërë procesesh. Le të mendojmë pak, duke u bazuar në këto njohuri teknike.

Truri është i izoluar tërësisht nga drita. Kjo do të thotë se pjesa e brendshme e trurit është në errësi të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësi të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë në këtë errësi të plotë.

Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa që as teknologjia e shekullit njëzet nuk ka arritur ta realizojë. Për shembull, shikoni librin që jeni duke e lexuar, duart me të cilat e mbani atë dhe pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Edhe ekrani më i zhvilluar i televizorit i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër. Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimensional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpikin një sistem TV tre-dimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale 3-D. Për më tepër, bëhet fjalë vetëm për një tre-dimensional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa plani i parë duket sikur është dekor prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishtëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot?

Nëse një pajisje që prodhon një imazh më primitiv se syri nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë krijuar rastësisht. E njëjta

gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt dhe i drejton te veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. D.m.th. truri është i izoluar nga tingujt, ashtu si është i izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbizotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më të mprehtë perceptohen nga truri.

Nëpërmjet trurit tonë, i cili është i izoluar nga tingujt, ne dëgjojmë simfoninë e ekzekutuar nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz. Megjithatë, nëse bëhet një matje ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, do të kuptonim se një qetësi absolute mbizotëron aty.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruarit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfituar asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi. Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto pajisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur ndizni një HI-FI gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, i mprehtë e i qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga krijimi i njeriut.

Kujt i takon ndërgjegjja që sheh dhe dëgjon në brendi të trurit?

Kush shikon një botë joshëse në trurin tonë, dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve dhe ndien aromën e trëndafilut?

Nxitjet që vijnë prej syve, veshëve dhe hundës së një personi shkojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë, mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si ky imazh formohet në tru. Mirëpo, kurrë nuk do të mund të ndesheni me faktin më të rëndësishëm: Kush i pranon këto impulse nervore elektro-kimike si imazhe, tinguj, aroma dhe ngjarje shqisore në tru? Ekziston një ndërgjegje në tru që i pranon gjithë këto pa ndier ndonjë nevojë për një sy, vesh apo hundë. Kujt i takon kjo ndërgjegje? Natyrisht se nuk u takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse darvinistët-materialist, të cilët besojnë se gjithçka përbëhet prej materies, nuk mund të japin përgjigje në këto pyetje.

Sepse kjo ndërgjegje është shpirti i krijuar prej Allahut, i cili nuk ka nevojë as për syrin për të shikuar imazhet dhe as për veshin për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë për trurin për të menduar.

Çdo njeri që e lexon këtë fakt të qartë shkencor do të duhej të mendonte thellë për Allahun e Gjithëfuqishëm dhe të ketë frikë dhe të kërkoj strehim tek Ai, sepse Ai ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej disa centimetrave kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndritshme.

Një besim materialist

Informacioni që kemi paraqitur deri tani tregon se teoria e evolucionit është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore. Pretendimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës është në

kundërshtim me shkencën, mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë forcë evolutive, dhe fosilet tregojnë se format kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë. Prandaj, teoria e evolucionit duhet të hidhet poshtë si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide, si modeli i gjithësisë me qendër Tokën, janë nxjerrë jashtë agjendës së shkencës gjatë historisë.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorive shkencore. Disa njerëz madje përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të saj si “sulm ndaj shkencës”. Po pse ndodh kjo gjë?

Arsyeja për këtë situatë të krijuar është se për disa njerëz të cilët u përkasin disa qarqeve të caktuara, teoria e evolucionit është shndërruar në një besim dogmatik të domosdoshëm. Këto qarqe kapen fort pas filozofisë materialiste dhe ndikohen nga Darwinizmi, i cili për ta është shpjegimi i vetëm materialist për natyrën.

Nganjëherë ata e pranojnë hapur këtë. Riçard Levontin, gjenetist i famshëm nga universiteti i Harvardit dhe në të njëjtën kohë një evolucionist i njohur pranon se është “së pari materialist, pastaj shkencëtar”:

Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materiale, edhe nëse janë kundër intuitës, pa marrë parasysh se sa të mjegullta janë për të panisurën. Për më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë të dalë në skenë një Qenie Hyjnore.²⁷

Këto fjalë janë deklarata të qarta se Darwinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Prandaj, ajo predikon se materia e pajetë dhe e pavetëdijshme krijoi jetën. Ajo këmbëngul se

miliona specie të gjalla, (si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, balenat dhe qeniet njerëzore) u shfaqën si pasojë e bashkëveprimit të materies si shiut, rrufeve dhe kështu me radhë prej materies së pajetë. Ky besim është në kundërshtim të plotë si me arsyen ashtu edhe shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim me qëllim që “të mos lejojnë daljen në skenë të një Qenie Hyjnore.”

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi, i Cili zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. Ky Krijues është Allahu, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, i Cili e konstruktoi atë në mënyrën më të përkryer dhe u dha formë të gjitha gjallesave.

Teoria e evolucionit:

Magjia më e fuqishme në botë

Çdo njeri i lirë prej paragjyimit dhe ndikimit të çfarëdo ideologjie të caktuar, që përdor arsyen dhe logjikën e tij apo të saj, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, i cili na përkujton besëtytnitë e shoqërive pa dijeni të shkencës apo qytetërimit, është plotësisht i pamundshëm.

Siç u shpjegua më lartë, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do të mund të krijojnë profesorë dhe studentë universiteti që janë në gjendje të mendojnë dhe gjykojnë; shkencëtarë si Ajnshtajni dhe Galileo; artistë si Hemfri Bogart, Frenk Sinatra dhe Luçano Pavaroti; si edhe antilopa, drurë limoni dhe karafila. Për më tepër, pasi që shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjepura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si për “magjinë më të fuqishme në histori.” Asnjëherë më parë asnjë besim apo ide tjetër nuk ua ka larguar aftësinë e të gjykuarit të njerëzve, nuk

ka pranuar t'i lejojë ata të mendojnë me mençuri dhe me arsye dhe ua ka fshehur të vërtetën sikur ata t'i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e keqe dhe më e pabesueshme se adhurimi i Zotit të Diellit Ra nga egjiptianët, adhurimi i totemeve në disa pjesë të Afrikës, adhurimi i Diellit nga populli i Sabës, adhurimi i idhujve që kishin mbaruar me duart e tyre nga ana e fisit të Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të) apo adhurimi i Viçit të Artë nga ana e popullit të Profetit Musa (paqja qoftë mbi të).

Në të vërtetë, Allahu ka theksuar këtë mungesë arsyeje në Kuran. Në shumë vargje, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafuqishme të shohin të vërtetën. Disa nga këto vargje jepen në vazhdim:

Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove - ata nuk besojnë. Allahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh. (Sure Bekare: 6-7)

... Ata kanë zemra me të cilat nuk kuptojnë. Ata kanë sy me të cilët nuk shohin. Ata kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur! Ata janë të pavetëdijshëm. (Sure A'raf: 179)

Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë), ata vetëm do të thoshin: "Neve na janë ndalë sytë (të parët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur. (Sure Hixhr: 14-15)

Fjalët nuk mund ta shprehin se sa është e habitshme se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet aq të gjerë në skllavëri, t'i largojë njerëzit nga e vërteta dhe të mos ndërpritet për 150 vjet. Është e kuptueshme se një apo disa njerëz do të mund të besonin në skenarë dhe pohime të pabesueshme përplot marrëzi dhe mungesë arsyeje. Mirëpo, "magjia" është shpjegimi i vetëm i mundshëm për njerëzit në mbarë

botën që besojnë se atomet e pavetëdijshme dhe të pajetë papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem të organizimit, rregullit, arsyes dhe vetëdijes së përkryer; një planet të quajtur Tokë me të gjitha veçoritë e saj të përshtatura në mënyrë aq të përkryer për jetën; dhe gjallesat përplot sisteme të panumërta komplekse.

Në të vërtetë, Kurani rrëfen ngjarjen e Profetit Musa dhe Faraonit për të treguar se disa njerëz të cilët përkrahin filozofitë ateiste në të vërtetë ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur iu tha Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Musa të ndeshet me magjistarët e tij. Kur Musai e bëri këtë, ai u tha atyre që të tregojnë aftësitë e tyre të parët. Vargjet pasojnë:

“Hidhni ju!” – u përgjigj ai. Kur magjistarët hodhën shkopinjtë e tyre, i magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe shfaqën një magji të madhe. (Sure A’raf: 116)

Siç kemi vënë re, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje të mashtrojmë çdo njeri, përveç Musait dhe atyre të cilët i besuan atij. Mirëpo, dëshmia e tij zhduki magjinë, apo “gëlltiti atë që ata kishin sajuar,” siç përshkruhet në ajet.

Atëherë Ne i kumtuam Musait: “Hidhe shkopin tënd!” - dhe ai filloi të gëlltiste gjithçka që trilluan ata. Në këtë mënyrë, doli në shesh e vërteta dhe dështoi ajo që kishin bërë ata. (Sure A’raf: 117-118)

Siç kemi vënë re, kur njerëzit e kuptuan se ata u magjepsën dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion, magjistarët e Faraonit humbën gjithë besueshmërinë e tyre. Edhe në ditët tona, përveç nëse ata të cilët, nën ndikimin e një magjie të ngjashme, besojnë në këto pretendime qesharake nën maskën e tyre shkencore dhe kalojnë jetët e tyre duke i mbrojtur ato, i braktisin besimet e tyre paragjykuese, ata po ashtu do të poshtërohen kur e vërteta e plotë shfaqet dhe magjia prishet. Në të

vërtetë, Malkolm Magerixh, një filozof ateist dhe përkrahës i evolucionit, pranoi se ishte i brengosur pikërisht nga kjo perspektivë:

Unë personalisht jam i bindur se teoria e evolucionit, posaçërisht shtrirja e zbatimit të saj, do të jetë njëra prej shakave më të mëdha në librat e historisë në të ardhmen. Brezat e ardhshëm do të çuditen se si një hipotezë aq jo bindëse dhe e dyshimtë ka mundur të pranohej me naivitetin e pabesueshëm që ajo posedon.²⁸

Se e ardhmja nuk është larg: Përkundrazi, njerëzit së shpejti do ta shohin se “rasti” nuk është hyjni dhe do të shikojnë prapa në teorinë e evolucionit si në mashtrimin më të keq dhe magjinë më të tmerrshme në botë. Ajo magji tashmë ka filluar të ngrihet me shpejtësi prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë njerëz që e shohin fytyrën e saj të vërtetë po pyeten me habi se si është e mundur që të jenë kapluar prej saj.

.....

***Engjujt thanë: “Larg nga të metat je
Ti o Zot! Ne nuk kemi asnjë dije tjetër
përveç asaj që na mësove Ti. Vërtet,
Ti je i Gjithëdijshëm e i Urtë.”***
(Sure Bekare: 32)

SHËNIMET

1. Buyuk Hadis Kulliyati (Great Ahadith Collection), Cem-ul-fevaid min Cami'il-usul and Mecma'iz-zevaid, Imam Muhammad Bin Muhammad Bin Sulayman er-Rudani 5
2. Sahih Bukhari, Volume 8, Book 75, Number 351
3. Ramuz el-Hadis, vol 1, p. 22
4. Al-Tirmidhi, Destiny 10, 2145
5. Al-Tirmidhi, Birr 55, 1988
6. Ramuz El-Hadis, vol 1, p. 137
7. Ramuz El-Hadis, vol 1, p. 13
8. Ramuz El-Hadis, vol. 1, p. 7
9. Sidney Fox, Klaus Dose, Molecular Evolution and The Origin of Life, E.H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, p. 4.
10. Alexander I. Oparin, Origin of Life, Dover Publications, NeëYork, 1936, 1953 (reprint), p. 196.
11. "Neë Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life", Bulletin of the American Meteorological Society, vol 63, November 1982, p. 1328-1330.
12. Stanley Miller, Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules, 1986, p. 7.
13. Jeffrey Bada, Earth, February 1998, p. 40.
14. Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on Earth", Scientific American, vol. 271, October 1994, p. 78.
15. Charles Darëin, The Origin of Species by Means of Natural Selection, The Modern Library, Neë York, p. 127.
16. Charles Darëin, The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition, Harvard University Press, 1964, p. 184.
17. B. G. Ranganathan, Origins?, Pennsylvania: The Banner Of Truth Trust, 1988, p. 7.
18. Charles Darëin, The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition, Harvard University Press, 1964, p. 179.
19. Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record", Proceedings of the British Geological Association, vol 87, 1976, p. 133.
20. Douglas J. Futuyma, Science on Trial, Pantheon Books, Neë York, 1983. p. 197.
21. Solly Zuckerman, Beyond The Ivory Toëer, Toplinger Publications, Neë York, 1970, pp. 75-14; Charles E. Oxnard, "The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt", Nature, vol 258, p. 389.
22. "Could science be brought to an end by scientists' belief that they have final ansëers or by society's reluctance to pay the bills?" Scientific American, December 1992, p. 20.
23. Alan Eäalker, Science, vol. 207, 7 March 1980, p. 1103; A. J. Kelso, Physical Antropology, 1st ed., J. B. Lipincott Co., Neë York, 1970, p. 221; M. D. Leakey, Olduvai Gorge, vol. 3, Cambridge University Press, Cambridge, 1971, p. 272.
24. Jeffrey Kluger, "Not So Extinct After All: The Primitive Homo Erectus May Have Survived Long Enough To Coexist Eëth Modern Humans", Time, 23 December 1996.
25. S. J. Gould, Natural History, vol. 85, 1976, p. 30.
26. Solly Zuckerman, Beyond The Ivory Toëer, p. 19.
27. Richard Leëontin, "The Demon-Haunted Eërd," The Neë York Revieë of Books, January 9, 1997, p. 28.
28. Malcolm Muggeridge, The End of Christendom, Grand Rapids:Eerdmans, 1980, p. 43